



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave
“Inxhinieri Informatike”**
**me profile “Inxhinieri Softwerësh”, “Siguria e Sistemeve të
Informacionit”, “Menaxhim të Dhënash”, “Dizenjim dhe Zhvillim
Aplikimesh”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”**
“Universiteti European i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Edlira Martiri

Edlira Martiri

Dr. Ervin Ramollari

Ervin Ramollari

Shtator/2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Master i shkencave në "Inxhinieri Informatike" me profilet: "Inxhinieri software-sh", "Siguria e Sistemeve të Informacionit", "Menaxhim të Dhënash", "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë (Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i shkencave "Inxhinieri Informatike" me profile: <ul style="list-style-type: none"> • "Inxhinieri software-sh", • "Siguria e Sistemeve të Informacionit" • "Menaxhim të Dhënash" • "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh" • "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 627 datë 05.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
13.1	• Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	• Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2020-2021: 7 PAE / 6 PAK
16	Numri i studentëve (për tre vite):	119 Studentë
17	Komente / të tjera:	

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Nga verifikimi i dokumenteve, programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike", me profilet: "Inxhinieri software-sh", "Siguria e Sistemeve të Informacionit", "Menaxhim të Dhënash", "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh", (më tej me 5 profile) miratohet për hapje nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Me Urdhër Nr. 627, datë 05.10.2018 të MASR, në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 18, 23, 35, 69 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Ky program realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Inxhinieri Informatike", me profile, në Fakultetin e Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, të Universitetit Europian të Tiranës, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Veprimtaria akademike e programit të studimit fillon në vitin akademik 2018-2019.

Njësia Kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë.

Ky raport bën vlerësimin e jashtëm të programit të studimit në kuadër të akreditimit të parë të programit.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr.31, Datë 05.05.2021 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universitetit European i Tiranës” dhe në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti European të Tiranës, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, e përbërë nga 160 dokumenta në total. Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, kanë realizuar vizitat në datat 23 dhe 24 Qershor 2021, në Institucionin e Arsimit të Lartë “Universiteti European të Tiranës”, sipas veprimtarive të parashikuara në axhendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët. Ekspertët vlerësuan edhe dokumentacionin e kërkuar gjatë vlerësimit.

Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”.

Koordinator Teknik i vlerësimit të këtij programi ka qenë specialisti i ASCAL ME. Renata Qatipi.

Më datë 08.09.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 19/63 Prot., datë 09.09.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, UET është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

UET përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 78/50 Prot., datë 24.09.2021 “Kthim përgjigje mbi draft RVJ për programin e studimit Msc në Inxhinieri Informatike”, me 5 profile. Në këtë dokument institucioni ka disa komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet e UET sqaron si më poshtë:

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.3, Kriteri 1): “GVJ konstaton mospërputhje të pjesëve të ndryshme përshkruese të objektivave dhe qëllimeve të programit master. *Këto shprehje vihen re në disa prej dokumenteve të dorëzuara nga IAL, ashtu si edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, ku më shumë vlerësimi është i përgjithshëm dhe jo specifikisht për këtë program studimi. (Psh. objektivat e një studenti IT, lidhen me shkencat shoqërore).

Komenti i UET: Në lidhje me këtë paragraf, vëmë në dukje se vlerësimi i këtij kriteri në RVB është informues dhe i përgjithshëm, pasi vetë formati i përdorur për RVB nuk synon që informacioni i pasqyruar aty të jetë shterues, ndërkohë që për informacion të detajuar, vlerësuesit nevojitet t’i referohen edhe dokumentacionit mbështetës të referuar në RVB (konkretisht Ref. Nr. 7. Rregullore mësimore e programit MSH Inxhinieri Informatike”). Objektivat dhe qëllimet e programit përshkruhen në formë më të zgjeruar dhe konkrete dhe në Supplementin e Diplomës që është gjithashtu pjesë e DVV (lutemi referohuni dhe komentit në kriterin 3 më poshtë), të cilat gjykojmë se janë në të njëjtën linjë me ato të Rregullores

mësimore të programit. Duke qenë se vlerësimi mbështetet si në RVB, ashtu edhe në DVV, besojmë se informacioni i dorëzuar është mëse i plotë, ndaj lutemi të rishikohet formulimi për këtë kriter në Raportin përfundimtar të ekspertëve.

Përgjigje e GVJ:

Në lidhje me këtë konstatim, GVJ ka shqyrtuar dokumentet e vëna në dispozicion nga IAL, bashkë me RVB (Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit; Suplementet e Diplomave; Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit).

- 1) Në Rregullore, objektivat janë të përgjithshëm, mungojnë objektivat formues, qëllimi i programit të studimit, si dhe njohuritë dhe kompetencat e studentit në dalje të programit të studimit, të cilat duhet të reflektojnë arritjen e vetë objektiveve.
- 2) Në suplementet e diplomave, rubrika Rezultatet e të nxënit, janë të vendosura qëllimet që ka programi i studimit (mungojnë objektivat).
- 3) Është e vërtetë që RVB nuk mund të japë përgjigje shteruese për kriteret në përgjithësi në përmbushjen e IAL të misionit të saj dhe përshkrimit të plotë të programit të studimit. Por, ky dokument është përmendur në RVJ si një mundësi e mirë përfundimtare për të arsyetuar atë çfarë cdo kriter kërkon specifikisht.

Për të përmbledhur, dokumentet e përmendura dhe mbi të cilët programi i studimit ngrihet, GVJ sugjeron që të rishqyrtohen, të rakordohen mes tyre dhe të plotësohen (vecanërisht Rregullorja e programit të studimit), për të pasur një pasqyrë të qartë për studentët që zgjedhin këtë degë dhe profilet përkatëse, si dhe institucionet e kontrollit të cilësisë së IAL.

Pavarësisht, meqenëse në dokumentacionin bazë të programit të studimit, elementët e mësipërm, si objektivat/qëllimet, objektivat formues, rezultatet e të nxënit, njohuritë dhe kompetencat e studentit në dalje të programit të studimit, pozicionet e punës ku të diplomuarit mund të punojnë etj, në tërësinë e dokumenteve të dorëzuara ato janë të përcaktuara, GVJ, fjalën “mospërputhje” do ta zëvendësojë me “shpërndarje”.

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.3, Kriteri 1): *Së fundmi, në suplementet e diplomave, Pika 4.2, Rezultatet e të nxënit të parashikuara për programin e studimit, vëmë re që ndryshimi mes 4 profileve është minimalist. Të paktën në këtë dokument të fundit të lëshuar për studentin, të nxirrej në pah më shumë vecantia e tij si profesionist dhe si studiues shkencor në këtë profil”*

Komenti i UET: Në seksionin 4.2 të suplementeve të diplomës, rezultatet e të nxënit të parashikuara për programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Informatike”, janë formuluar qartësisht dhe lidhen drejtpërdrejt me fushën kryesore të tij. Sqarojmë se profilet e këtij programi, janë të konceptuara bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, si grup-lëndë me zgjedhje, veprimtari formuese të kategorisë C (referuar VKM 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar), dhe qëllimi kryesor është t’i pajisi studentët me njohuri në fushën kryesore që është Inxhinieri Informatike, dhe të mundësojë fokusimin e tyre në një drejtim pak më të ngushtë të fushës kryesore që është profili, përmes 3 lëndëve me zgjedhje të përcaktuara në kurrikul, sikurse është evidentuar në suplement.

Për sa kohë profilet përbëhen nga vetëm 3 lëndë, nuk mendojmë se veçantia e studentit si profesionist dhe studiues shkencor në fushën e inxhinierisë informatike është më e thellë nga sa është evidentuar në seksionin 4.2 të suplementeve të diplomës, konform legjislacionit në fuqi për elementët e programeve të studimit. Mbështetur në sa më sipër, gjykojmë se ka vend për rishikimin e këtij seksioni në draftin përfundimtar të RVJ.

Përgjigje e GVJ:

Është e vërtetë që suplementet e diplomave, në seksionin 4.2, japin një shpjegim mjaft të rëndësishëm (sikurse RVJ e nxjerr në pah këtë dokument si një burim i mirë informacioni në disa kritere, madje për t'u përvetësuar dhe nga dokumentet e tjerë), por ajo çfarë do sugjeronim të vihej në pah, është një diferencim më i qartë në këtë përshkrim për profilet.

Në lidhje me kuadrin ligjor të përmendur në koment, profilet "IT e biznesit" dhe "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" bashkëndajnë një nga tre lëndët që duhet të bënin ndryshimin mes tyre, duke krijuar kështu mundësinë e një thyerjeje të kritereve të përcaktuara në VKM nr. 41.

Së fundmi, sugjerojmë që në këtë pjesë, të rishihet par. 2: "Qëllimi i këtij programi është t'u përgjigjet interesave të ndryshme që mund të kenë studentët...". Mendojmë se riformulimi duhet të jetë në funksion të interesave profesionale e akademike të studentëve, ose interesave kombëtare për profesionistë të tillë.

Komentet e IAL nuk pranohen.

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.3, Kriteri 2): "Në dokumentin "Studimi periodik për tregun e punës, pas daljes së studentëve", pasqyrohet e njëjta përmbajtje si në dokumentin e kaluar, pra nuk konstatojmë reflektime të tjera në lidhje me programin e studimit. Mungojnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës."

Komenti i UET: Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigjen e këtij kriteri në RVB përshkruhet metodologjia e ndjekur në studimin e tregut, e cila përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Këto elementë të studimit të tregut përfshihen në dokumentin sipas formatit të dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit, me informacionin i cili përditësohet për periudhat respektive që kryhet analiza e tregut të punës. Duke qënë se burimet e përdorura janë zyrtare, për tregun vendas bazuar kryesisht në studimet e INSTAT, është siguruar në këtë metodologji të studimit të tregut të punës, një kontakt indirekt me punëdhënësit dhe kërkesat e tyre.

Bazuar në sqarimet e mësipërme lutemi për rishikimin e vlerësimit të këtij kriteri.

Përgjigje e GVJ:

GVJ konstaton që formulari kërkon në këtë kriter që: *“Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës”, vlerësimi i përgjithshëm për të nuk ndryshon.*

Komentet e IAL nuk pranohen.

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.3, Kriteri 3): *“Qëllimi për përgatitjen e studentëve me njohuri bazë aplikative shprehet në RVB në mënyrë të përgjithësuar, sipas të cilit misioni i programit është të formojë specialist të lartë.”*

Komenti i UET: Në lidhje me këtë formulim, shohim se vlerësimi i këtij kriteri në RVB është shterues për aq sa është parë e arsyeshme dhënia e një vlerësimi i mbështetur në evidenca dhe lidhet me objektivat formues dhe rezultatet e pritshme të të nxëniet për programin MSH “Inxhinieri Informatike”, duke referuar së paku një dokument ku ato identifikohen, Ref. Nr. 15.1 – 15.4. Modeli i diplomës; Modeli i Suplementit të diplomës”, sipas të cilit citojmë:

“Qëllimi i këtij programi është të përgatisë specialistë të nivelit të lartë, të aftë për të përballuar kërkesat e tregut në drejtim të zgjidhjeve dhe menaxhimit softwerik të projekteve. Në këtë program studentët do të pajisen me dijet më inovative në këtë drejtim për t'i bërë të aftë të përdorin teknologjitë e reja të menaxhimit të të dhënave, të domosdoshmenë në të gjitha fushat e zhvillimit ekonomik e social. Kurrikula ofron formim të thelluar shkencor për të rritur aftësitë vendim-marrëse dhe profesionale në përdorimin e sistemeve dhe teknologjive më të avancuara si Sistemet Enterprise, teknologjitë Big Data dhe Inteligjencën artificiale. Mbjajtësi i diplomës ka afësinë të identifikojë kërkesat për zgjidhje, projekttojë, dizenojë, realizojë sisteme inovative dhe komplekse të informacionit nëpërmjet aplikacioneve software si dhe të kryejë kërkime shkencore të avancuara në këtë fushë. Qëllimi i këtij programi është t'u përgjigjet interesave të ndryshme që mund të kenë studentët dhe t'i bëjë ata të vetëdijshëm për rolin që do të luajnë në mbarim të tij në vendin e punës në tregun kombëtar ose ndërkombëtar nëpërmjet kombinimit të harmonizuar të dijeve praktike me ato teorike. Në program përfshihen lëndë karakterizuese që i japin studentit njohuri të thelluara mbi sistemet e informacionit, teknologjitë e reja, inxhinierimi dhe menaxhimi i tyre, bazat e të dhënave, zhvillim web, menaxhimi i rrjetave kompjuterike dhe Inteligjenca artificiale.”

Për arsyet e sipërpërmendura, lutemi që formulimi të rishikohet në Raportin Përfundimtar.

Përgjigje e GVJ:

GVJ nuk është e qartë mbi arsyet e komentit të dhënë. Vlerësimi i këtij kriteri nga GVJ nuk është kritikues. Të shprehurit që RVB shpreh në mënyrë të përgjithësuar, është konstatim dhe jo vërejtje. Fokusi i kriterit në këtë standard është se si elementë të ndryshëm të programit të studimit (struktura, objektivat, rezultatet e pritshme, etj) garantojnë kompetenca që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Për GVJ kjo realizohet, kurse faktin që elementët e përmendur (struktura, objektivat, rezultatet e pritshme, etj) janë të shpërndarë në disa dokumente e kemi analizuar në kriteret përkatëse. Fjalja do të riformulohet, për të mos lënë keqkuptime.

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.3, Kriteri 4 dhe 5): *“Për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja, por, sipas kriterit, IAL nevojitet të saktësojë konkretisht se cilit programi të ngjashëm të ofruar nga institucione ndërkombëtare, ai i është referuar. RVB shpreh në mënyrë të përgjithësuar që “për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja”, por nuk shprehet më qartë se cilin/cilët.”*

Komenti i UET: Kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton detyrimisht si kriter për t’u zbatuar nga IAL-të identifikimin e një modeli konkret, të cilin IAL ka përdorur si referencë për hartimin e një kurrikule. Sigurisht që për hartimin e programit janë konsultuar kurrikula të programeve të tjera të ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja, si edhe është shfrytëzuar përvoja e personelit akademik të programit, një pjesë e të cilit ka studiuar/punuar jashtë vendit, por nuk është se është kopjuar ndonjë program konkret që të mund të specifikohet. Dëshmi që programi është i ngjashëm me programe të tjera është edhe numri i lartë i shkëmbimeve të studentëve të programit në kuadër të Erasmus+ (Ref. Nr. 28.1. Mobiliteti i studenteve Erasmus). Për sa kohë kriteri nuk kërkon të evidentohet një program konkret i përdorur si referencë, lutemi të rishikohet formulimi në Raportin Përfundimtar.

Përgjigjia e GVJ:

RVJ në këtë pikë, nevojitet të saktësojë çfarë kërkon një kriter me atë çfarë argumenton IAL për plotësimin e kriterit. Në formular, kriteri kërkon që: *“Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare”*. RVB, argumentohet që: *“Programi i studimit është në përputhje me kriteret e sistemit të Bolonjës, ku mundësohet mobiliteti i studentëve mes universiteteve. Për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja”*.

Komenti i dhënë më lart për plotësimin e kriterit është më i plotë se përgjigjia e RVB, prandaj GVJ do të reflektojë ndryshimet e dhëna. Por, në bazë të ligjit, Neni 86 “Kodifikimi i programeve të studimit”, pika 2, *“programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind”*.

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

Komenti i UET: Kriteri 8: Ju paraqesim një spjegim më shterues të formulimit të përgjigjes në RVB për këtë kriter;

Si rregull, dokumentet që lidhen me programin e studimit të cilat hartohen dhe arkivohen në shqip dhe anglisht, janë: syllabuset (e çdo viti akademik), Rregullojta e programit të studimit, tabelat (14, 14.1) dhe çdo dokument tjetër i nevojshëm për rastet e informimit të studentëve të huaj që parashikohen të vijnë në UET nëpërmjet shkëmbimeve studentore. Bashkëlidhur gjendet dokumentacioni:

- Ref. Nr. 1.1: Syllabuset, në anglisht
- Ref. Nr. 1.2: Rregullojta e programit, në anglisht
- Ref. Nr. 1.3: Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Informatike, në anglisht
- Ref. Nr. 1.4: Plani mësimor MSH Inxhinieri Informatike, në anglisht

Bazuar në sqarimin e mësipërm dhe dokumentat bashkëlidhur, lutemi për rishikimin e vlerësimit të kriterit në Raportin Përfundimtar.

Përgjigje e GVJ:

Falenderojmë IAL për dokumentet e plota të programit të studimit në gjuhën angleze, sipas komentit më lart. Komentet e IAL pranohen dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.4, Kriteri 3): *Në lidhje me klasifikimin/kodifikimin e programit të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, RVB nuk shprehet se si ato janë reflektuar, si dhe nuk gjenden në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL.*

Komenti i UET: Në listën e dokumentave tip të vënë në dispozicion nga ASCAL në faqen zyrtare www.ascal.al, referohet dokumenti me numër rendor 31, me emërtimin “Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Evropiane”, si kërkesë për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri.

Mirëpo, siç jemi në dijeni nga puna jonë (e përbashkët) në ambientet akademike/universitare, nuk janë publikuar ende udhëzimet për përcaktimin e kodit dhe klasifikimin e programeve të studimit, sikurse parashikohet në LAL 80/2015, Neni 86, Pika 3.

Ndërsa GVB ka dhënë spjegim në dokumentin 0.1. Lista e dokumenteve mbështetëse - MSH IngInf, numri rendor 31, se nuk kanë dalë ende aktet nga MASR.

Bazuar në sa më sipër nevojitet që ky konstatim të mos mbetet pjesë e Raportit Përfundimtar, pasi institucioni nuk mund të ofrojë informacion për gjëra që ende nuk janë definuar me aktet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Përgjigje e GVJ:

Pas komenteve të dhëna nga GVB dhe konfirmimit me zyrën e ASCAL, GVJ do të ndryshojë vlerësimin e dhënë në këtë kriter. Komentet e IAL pranohen dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.6, Kriteri 1): *“RVB shpreh që IAL promovon dhe mbështet mobilitetin e stafit, sipas referencës “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit”. Kjo referencë nuk përmban të dhëna për vitin akademik 2020-2021, i cili është e vërtetë që ka qenë vit pandemik, por duhej të përshkruhet dhe arsyetohet në raport, si dhe të azhurohen dokumentet përkatëse.”*

Komenti i UET: Lidhur me fjalinë e dytë në këtë paragraf, dokumenti i referuar përmban të dhënat që disponon DIT për periudhën të cilës i nënshtrohet vlerësimi dhe mendojmë se mungesa e një përshkrimi apo arsytimi në raport për ndikimet e një situatë që preku të gjithë sektorët jetësorë, nuk është tregues i mospërmbushjes së kriterit. Lutemi të rishikohet ky formulim në Raportin Përfundimtar.

Ndërsa konsatojmë një vlerësim pozitiv të Ekspertëve lidhur me aspektin e projekteve, kërkimit shkencor dhe shkëmbimet e stafit, duke përfshirë argumentimin për ndikimet nga situata e pandemisë Covid-19, në Standardin IV.2, Kriteri 2.

Përgjigje e GVJ:

GVJ kërkon që dokumentet t'i përmbahen periudhës së cilës in nënshtrohet vlerësimi, që përfshin vitin akademik 2020-2021. Fjalja e nxjerrë në koment, është një nevojë për saktësimin e cdo kriteri dhe argumenti, me shkrim. Jo më kot e përmendëm dhe e justifikuam këtë mungesë (që nuk është konsideruar në fakt si e tillë). Gjithsesi, për të evituar keqkuptime, GVJ do të riformulojë draft-raportin.

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi I.6, Kriteri 3 dhe 4): *“Kriteri në këtë rast kërkon të saktësojë atë çfarë IAL realizon në drejtim të mbrojtjes së produktit të kërkimit shkencor, si dhe çfarë politike ndiqet për pronën intelektuale.”*

Komenti i UET: Lidhur me këtë formulim, në vijim një plotësim i përgjigjes së GVB: **Politikat që ndjek UET paraqiten në dokumentin Nr. Ref. 54. Kodi i Etikës, në veçanti Pika A.II.7.1 dhe A.II.7.2.** Lutemi në rishikimin e formulimit në Raportin Përfundimtar.

Së fundmi, nëse këto konstatime/komente kanë ndikuar në vlerësimin “përbushet pjesërisht” të standardit I.6, bazuar në argumentat e mësipërme, lutemi që ky vlerësim të rishikohet.

Përgjigje e GVJ:

Falenderojme GVB për saktësimin e RVB në kriterin 3, duke shtuar referencat e duhura Komentet e IAL pranohen dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi II.3, Kriteri 4): *“IAL nuk ka një plan mësimor në një dokument të vetëm për programin e studimit MSH Inxhinieri Informatike me 5 projekte.”*

Komenti i UET: Dokumenti i planit mësimor ekziston dhe është pjesë e DVV të programit. Vetë Ekspertët konfirmojnë paraprakisht në vlerësimin e këtij kriteri se: “Në dokumentin “Plani mësimor MSH Inxhinieri Informatike”, paraqitet vetëm tabela e numrit total të orëve të: Leksione, Seminare, Ushtrime/Projekte, Praktikë Profesionale, Punimi i diplomës. Rregullat për frekuentimin si dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe në programet e vecanta lëndore, si dhe në Rregulloren Mesimore të programit. Në bazë të dokumentacionit, IAL përcakton një nivel frekuentimi të mësimit prej 80% të kohës për programet e ciklit të dytë”. Lutemi që në kuadër të koherencës së raportit të hartuar, formulimi të rishikohet në Raportin Përfundimtar: Plani mësimor i programit është hartuar sipas modelit të kërkuar nga ASCAL, konkretisht tabela 10, dhe këtu dalim përtej vlerësimit nëse do duhet të ishte hartuar duke përfshirë edhe elementë të tjerë sipas gjykimit të ekspertëve, elementë të cilët gjithsesi gjenden në dokumente të tjera të DVV dhe nuk është se mungojnë.

Përgjigje e GVJ:

Në bazë të VKM 41/2018, elementët kryesorë që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në: kreditet; kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; objektivat formues dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese; kategoritë e veprimtarive formuese; plani mësimor; kuotat e pranimit; syllabusët; etj. Sic e kemi përmendur dhe në komentet e mësipërme, IAL këto elementë i ka në masën më të madhe të tyre, por i gjejmë të shpërndarë në dokumente të ndryshëm. Specifikisht:

1. Objektivat e përgjithshëm janë në Rregullore e Programit
2. Objektivat strategjike janë tek Plani strategjik për zhvillimin e programit. (Objektivat formues nuk i gjejmë në ndonjë dokument)
3. Qëllimet, plus përshkrimet dhe saktësimet e profileve dhe profesionet e mundshme janë vetëm tek Suplementet e Diplomave.
4. Mundësitë e punësimit janë edhe tek Plani strategjik i MSH.
5. Kurrikula është dokument me vete (shpërndarja e lendeve sipas kategorive-ref 14)
6. Plani mësimor sipas semestreve (dokument me vete -ref 14.1)
7. Kriteret e pranimit janë dokument tjetër (ref. 27.1), që nuk kuptohet nga është ekstraktuar (statuti ndoshta). Nuk ka ndarje Kriteri i përgjithshëm, nga Kriteri specifik, etj.

Kjo VKM, duke qenë se nuk e shpreh saktësisht dokumentimin e elementëve të strukturës së programit të studimit, shpesh nënkuptohet që këto elementë ndodhen në rregulloren e programit (ose në ndonjë rast emërtohet dhe strukturë apo plan, etj). GVJ do të rregullojë këto terma në draft, si dhe do të saktësojë faktin që elementët gjenden në pjesën më të madhe të tyre.

Komentet e IAL pranohen dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi II.3, Kriteri 5): "GVJ konstaton se në kriteret e pranimit nuk ka rregulla specifike, pra kushte paraprake për regjistrimin e studentëve. Kjo rregullore nënkupton që këtë program mund ta ndjekin studentë nga çfarëdo programi bachelor."

Komenti i UET: Mendojmë se ky konstatim qendron, por nuk mund të cenohet cilësinë e përbushjes së kriterit/standardit për sa kohë që kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit janë konform kuadrin ligjor në fuqi, i cili nuk ka përcaktuar ndonjë pengesë në lidhje me fushën e studimeve paraprake për pranimit në programet e ciklit të dytë Master, duke ia lënë vendimarrjes së brendshme të IAL-ve të drejtën për të përcaktuar kriteret pranimi shtesë. UET nuk e ka parë të arsyeshme të kufizojë të drejtën e studentëve për të riorientuar studimet e tyre në programet e ciklit të dytë të studimeve. Filozofia e UET për ndërtimin e syllabuseve të lëndëve dhe mbështetja dhe këshillimi akademik që UET u ofron studentëve gjatë studimeve, e mundësojnë ndjekjen me sukses të një programi master edhe nga studentë që nuk kanë përfunduar studimet Bachelor në një fushë të njëjtë apo të përafërt. Sigurisht që këto raste janë sporadike, dhe në vijim do të gjeni një tabelë me shpërndarjen e studentëve të regjistruar në programin e studimit, sipas fushës ku kanë përfunduar studimet Bachelor.

Fusha e studimeve Bachelor	Nr. i Studentëve të regjistruar		
	2018-2019	2019-2020	2020-2021
Informatikë	4	4	10
Informatikë ekonomike	12	36	19
Inxhinieri informatike	1		3
Inxhinieri matematike	1	2	1
Sistemet e Informacionit	1	1	
Teknologji informacioni	1	3	4

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 11

Financë bankë, Ekonomik	1		4
Fizikë Kompjuterike		2	
Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital		1	
Inxhinieri Gjeoinformatike		2	2
Inxhinieri Kompjuterike		3	2
Inxhinieri matematike dhe Informatike		1	
Matematikë		1	2
Matematikë-Infomatikë		1	
Shkenca Kompjuterike		1	1
Menaxhim biznesi		1	
Inxhinieri Softwerike			1
Inxhinieri telekomunikacioni			2
Total të regjistruar	21	59	51

Nga të dhënat e mësipërme mund të vihet re se vetëm 1 nga 21 studentët e regjistruar në vitin akademik 2018-2019 janë me formim të mëparshëm në një fushë të ndryshme nga ajo e programit të studimit, në vitin 2019-2020 vetëm 1 nga 59 studentë e regjistruar, ndërsa në vitin 2020-2021, 4 nga 51 studentët e regjistruar. Këta studentë janë me formim të mëparshëm në fushat Financë, Ekonomik e Menaxhim Biznesi.

Së fundmi, nëse konstatime/komentet e mësipërme kanë ndikuar në vlerësimin “përbushet kryesisht” të standardit II.3, bazuar në argumentat dhe shpjegimet e mësipërme, lutemi të shihet mundësia për rishikimin e këtij vlerësimi.

Përgjigje e GVJ:

Kriteri 5, kërkon nëse programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto informacione ofrohen, sic përmendet në RVJ, dhe nxirret në pah kjo karakteristikë e Programit të Studimit, pa specifikuar asnjë vlerësim nëse është vendim i drejtë apo i gabuar. Mbetet në vlerësimet e IAL dhe jo të GVJ.

Gjithashtu, në RVB pohohet që “Programi i studimit reflekton kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit...” gjë që nuk rezulton e tillë nga kontrolli i dokumentacionit të IAL, si dhe konfirmohet nga komenti më lart. Përsëri, vendimi është i IAL për pranimin e studentëve dhe përshtatjes së kontigjenteve së studentëve, që janë larg fushave të studimit përkatëse.

Komentet e IAL nuk pranohen.

GVJ në Draft RVJ (Standardi II.3, Kriteri 6): Të gjitha lëndët janë të përfshira në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, përveç “Praktikës Profesionale” e cila në kurrikul reflektohet si “Personal Development”.

Komenti i UET: Lidhur me komentin e GVJ lutemi të rishikohet pasi nga verifikimi i kryer, “Praktika Profesionale” paraqitet në dokumentet;

“14. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Informatike”,

“14.1 Plani mësimor MSH Inxhinieri Informatike”,

“14.2. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese - MSH Inxhinieri Informatike (Aneks_Tabela 9)”;

“19. Syllabus_Praktike Profesionale”, dhe

Në link <https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2018/10/Msc.-Inxhinieri-Informatike.pdf>.

Përgjigje e GVJ:

Për saktësim të citimit nga RVJ, vendosim versionin e plotë: “...Për më tepër, GVJ konstaton që lënda “Praktikë Profesionale”, edhe pse është e dokumentuar në gjithë dokumentet e sipërpërmendur, nuk është e reflektuar në programin e studimit, në listën e lëndëve dhe kategorive.[<https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/10/MSc-Inxhinieri-Informatike.pdf>]. Komenti është i drejtë në lidhje me dokumentet e listuara, ato do të reflektohen në mënyrë specifike dhe jo të përgjithshme sic është në versionin aktual të RVJ. Shqetësimi në lidhje me faqen ueb, nuk është esencial për këtë kriter dhe vlerësimin e tij, por konstatohet si informacion publik, që aksesohet nga studentët (të cilët në përgjithësi nuk konsultojnë rregullorë, por këto forma tabelare online, shumë më të qarta dhe të përmbledhura për ta).

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi II.4, Kriteri 2): a. Dizajnimi dhe Zhvillimi i sistemeve IT (mungon E. K) b. Vlerësim ekonomik projektsh (në syllabus e jep V. K., në department A. Xh.); c. Zhvillimi i avancuar i softwerëve (mungon M. D.)

Komenti i UET: Sqarojmë se në DVV janë përfshirë vetëm syllabuset e vitit akademik 2020-2021, ndërkohë që informacioni për personelin akademik të angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është dhënë për 3 vitet e fundit në tabelat të veçanta, konkretisht 12.1, 12.2 dhe 12.3 të dokumentit Nr. Ref. 24. Aty konstatohet se:

- a. Dr. E. K. është i reflektuar si në syllabusin e lëndës, ashtu edhe tek stafi akademik që ka zhvilluar lëndën (Dokumenti Nr. 24, Tabela 12.3 me numer rendor 8)
- b. Në lidhje me lektorin e lëndës Vlerësim Ekonomik Projektsh, në dokumentacionin e dorëzuar nuk ka mospërputhje informacioni. Në syllabus është V. K., sikurse është edhe në Dokumentin 24, Tabela 12.3 me numër rendor 19.
- c. Për lëndën Zhvillim i avancuar i softwerëve, në vitin akademik 2020-2021, pasqyrohet pedagogu që ka zhvilluar mësimin me grupet mësimore të studentëve të këtij programi, Dr. A. K. Pedagogu pasqyrohet dhe në syllabus, po ashtu dhe në tabelën e stafit, Dokumenti 24, Tabela 12.3, me numër rendor 20.

Përgjigje e GVJ:

Falenderojme GVB për vlerësimin e dhënë dhe konsiderimit të sugjerimeve. Si ekspertë të fushës, bashkë të gjithë GVJ dhe GVB, jemi të vetëdijshëm për sfidat dhe rëndësinë e këtyre programeve studimi, pasi lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me tregun e punës dhe kërkimin shkencor, si asnjë profil tjetër. Jemi gjithashtu në dijeni të faktit që, këto ndryshime nuk mund të reflektohen që tani, por pas akreditimit të parë. Pavarësisht kësaj, ne e pamë të nevojshme t'i listonim, për përmirësimin e përgjithshëm të kurrikulës në të ardhmen e afërt. Themi “të afërt”, sepse efekti kohë në IT është gjithashtu mjaft i rëndësishëm, e mund të ndodhë që

ndonjë prej këtyre sugjerimeve tona, apo dhe konstatimeve tuaja, mund të mos kenë më të njëjtin impakt më vonë.

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi IV.6):

Komenti i UET: Lidhur me evidentimet në draft-Raport të mungesës së dokumentacionit mbi pasqyrat dhe apo evidencave të tjera, ju lutem gjeni bashkëlidhur dokumentet e indeksuara me Nr. Ref. 6.1 – 6.6 (Pasqyra dhe Raporte Financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020).

Lidhur me evidentimin për mungesën e kostove për student në programin e studimit, sqarohet përmes Zyrës së Financës UET, se nuk bëhet përlogaritja e kostos për student në bazë të programeve të veçanta të studimit. Kjo përrarsye se një përlogaritje e tillë do të kërkonte shumë punë, ndërkohë që drejtuesit e institucionit nuk e konsiderojnë të nevojshme këtë lloj informacioni për vendimmarrjen e tyre.

Nëse mungesa e dokumenteve, e evidentuar nga Ekspertet në draft-Raport, ka ndikuar në vlerësimin “përmbushet kryesisht” të këtij standardi, bazuar në evidencat bashkëlidhur parqesim kërkesën që ky vlerësim të rishikohet

Përgjigje e GVJ:

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

GVJ në Draft RVJ (Standardi V.6, Kriteri 3): “Megjithatë, përtej aktivitetit shkencor të mësipërm, GVJ nuk konstaton ndonjë punim shkencor të publikuar prej studentëve të programit të studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile. Institucioni organizon konferencën e përvitshme shkencore, “Ditët e Studimeve Shqiptare”, por nuk ka të dhëna për pjesëmarrje të studentëve të këtij programi studimi si prezantues në këtë konferencë.”

Kriteri 4: “Për sa i përket studentëve të programit Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile, nuk ka evidencat për ndonjë publikim prej tyre në revista shkencore.”

Komenti i UET: Motivimi i studentëve për hartimin dhe publikimin e studimeve e punimeve shkencore (kërkesë e kriterit 3) dhe mbështetja e personelit akademik dhe studentëve për publikime në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore (kërkesë e kriterit 4), përveçse janë në vëmendje të institucionit (Plani Strategjik UET), janë në kujdesin e drejtpërdrejtë dhe të DIT. Kjo demonstron nëpërmjet përfshirjes së këtyre aspekteve në Planin Strategjik të Zhvillimit të Programit të Studimit dhe, për periudhën që programi i nënshtrohet vlerësimit të akreditimit, shifrat për punimet shkencore dhe pjesëmarrjes në projekte dhe mobilitete të stafit akademik apo pjesëmarrjes në mobilitete të studentëve, janë të kënaqshme për vetëm 3 (tre) vite aktivitet të këtij programi. Kjo konfirmohet dhe vlerësohet nga Ekspertët përgjatë draft-RVJ, psh. në përgjigjen e Kriterit 5, Standardi III.4.

Aksesi në thirrjet për t'u përfshirë në konferencën vjetore "Ditët e Studimeve Shqipëtare", ka qënë publik dhe i drejtpërdrejtë edhe për/te studentët. Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë do të ishte mëse i kënaqur nga pjesëmarrja e tyre, dhe çmon rekomandimin e Ekspertëve për inkurajimin e studentëve me temat më të mira të diplomës që t'i prezantojnë/botojnë rezultatet e tyre shkencore në këtë konferencë, në revistën "Nodus" ose përtej tyre.

Megjithë mungesat e publikimeve të punëve shkencore të studentëve në revista shkencore, në kaq pak kohë të ofrimit të programit të studimit dhe kushtet që u induktuan nga situata e pandemisë Covid-19, ata janë motivuar dhe mbështetur në këtë drejtim për: realizimin e projekteve kërkimore lëndore dhe punimit të diplomës.

Bazuar në argumentat e mësipërme dhe duke qënë se në vlerësimin e kritereve të Standardit V.6, nuk identifikohen konstatime/problematika të tjera (përveç "mungesa e ndonjë punimi shkencor të publikuar prej studentëve të programit") të cilat do të cënonin rëndë cilësinë e përmbushjes së tij, lutemi të rishikohet në Raportin Përfundimtar ndryshimi i vlerësimit "përmbushet pjesërisht".

Përgjigje e GVJ:

Komentet e IAL pranohen pjesërisht dhe Draft-Raporti ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” me profile: a. “Inxhinieri Software-sh”, b. “Siguria e Sistemeve të Informacionit”, c. “Menaxhim të Dhënash”, d. “Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh”, e. “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”.

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>GVJ arrin në përfundimin se Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike”, me profile “Inxhinieri Software-sh”, “Siguria e Sistemeve të Informacionit”, “Menaxhim të Dhënash”, “Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, (më tej me 5 profile) i ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës, është në përputhje dhe në harmoni me interesat kombëtare. Kjo është e shprehur dhe në “Planin Strategjik 2021-2025”, ku IAL synon të ndjekë modelin sipas të cilit arsimi ka rol parësor në përmirësimin e përgjithshëm të një vendi.</p> <p>Programi Master i Shkencave, me 5 profile në fjalë, duke qenë se ndjek strategjinë dhe vizionin e përgjithshëm të UET, në bazë të Planit Strategjik të tyre, ka synim të zhvillojë dhe të ketë prioritarë kërkimin shkencor në aktivitetet e përditshme të tij, si dhe të shmangë praktikatat e gabuara. Këtë vizion e shohim të detajuar dhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2021-2025. Sipas këtyre dokumenteve GVJ sheh dhe prioritetet e tjera në aspektin mësimor, atë të botimeve, si dhe në zhvillimin e aktivitetëve social-kulturore.</p> <p>Në bazë të Planit Strategjik për zhvillimin e programit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, GVJ konstaton që hapja e këtij programi përmbush objektivat strategjike institucionale.</p> <p>[Plani Strategjik 2021 – 2025], [Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	
Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Në bazë të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të IAL, konstatohet që programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe ka si objektiv të plotësojë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Kjo shihet dhe në projektin institucional 500+ (më parë 250+), që përfshin kompanitë më të mëdha në vend. Ky projekt, i cili ka si qëllim bashkëpunimin e biznesit me akademinë, ka arritur që të integrojë dhe studentë në internship-e apo punësime. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u</p>

	<p>njoh në mënyrë më të detajuar me projektin, mënyrën e zhvillimit të aktiviteteve të tij, periodicitetin e tyre, si dhe impakti që ka pasur në ngritjen institucionale.</p> <p>[Projekti 500+]</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Në bazë të kurrikulës së Programit të Studimit, GFJ konstaton që nga ana strukturore, ky program mundëson studimet e thelluara të ciklit të tretë të studentëve të diplomuar në të. Kështu, përmendim lëndën Metoda Kërkimi të Avancuara në kurrikulën e tij, si dhe mjaft lëndë të tjera teknike, që i ndihmojnë aftësimin shkencor të studentëve.</p> <p>GVJ vëren se syllabusi i lëndës “Metoda Kërkimi të Avancuara” në dosjen e vetëvlerësimit nuk e ka në listë programin e studimit MSH në Inxhinieri Informatike. Gjithashtu, tematikat përqëndrohen më tepër në metodat kërkimore për shkencat sociale, të cilat mund të ndryshojnë nga metodat kërkimore për informatikën dhe shkencat kompjuterike. Ekspertët e GVJ mendojnë se kjo lëndë u duhet përshtatur më mirë nevojave të studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>[RVB], [Kurrikula e programit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi I.2</p> <p>Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të IAL si Plani Strategjik për zhvillimin e programit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, si dhe RVB, GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të IAL. Gjithashtu kjo evidentohet edhe në dokumentin Plani Strategjik 2015-2020 (Seksioni 1, pika 1.1), sipas të cilit: “<i>UET synon shndërrimin në një qendër ekspertize në fushën e ... teknologjisë së informacionit ...</i>”.</p> <p>[Rregullore e UET]; [Plani Strategjik 2015 -2020]; [Plani Strategjik -2015-2020]</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>GVJ konstaton se në disa dokumenta të rëndësishme të dorëzuara nga IAL (të sipërpërmendura) janë të shprehura qartë dhe në mënyrë të detajuar drejtimit prioritar akademike të tij. Këtë e shohim të shprehur dhe në politikat e brendshme të IAL, sipas dokumentit “STUDIMI (periodik) PËR TREGUN E PUNËS”. Aspekti akademik dhe punësimi i studentëve mendojmë se janë ndër objektivat e rëndësishme të IAL, të cilat përveç politikave të shkruara, GVJ i sheh se janë jetësuar dhe në aktivitetet universitare.</p>

<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Drejtimi i Teknologjisë së Informacionit në përgjithësi në UET është ndër drejtimet e reja të ofruara nga ky IAL, krahasuar me degë të tjera të konsoliduara tashmë prej tij. Nga vetë natyra e kësaj disipline, GVJ mendon se programi i studimit të Masterit të Shkencave emërtohet, organizohet dhe ka strukturë të përputhur me drejtimet akademike të institucionit. Natyra e tij me profile është gjithashtu në kuadër të objektivave të IAL për të ofruara një strukturë unike në të gjitha drejtimet e tij (pra me profile të shumta). <i>GVJ sugjeron që përmbajtja e programeve me natyrë IT, të jetë në vëmendje të vazhdueshme nga IAL, për shkak të dinamikave të fushës.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Shkencat kompjuterike në përgjithësi janë pjesë e strategjive kombëtare të zhvillimit si një nga fushat prioritare të tyre. Kjo është në përputhje me trendet globale të zhvillimit, madje mund të themi se Shqipëria ka ende mungesë për specialistë të këtyre fushave. Programi Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile, vihet re që ofron disa nga pozicionet e rëndësishme të këtyre specialistëve.</p> <p><i>GVJ mendon se këto profile kanë një profil jashtë natyrës së përgjithshme të Informatikës dhe sugjerojmë ngushtimin e tyre në drejtime më të afërta teknike. Kjo do të lehtësonte dhe çështje të cilat lidhen me burimet njerëzore, me kapacitetet laboratorike, programet aplikative, etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Sipas Rregullores mësimore të programit të studimit, konstatojmë që ai është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimin, misionin dhe objektivat e institucionit për të përgatitur specialistë të kualifikuar dhe të aftë për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut edhe në zhvillimin perspektiv të tij. Për këtë, në Rregulloren Mësimore të Programit, pika 3.3.1, shprehet që programi synon të pajisë studentin me:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve b) parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar c) formim tematik apo historik* d) aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor e) përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit <p>Këto objektiva shihet se janë konsideruar në mënyrë të detajuar nga strukturat e brendshme të IAL përgjegjëse. Këto struktura mbështesin</p>

vendimet e tyre dhe nga Bordi i Tregut te punes, i cili përbëhet nga alumni të UET. Por, GVJ konstaton një shpërndarje të pjesëve të ndryshme përshkruese të objektivave dhe qëllimeve të programit master. GVJ ka shqyrtuar dokumentet e vëna në dispozicion nga IAL, bashkë me RVB (përfshirë Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit; Suplementet e Diplomave; Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit).

GVJ sugjeron që të rishqyrtohen, të rakordohen mes tyre dhe të plotësohen (vecanërisht Rregullorja e programit të studimit), për të pasur një pasqyrë të qartë për studentët që zgjedhin këtë degë dhe profilet përkatëse, si dhe institucionet e kontrollit të cilësisë së IAL.

Pavarësisht, meqënëse në dokumentacionin bazë të programit të studimit, elementët e mësipërm, si objektivat/qëllimet, objektivat formues, rezultatet e të nxënit, njohuritë dhe kompetencat e studentit në dalje të programit të studimit, pozicionet e punës ku të diplomuarit mund të punojnë etj, në tërësinë e dokumenteve të dorëzuara ato janë të përcaktuara.

**Këto shprehje vihen re në disa prej dokumenteve të dorëzuara nga IAL, ashtu si edhe në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, ku më shumë vlerësimi është i përgjithshëm dhe jo specifikisht për këtë program studimi. (p.sh. objektivat e një student IT, lidhen me shkencat shoqërore)*

Gjithashtu, në Planin Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit, objektivat janë tërësisht praktike (4 nga 8) dhe shumë më pak shkencore (1 nga 8: Lexo "Objektivat strategjike të programit"), gjë që në këndvështrimin tonë, duhet të ishte e anasjellta.

Këshillojmë që IAL të rishikojë "Prioritetet: Pika 1-Prioritete në aftësimin për kërkimin shkencor", në mënyrë që përmbajtja e kësaj pike të jetë tërësisht e orientuar ndaj zhvillimit të ideve të reja, kërkimit shkencor, analizës së të dhënave, metodologjive të ndryshme, etj.

Së fundmi, në suplementet e diplomave, Pika 4.2, Rezultatet e të nxënit të parashikuara për programin e studimit, vëmë re që ndryshimi mes 4 profileve është minimalist. Të paktën në këtë dokument të fundit të lëshuar për studentin, të nxirrej në pah më shumë vecantia e tij si profesionist dhe si studiues shkencor në këtë profil.

Në bazë të VKM 41/2018, elementët kryesorë që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në: kreditet; kontrolli i dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; objektivat formues dhe kompetencat profesionale; veprimtaritë formuese; kategoritë e veprimtarive formuese; plani mësimor; kuotat e pranimit; syllabuset; etj. Konstatojmë që, IAL këto elementë i ka në masën më të madhe të tyre, por i gjejmë të shpërndarë në dokumentë të ndryshëm. Specifikisht:

1. Objektivat e përgjithshëm janë në Rregullore e Programit
2. Objektivat strategjike janë tek Plani strategjik për zhvillimin e

	<p>programit. (objektivat formues nuk i gjejmë në ndonjë dokument)</p> <ol style="list-style-type: none"> 3. Qëllimet, plus përshkrimet dhe saktësimet e profileve dhe profesionet e mundshme janë vetëm tek Supplementet e Diplomave. 4. Mundësitë e punësimit janë edhe tek Plani strategjik i MSh. 5. Kurrikula është dokument me vete (shperndarja e lendeve sipas kategorive-ref 14) 6. Plani mësimor sipas semestreve (dokument me vete -ref 14.1) 7. Kriteret e pranimit janë dokument tjetër (ref. 27.1). Nuk ka ndarje Kriter i përgjithshëm, nga Kriter specific, etj. <p>GVJ sugjeron që IAL t'i përfshijë dhe t'i plotësojë elementët e domosdoshëm, sic e kërkon VKM, në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>[Plani strategjik për zhvillimin e programit] [Model diplome_suplement MSH Inxhinieri Informatike]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Duke pasur parasysh nevojat mjaft imediate që ka tregu i punës në Shqipëri, bazuar në strategjitë kombëtare si dhe në kërkesat e vetë studentëve për profilet me natyrë informatike, hapja e programeve që plotësojnë këto kërkesa është e domosdoshme. Në UET, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe nga vizita e kryer nga GVJ, u konstatua që ky institucion realizon studime dhe aktivitete periodike me të diplomuarit (Alumni i UET) si dhe ka të ngritur Bordin e Tregut të punës.</p> <p>Në dokumentin “Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit” ravijëzohen të gjithë analizat e nevojshme dhe argumentet e hapjes së programit të studimit. Në dokumentin “Studimi periodik për tregun e punës, pas daljes së studentëve”, pasqyrohet e njëjta përmbajtje si në dokumentin e kaluar, pra nuk konstatojmë reflektime të tjera në lidhje me programin e studimit. Mungojnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës, si dhe analiza konkrete të nevojës së kërkimit shkencor në këto fusha dhe specifiki në këto profile.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Qëllimi për përgatitjen e studentëve me njohuri bazë aplikative shprehet në RVB dhe në suplementet e diplomave, sipas të cilit misioni i programit është të formojë specialist të lartë. Në bazë të dokumentacionit, vecanërisht në Rregulloren Mësimore të Programit, mund të pranohen studentë, të cilët kanë përfunduar një diplomë të nivelit të parë, pra në këtë cikël mund të regjistrohen studentë nga cdo program bachelor. <i>Në këtë aspekt, duke qenë se aftësitë teknike të ofruara në këtë program kërkojnë një formim bazik paraprak, mendojmë që përmbajtja e programit të studimit duhet të konsiderojë edhe këtë fenomen, gjë që sjell krijimin e heterogjeniteti brenda grupeve mësimore. Sugjerojmë që IAL të rrisë gradën e objektivave të të</i></p>

	<p><i>nxënit si dhe të kërkimit shkencor të studentëve në këtë program studimi.</i></p> <p>Vlerësojmë përpjekjen e suksesshme të IAL për ruajtjen e të dhënave të Alumnit të tij, për përfshirjen e tyre në vendimmarrje, si dhe për komunikimin e vazhdueshëm me aktorë të tregut të punës, gjë që i ndihmon studentët të punësohen më lehtë.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Sipas RVB dhe konstatimit të GVJ programi i studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile është në përputhje me kriteret e Kartës të Bolonjës. Për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja, por, sipas kriterit, IAL nevojit të saktësojë konkretisht se cilit programi të ngjashëm të ofruar nga institucione ndërkombëtare, ai i është referuar. RVB shpreh në mënyrë të përgjithësuar që “për hartimin e programit janë marrë parasysh programet e ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja”, por nuk shprehet më qartë se cilin/cilët. Konstatohet që, për hartimin e programit janë konsultuar kurrikula të programeve të tjera të ofruara nga institucionet vendase dhe të huaja, si edhe është shfrytëzuar përvoja e personelit akademik të programit, një pjesë e të cilit ka studiuar/punuar jashtë vendit.</p> <p>GVJ konstaton që ky program ofron gjithashtu një strukturë të programit mësimor të ndarë në disiplina mësimore dhe veprimtari të tjera formuese sipas kategorive nga A-E. Zgjedhja e ofrimit të një programi master me një periudhë kohore 2-vjecare e ndarë në katër semestra ndihmon në daljen në treg të të diplomuarve, gjë që është në përputhje dhe me praktikën e mira të vendeve evropiane. Por, për studentët që planifikojnë të vazhdojnë studimet e thelluara në një nga profilet në ciklin e tretë të studimeve, kjo është një kohë e mjaftueshme për të përvetësuar aftësitë kërkimore, analitike, të mendimit kritik, etj, nëse shoqërohen me përmbajtjen e duhur të kurrikulës së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, përfshin në programin e tij të studimit një lëndë të mirëfilltë të dedikuar për praktikën profesionale, apo internship-in e studentëve pranë institucioneve të ndryshme publike dhe private. Vlejnë për tu përhëndetur një numër i lartë marrëveshjesh bashkëpunimi me kompani të vendit, apo dhe projekte me partnerë ndërkombëtarë, por tek këto projekte shihet një përfshirje e ulët e pjesëmarrjes së studentëve në detyra konkrete, angazhime profesionale, apo shkencore.</p> <p>[Mbi Praktiken Profesionale],</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga vizita e kryer në institucion, si dhe nga RVB, GVJ konstaton që programi është i licensuar dhe zhvillohet në gjuhën shqipe. Gjithsesi, në politikën e IAL është e përfshirë dhe mundësia e zhvillimit të lëndëve specifike në gjuhë të huaj, si pasojë e shkëmbimeve të studentëve nga programet Erasmus+.</p> <p>Në strategjinë e IAL për 2021-2025 shprehet objektivi për rritjen e</p>
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të</p>	<p>Në strategjinë e IAL për 2021-2025 shprehet objektivi për rritjen e</p>

kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.	përqindjes së ofertës akademike në gjuhën angleze, por ende nuk ofrohet në këtë program studimi.		
Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze	GVJ konstaton që IAL përgatit dhe arkivon dokumentacionin e programit të studimit edhe në gjuhën angleze, si p.sh. Syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit, Kurrikula: Plani Mësimor. [Syllabuset, në anglisht], [Rregullorja e programit, në anglisht], [Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Informatike, në anglisht], [Plani mesimor MSH Inxhinieri Informatike, në anglisht]		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi I.4

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile është ofruar nga Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, pranë UET.</p> <p>Në bazë të dokumentacionit të RVB, institucioni ka të angazhuar në këtë fakultet 26 PAE. Ndërkohë, në programin e studimit janë të angazhuar 14 lektorë (9 PAE dhe 5 PAK), nga të cilët pesë janë të kategorisë “Profesor”, 3 “Doktorë” dhe 1 me “Msc”. GVJ konstaton që një pjesë prej tyre janë nga departamente të tjera, gjë që tregon bashkëveprim mes njësive përbërëse të IAL në të mirë të organizimit të strukturave mësimore të programeve të ndryshme. Sipas Nenit 59/6 i Ligjit të Arsimit të Lartë, në programet e studimit Master është e domosdoshme që stafi të jetë me titull të paktën “Doktor” ose “Profesor”. Në programin Master i Shkencave në Inxhinieri Informatike me 5 profile, viti akademik 2020-21, janë 2 pedagogë me gradën “Master”, që mbulojnë 4 lëndë në këtë program. GVJ konstaton që lektorët e këtyre lëndëve kanë eksperiencë në mësimdhënie si dhe në tregun e punës, por kriteret ligjore janë pjesë esenciale e procesit të akreditimit dhe mirëfunksionimit të IAL.</p> <p>GVJ sheh si mjaft të rëndësishme shtimin e burimeve njerëzore si dhe rritjen e kapaciteteve në drejtim të lëndëve teknike të programit master, për të rritur dhe cilësinë e diplomës në përgjithësi. Nga vizita në IAL, në takimin me dekanin, përgjegjësen e departamentit dhe stafin, u vu re dhe u pohua nevoja për plotësimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore, por këto mbeten sfida të cdo departamenti me drejtim IT.</p> <p>[Lista e stafit akademik të deklaruar nga IAL, Programi i studimit Master Shkencor Inxhinieri Informatike]</p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton që fusha e studimit të Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore. Mendojmë që ristrukturimi i IAL dhe krijimi i fakultetit të ri me fokus inxhinierik, e ka kthyer vëmendjen e duhur dhe pozicionimin e këtij programi nën një njësi të përshtatshme.</p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Fushat e përgjithshme dhe specifike e programit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, konstatohet se është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. Edhe pse profilet e ndryshme të këtij programi ndërlidhen dhe me disiplina të tjera, pra nuk janë të gjithë profilet e tij drejtimet teknike në fushën e IT, shihet se pjesa tjetër plotësohet mjaft mire dhe nga lektorë të departamenteve të tjera, apo nga qendra kërkimore. Ky harmonizim besojmë se vjen si pasojë e historikut të shkuar të strukturave institucionale (pjesa e Fakultetit të Ekonomisë), por vlerësojmë që në vijim të ketë më tepër pavarësi nga departamentet e tjera, në mënyrë që programet të jenë më të linjëzuara brenda secilit profil. Gjithsesi, departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, i cili është përgjegjës për këtë program studimi, siguron përputhje mes disiplinave të ndryshme.</p> <p>Në lidhje me klasifikimin/kodifikimin e programit të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, IAL mbetet në pritje të akteve të tjerë ligjorë si dhe urdhrave nga organet kompetente.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se programi Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile mbështetet nga lëndë dhe staf të cilat mbulohen dhe nga departamente të tjera. Kështu përmendim që, përveç vetë departamentit “Informatikë dhe Teknologji”, përfshihen në procesin mësimor dhe Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe Departamenti “Menaxhim dhe Marketing”. Nga kjo ndërthurje kuptojmë një marrëdhënie të mirë ndër-institucionale në funksion të plotësisht të programit master.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e</p>	<p>Sipas shpjegimeve të dhëna gjatë vizitës, GVJ konkludon që përveç institucioneve publike e private, IAL ka vendosur marrëdhënie të mira dhe me institucione homologe në shtete të ndryshme, si pasojë e pjesëmarrjes në projekte si partner.</p>

biznesit vendës dhe/ose të huaj.	
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>GVJ evidentoi se institucioni ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione, organizata profesionale dhe biznese të ndryshme. Në bazë të dokumentave, janë dorëzuar 11 marrëveshje bashkëpunimi mes IAL dhe kompani e institucione të rëndësishme në vend si p.sh. Infosoft, Dhoma e Tregëtisë e Industrisë, etj. Në bazë të Raportit të Përfitimit nga Marrëveshjet e Bashkëpunimit, vihet re dhe një fokus të rëndësishëm në aktivitetet dhe partneritetet në fushën e IT.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Qëllimi dhe objektivat e këtyre marrëveshjeve kishin në fokus realizimin e objektivave të programeve të studimeve për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave mësimore apo organizimin e trajnimeve profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit. Fokus i tyre janë dhe internshipet e studentëve, e në fakt një pjesë e studentëve i kanë ndjekur. Në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL, 24 studentë kanë kryer praktikat e tyre mësimore në institucione të ndryshme publike dhe private.</p> <p>Sipas RVB, kompanitë që janë anëtare të Bordeve të Punës pranë Departamenteve në UET, janë shprehur të hapura në bashkëpunim për internshipet, bordet e punës, leksionet e hapura dhe vizitat në kompani. Në këtë dokument shprehet se universiteti do të vijojë orientimin në bazë të kërkesave të tregut dhe në përputhje me strategjitë për zhvillimin kombëtar, duke mos e përjashtuar mundësinë e përditësimit të kurrikulave. GVJ e vlerëson si pozitive këtë praktikë.</p> <p>Në bazë të RVB, por edhe nga saktësimet e konstatuara gjatë vizitës në institucion, GVJ vlerëson se institucioni bashkëpunon me një sërë aktorësh dhe institucionesh. Projekti 250+ e më pas 500+ ka qenë një ndihmesë e rëndësishme në këtë aspekt.</p> <p>[Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe INSTAT], [Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe ITD], [Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe AWARD GROUP] [Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe E.H.W], [Marreveshja e Bashkepunimit mes UET dhe Infosoft], [Marreveshje Bashkepunimi mes EEI & Balfin], [Marreveshje Bashkepunimi mes UET dhe AMF], [Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe WE WEB], [Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe MicroTIK], [Memorandum Bashkepunimi mes UET dhe UnionBank], [Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi organizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e IT dhe Inovacionit, apo konferencat, projektet etj. Ndërkohë që shumë pak flitet për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve, sic janë të kërkuara në këtë kriter. Dokumenti i referuar nga RVB për këtë kriter, “Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit” liston institucionet qeveritare bashkëpunuese, por fokusi kryesor i tij është tek mundësia e praktikës nga</p>

	ana e studentëve. Ndërkohë, tek “Marrëveshje bashkëpunimi UET”, renditen 94 IAL partnerë të huaj, 15 IAL vendase, si dhe 20 institucione të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Duke u bazuar tek dokumentat e vëna në dispozicion GVJ mendon se njësia përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, realizon raporte të përfitimeve. Ndërkohë sipas RVB, në dokumentin e referuar (Ref: Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, Nr. 35), GVJ cilëson që kjo analizë duhet të jetë më e thellë si dhe me natyrë më analitike, pasi duhet të pasqyrojë konkluzionet, realizimet, ndryshimet, pritshmëritë e një viti akademik. Dokumenti i dorëzuar nga IAL, të cilit RVB i referohet, nuk është një dokument periodik, pavarësisht se ka vlerën e tij si punë e kryer për pasqyrimin e praktikave të studentëve. Në këtë analizë, ashtu si edhe në dokumentet e tjera, RVB dhe IAL duhet tu referohet si programit në tërësi, ashtu dhe profileve në vecanti.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	<p>Sipas Statutit të UET, ky institucion ka si objektiv dhe promovon kualifikimin e mëtejshëm të stafit të tij. Një pikë e rëndësishme e këtij objektivi është pjesëmarrja në projekte, e për pasojë në aktivitete të përbashkëta me stafe të institucioneve të tjera, ku kërkimi shkencor është në përgjithësi primar.</p> <p>RVB shpreh që IAL promovon dhe mbështet mobilitetin e stafit, sipas referencës “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit”. Për vitin akademik 2019-2020, IAL ka marrë pjesë si partner në disa projekte, si dhe ka realizuar mobilitetin e studentëve.</p>
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Sipas Statutit të UET (Kreu III, Pika 20.7), IAL ka përcaktuar si një njësi të vecantë Qendren Kërkimore Shkencore, e cila drejtohet nga një person akademik, që emërohet me mandat 4 vjeçar. Ai ka si detyrë të udhëheqë dhe kontrollojë realizimin e programit, si dhe bën vlerësimin e punës shkencore të anëtarëve të qendrës.</p> <p>GVJ nuk disponon një dokument tjetër, përveç Statutit të UET, si dhe RVB, që shpjegojnë më detajisht organigramën e kësaj qendre, detyrat e saj, impaktin, vlerësimet, si dhe pozicionimin e saj në hierarkinë e IAL dhe në vetë fakultetin e departamentin e programit të studimit. Konsiderojmë si të rëndësishme për vlerësimin e kriterëve dhe standardeve nga RVJ, që përmbushja e tyre nga IAL të shprehet në terma konkretë nga grupi i hartimit</p>

	të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, sic ato ndodhin konkretisht në jetën akademike e universitare të UET, që sic evidentohet nga vizita, ne konstatojmë që në pjesën më të madhe nuk i mungojnë kësaj IAL.								
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	GVJ konstaton që IAL organizon aktivitetin “Ditët e Studimeve Shqiptare” (prill, 2021), në panelin 4 të së cilit fokusi ishte “ <i>Influence of technological innovations on industry and services</i> ”. RVB shpreh që IAL ndjek një politikë shpërblyese për personat e angazhuar në veprimtari kërkimore shkencore.								
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Pavarësisht kësaj, IAL i kushton një vend të vecantë çështjeve të etikës dhe integritetit akademik, përdor programe të posacme për çështje të plagjiaturës së temave master ose tezat e doktoraturës, si dhe aktivizon UET Press për botimin e titujve të ndryshëm, pronë intelektuale e IAL. Politikat që ndjek IAL paraqiten në dokumentin Nr. Ref. 54. Kodi i Etikës, në veçanti Pika A.II.7.1								
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Në programin e studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, studentët ndjekin lëndën Metoda Kërkimi të Avancuara, si dhe në lëndë të ndryshme kryejnë detyra që nxisin krijimtarinë e tyre shkencore. Gjithsesi, për një program të tillë, kjo nuk do të mjaftonte. Sugjerojmë që IAL të konceptojë aktivitete të tilla, si konferenca studentore, projekte jo vetëm shkëmbimi, botimin e temave të mira të diplomave, kryerjen e analizave të ndryshme të problemeve/sistemeve/zgjidhejeve softuerike/ të të dhënave konkrete, etj. (p.sh. numri i studentëve të aktivizuar për projekte shkencore në rang departamenti është 0 – “Tabela përmbledhëse për Aneks RVB”)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të	Sipas dokumentacionit të referuar (Kurrikula e Programit, Plani mësimor dhe Rregullorja e Programit të Studimit), programi Master i Shkencave “Inxhinieri

<p>vlerësuar në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Informatike” me 5 profile, është e organizuar në module të vlerësuar në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Për një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një semestri është 30 kredite, kurse në total programi master në fjalë ka 120 kredite.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Në dokumentacionet e dorëzuara nga IAL me 5 profile nuk vërehet një saktësim i pozicioneve të mundshme të punës të specialistëve të IT të cilët diplomohen në programin e studimit. Ndërkohë, në Rregulloren Mësimore të Programit të studimit janë të caktuara Lista e Profesioneve/ Mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve në Informatikë e Aplikuar, si:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Oficer i sigurisë së Sistemeve të Informacionit 2. Administrator baza të të dhënave 3. Menaxher i projekteve IT 4. Menaxher i sistemeve të informacionit. <p>GVJ vëren se ka një ndryshim p.sh midis listës së pozicioneve të punës të ofruar si më lart në Rregulloren Mësimore të Programit, dhe përmbajtjes së ndodhur tek Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit.</p> <p>Në të gjithë dokumentet e rëndësishme të programit të studimit, apo të njësisë bazë, nuk ka një detajim të profileve, një përshkrim të secilit, shoqëruar kjo me aftësitë, objektivat, mundësitë e punësimit, etj. Për GVJ kjo është kaotike dhe e tillë është dhe për studentët. Kjo u shpreh dhe gjatë vizitës në IAL.</p> <p>Si një burim tjetër, GVJ ka shqyrtuar suplementet e diplomave të të pesë profileve të ndryshme.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Profili “Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh”: “...mbajtës i diplomës me këtë profil është i aftë të përdorë teknologjitë më të reja në fushën e IT për të bërë të mundur realizimin e aplikimeve të reja në sektorë të ndryshëm, të përdorë platformat e raportimit dhe menaxhimit të riskut...”. 2. Profili “Inxhinieri Software-sh”: “...mbajtës i diplomës me këtë profil është i aftë për të kontribuar në hartimin e softuerëve, të domosdoshëm për organizatat, duke qenë të aftë të dizenjojnë e zhvillojnë softuerë dhe aplikacione, menaxhojnë Big Data, të aplikojnë IA, etj....”. 3. Profili “Siguria e Sistemeve të Informacionit”: “...mbajtësi i diplomës me këtë profil është i aftë të kontribuojë në ruajtjen e sigurisë së informacionit, sistemeve dhe rrjetave kompjuterike, menaxhimin e riskut në IT dhe kriptografi...”. 4. Profili “Menaxhim të dhënash”: “...mbajtësi i diplomës me këtë profil do të jetë i aftë të përdorë teknologjitë më të reja në fushën e IT për të bërë të mundur realizimin e aplikimeve të reja në sektorë të ndryshëm, të përdorë platformat e raportimit dhe menaxhimin e Big Data...”.

	<p>5. Profili “Menaxhim dhe vlerësim projektsh”: “...mbajtësi i diplomës me këtë profil do të jetë i aftë të menaxhojë realizimin e projekteve softwerike duke siguruar menaxhimin optimal të kostove, burimeve njerëzore dhe kufizimeve kohore, nëpërmjet harmonizimit të njohurive në fushën IT dhe menaxhim...”.</p> <p>Pavarësisht kësaj, GVJ beson se ky program studimi formon njohuri të vecanta në fushën e IT e mund të jetë i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm për të filluar në pozicione specialist junior ose të mesëm, analist sistemesh, konsulencë, në atë të menaxhimit të projekteve, etj. Gjithsesi, sërish përmendim që nevojitet një rishikim i gjithë dokumenteve përshkruese e analizuese të programit të studimit, që të jenë të gjitha në një linjë si dhe të ofrojë qartësi për të gjitha palët.</p> <p>Në faqen ueb të IAL, në pasqyrimin e listës së plotë të lëndëve të programit të studimit dhe të profileve, përvec profilit të fundit “Menaxhim dhe vlerësim projektsh”, profilet e tjera bashkëndajnë 8 lëndë të ndryshme për 12 pozicione lëndësh (pra 4/12 përsëriten mes profileve), duke i shtuar një përqindje jo të vogël përafri së mes tyre dhe diplomave që dalin në treg.</p> <p>Në faqen ueb të IAL, në programin Master Shkencor “Teknologji Informacioni”, GVJ konstaton një përafri tjetër mes 4 profileve të ndryshëm që ofron ky program studimi si dhe 5 profileve të “Inxhinierisë Informatike” (duke përfshirë profilin “Siguria e Sistemeve të Informacionit”). Sugjerojmë që oferta akademike e programeve të studimit në IAL, të mbështetet mbi një kërkesë konkrete dhe reale që vjen nga tregu i punës, nga aktualiteti shqiptar, nevojat e kërkuesve shkencorë si dhe institucioneve mbështetëse e jo për hir thjesht të diversifikimit të portofolit të titujve të ofruar.</p> <p>[Link: https://uet.edu.al/neë/wp-content/uploads/2018/10/Msc.-Inxhinieri-Informatike.pdf]</p> <p>[Link: https://uet.edu.al/neë/wp-content/uploads/2018/10/Msc.-Inxhinieri-Informatike.pdf]</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile të ofruara prej tij jep njohuri konceptuale dhe praktike në fushën e IT të aplikuar në proceset e ndryshme të bizneseve apo sipërmarrjeve të tjera. Gjithashtu, ky është një program i orientuar nga praktika më shumë se ana akademike. Gjithsesi në përbërje të strukturën së tij ofrohen lëndë të cilat nxisin të kuptuarit kritik dhe parimet akademike, vecanërisht lëndët e kategorisë A. GVJ konstaton një përpjekje mjaft të mirë të IAL në përfshirjen e studentëve në tregun e punës, apo në orientimin e tyre drejt aktiviteteve apo detyrave me natyrë profesionale. Por, programi i studimit sugjerohet të krijojë kushte lehtësuese për studentët në kryerjen e hulumtimeve, si dhe ndjekjen e metodave shkencore e të aplikueshme në Informatikë.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Sipas GVJ, ky program ka objektiva të caktuara përsa i përket formimit të studentëve dhe kompetencave profesionale. GVJ konsideron që programi</p>

<p>paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, ofron njohuri dhe aftësi të mira (por jo te avancuara) qoftë menaxheriale apo teknike në profilet e vecanta.</p>																																				
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ vlerëson programin e studimit si të hartuar në përputhje me të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. Kjo përputhje vërtetohet në bazë të dokumentave të vënë në dispozicion, si Rregullore e UET, pika 3.8, si dhe në Statutin e IAL, të hartuar në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015.</p>																																				
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke iu referuar Rregullores Mësimore të Programit të Studimit dhe verifikuar nga RVB, GVJ vë re që lëndët në përmbajtje të kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”. Studenti merr:</p> <ul style="list-style-type: none"> - në Kategorinë A 12 kredite (2 lëndë), - në Kategorinë B 60 kredite (10 lëndë), - në Kategorinë C 18 kredite (3 lëndë), - në Kategorinë D 12 kredite (1 lëndë), - në Kategorinë E 18 kredite (1 lëndë), <p>Cdo lëndë ka 6 ECTS. Kategoria C përbëhet nga lëndë të ndryshme që formojnë dhe karakterizojnë 5 profilet.</p> <p>GVJ konstaton që nga 120 kredite, 5 profilet ndryshojnë në vetëm 18 kredite, pra 15%, e cila në vlerësimin tonë është brenda kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 41, sipas së cilës, për programet Master kjo përqindje duhet të jetë 12-20%. Sugjerojmë që kjo përqindje të jetë më e lartë, ose të shtohet një lëndë tjetër e profilit.</p> <p>Por, nëse shohim përmbajtjen e lëndëve të profilit, duke qenë se, sic përmendëm dhe më lart, profilet bashkëndajnë lëndë mes tyre, vëmë re që, kreditet e ndryshme mes 5 profileve (emërtuar për lehtësi P1 – P5), janë si në matricën e mëposhtme:</p> <table border="1" data-bbox="734 1541 1327 1809"> <thead> <tr> <th></th> <th>P1</th> <th>P2</th> <th>P3</th> <th>P4</th> <th>P5</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <th>P1</th> <td>-</td> <td>12</td> <td>12</td> <td>12</td> <td>18</td> </tr> <tr> <th>P2</th> <td>12</td> <td>-</td> <td>18</td> <td>12</td> <td>18</td> </tr> <tr> <th>P3</th> <td>12</td> <td>18</td> <td>-</td> <td>12</td> <td>18</td> </tr> <tr> <th>P4</th> <td>12</td> <td>12</td> <td>12</td> <td>-</td> <td>18</td> </tr> <tr> <th>P5</th> <td>18</td> <td>18</td> <td>18</td> <td>18</td> <td>-</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në bazë të kësaj matrice simetrike (ku për lehtësi janë afishuar të gjitha kombinimet), GVJ konstaton që përveç profilit P5 – Menaxhim dhe vlerësim projektesh, të gjithë profilet e tjerë e përmbushin pjesërisht kriterin e</p>		P1	P2	P3	P4	P5	P1	-	12	12	12	18	P2	12	-	18	12	18	P3	12	18	-	12	18	P4	12	12	12	-	18	P5	18	18	18	18	-
	P1	P2	P3	P4	P5																																
P1	-	12	12	12	18																																
P2	12	-	18	12	18																																
P3	12	18	-	12	18																																
P4	12	12	12	-	18																																
P5	18	18	18	18	-																																

	<p>përcaktuar në VKM nr. 41. Diferenca me 12 ECTS, do të thotë që diferenca mes profileve, të kombinuar me njëri-tjetrin në forma të ndryshme, është e barabartë me 10%.</p> <p><i>Sugjerojmë që për secilin profil të hartohet nga një "Strukturë mësimore" e detajuar, e cila shpjegon që nga qëllimet e objektivat, tek kategoritë e lëndëve, ndarjen e tyre sipas semestrave (gjë që mungon në të gjithë dokumentet e IAL për këtë program studimi), e deri tek punësimi dhe mundësia për të vazhduar më tej në ciklin e tretë të studimeve, mbi të gjitha duke vënë theksin dhe tek diferencat teknike, profesionale e akademike mes tyre.</i></p>			
Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	<p>Sipas dokumentit "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit", studentët mund të njihen në lidhje me të gjithë procesin e administrimit të diplomës.</p> <p>Ky aktivitet ka të parashikuar ngarkesën të shprehur në 18 kredite.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Universiteti European i Tiranës është akredituar me Vendim BA Nr. 12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022. Pas riorganizimit të njërive kryesore nga 3 fakultete në 5 fakultete UET akreditohet me Vendim BA Nr. 46, datë 05.07.2019 me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.</p> <p>Programi i studimit akreditohet për herë të parë.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton që departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, njësi bazë e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529, datë 04.09.2018, zhvillon të gjitha veprimtaritë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstaton që Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, i hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 529, datë 04.09.2018, ka në përbërje tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë; 2) Departamenti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës; 3) Qendra për Zhvillimin e Teknologjisë dhe Inovacionin. <p>Kjo strukturë është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.</p> <p>[Statuti i UET], Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit</p>

dhe Departamentit], [URDHER Nr.527,date 04.09.2018, Riorganizimin e Fakulteti i Ekonomise]. URDHER Nr.529,date 04.09.2018,Hapjen e njesise kryesore Fakulteti i Inxhinierise]

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Sipas VKM nr. 418, pika XI, shprehet që “çdo njësi kryesore duhet të ketë, të paktën, tre njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respective”. Në pikën XII: “Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të tij, të paktën, 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik”, kriteret të cilat IAL i plotëson.

Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë përbëhet nga 8 anëtarë të personelit akademik të brendshëm për vitin 2020-2021. Të dhënat për stafin e DIT për tre vitet e fundit akademike, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor	2		1		1	1
Prof. Asoc	1	1	1	3		1
Doktor/Docent	2	9	3	3	3	4
Msc.	4	6	5	4	4	2
Gjithsej	9	16	10	10	11	8

Në këtë departament, pas sugjerimit për rritjen e numrit të stafit efektiv, GVJ sugjeron dhe përmirësimin e raportit mes lektorëve me titull MSc. dhe gjithë kategorive të titujve të tjerë. Vëmë re që për vitin 2020-2021, tek lista e PAE, 50% e stafit janë me MSc, e po ashtu në vitet e tjera. Ky nuk është një kriter i ngurtësuar në aktet ligjore e nënligjore, por mbetet një sugjerim për t'u konsideruar, meqënëse DIT ofron një numër programesh Master (të Shkencave dhe Profesionalë) – si programi në fjalë.

Gjithashtu, vëmë re një ulje të numrit të personelit në përgjithësi, nga viti 2018-2019, përkatësisht 25, 20, 16 (në totalin e PAE + PAK). Kjo tendencë gjithashtu duhet të shihet me prioritet nga DIT.

Të dhënat për Fakultetin e i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, ku bën pjesë programi i studimit janë:

Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës	2020-2021	
	PAE	PAK
Profesor	5	3
Prof. Asoc	2	6
Doktor/Docent	7	10
Msc.	12	6
Gjithsej	26	25

Gjithashtu, në të njëjtën VKM janë përcaktuar ngarkesa e personelit

	akademik me kohë të plotë, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore. [Të dhënat tabelore për personelin akademik] (ref. 24)								
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe të shprehur në RVB, konstatohet nga GVJ që për zhvillimin e praktikave profesionale nuk është i angazhuar personel akademik ndihmës, por është ngarkuar një pedagog i brendshëm i departamentit, koordinatori i tij.								
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Për programin Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, pranë Universitetit European të Tiranës, si koordinator i programit të studimit, është caktuar një lektor me titull Prof. Dr. me vendim Nr. 36, datë 14.4.2021, të Dekanatit të Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, “Për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit”. Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET.								
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Sipas dokumentit “Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit”, në pikën F.V.5.2, listohen kompetencat kryesore të përgjegjës të grupit mësimor/koordinatorit, ndër të tjera dhe ai i hartimit të raportit periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional. Kriteri 7 cilëson dhe dokumentimin e çdo informacioni që lidhet me programin e studimit nga ana e koordinatorit, gjë që nuk gjendet në listën e detyrave të koordinatorit në dokumentin e dorëzuar nga IAL.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.3 Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se njësitë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, disponojnë të gjithë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e tij. Këto gjenden në Statutin e UET, tek Rregullorja Mësimore e Programit, apo aktet e vendimet e tjera. Një pjesë e konsiderueshme e këtij informacioni gjendet dhe në faqen zyrtare online të IAL (https://uet.edu.al)
Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se programi i studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Këto të

Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.

dhëna detajohen edhe në kurrikulën dhe rregulloren e programit të studimit, sipas së cilës, ky program zhvillon gjithsej 17 lëndë në katër semestra, të ndara si më poshtë:

Semestri I (5 lëndë)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Metoda kërkimi të avancuara 2. Aplikimi i Sistemeve të Informacionit 3. Projektim dhe Analizë e Bazave të të Dhënave 4. Arkitektura dhe Inxhinierimi i Sistemeve 5. Menaxhim i Sistemeve të Informacionit
Semestri II (5 lëndë)	<ol style="list-style-type: none"> 6. Menaxhimi i Rrjetave Kompjuterike 7. Dizenjim dhe Zhvillim i Sistemeve IT 8. Inxhinieri Softwerike 9. Menaxhim Strategjik 10. Sistemet e Shpërndara (Profili “Inxhinieri Softweresh”) 10. Kontrolli dhe auditimi i sigurisë në rrjetat kompjuterike (Profili “Siguria e Sistemeve të Informacionit”) 10. SQL server dhe platformat e raportimit (Profilet “Menaxhim të dhënash” ; Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh) 10. Aftësi Manaxheriale (Profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”)
Semestri III (4 lëndë)	<ol style="list-style-type: none"> 11. Kërkime Operacionale 12. Zhvillim Webi: aplikime dhe programim 13. Inteligjenca artificiale 14. Menaxhim i riskut në IT (Profilet “Inxhinieri Softweresh”; Siguria e Sistemeve të Informacionit”; “Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh”) 14. Administrim Baza të Dhënash (i avancuar), (Profili “Menaxhim të dhënash”) 14. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh (Profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”)
Semestri IV (3 lëndë)	<ol style="list-style-type: none"> 15. Menaxhim në Big Data (Profilet “Inxhinieri Softweresh”; “Menaxhim të dhënash”) 15. Kriptografia dhe Ethical Hacking (Profili “Siguria e Sistemeve të Informacionit”) 15. Zhvillim i avancuar i softwerëve (Profili “Dizenjim dhe zhvillim aplikimesh”) 15. Vlerësim ekonomik projektsh (Profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”) 16. Praktikë Profesionale 17. Punimi i diplomës

	<p>[Statuti i UET], [Rregullorja Mësimore e Programit Master]; [Faqja zyrtare online të IAL].</p> <p>[Link:https://uet.edu.al/new/wp-content/uploads/2018/10/MSc.-Inxhinieri Informatike.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në dokumentin “Plani mësimor MSH Inxhinieri Informatike”, paraqitet vetëm tabela e numrit total të orëve të: Leksione, Seminare, Ushtrime/Projekte, Praktikë Profesionale, Punimi i diplomës.</p> <p>Rregullat për frekuentimin si dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve janë të pasqyruara dhe në programet e vecanta lëndore, si dhe në Rregulloren Mesimore të programit. Në bazë të dokumentacionit, IAL përcakton një nivel frekuentimi të mësimit prej 80% të kohës për programet e ciklit të dytë.</p> <p>IAL nuk ka një plan mësimor në një dokument të vetëm për programin e studimit MSH Inxhinieri Informatike me 5 profile, por i ka ato të shpërndarë në disa dokumente.</p> <p>[Syllabuset e lëndëve], [Plani mësimor MSH Inxhinieri Informatike] (ref. 14.1)</p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në lidhje me informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit, GVJ konstaton se ato janë të paraqitura dhe të detajuara në Rregulloren Mësimore të Programit. Konkretisht, për kriteret e pranimit kërkesat janë të saktësuara në Kreun 2, për transferimet dhe ekuivalentimet në Kreun 9. Për të rregulluar më tej procesin e transferimeve IAL ka vënë në dispozicion dokumentin “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve”, sipas të cilit UET pranon dhe lejon transferimin e studentëve drejt dhe nga ky institucion.</p> <p>GVJ konstaton se në kriteret e pranimit nuk ka rregulla specifike, pra kushte paraprake për regjistrimin e studentëve. Kjo rregullore nënkupton që këtë program mund ta ndjekin studentë nga çfarëdo programi bachelor.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në bazë të RVB dhe dokumentacionit të dorëzuar, GVJ konstatoi që informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në programin lëndor të detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Syllabuset hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse (Shtojca Nr. 2 e VKM Nr. 41, datë 24.01.2008 “Për elementët e programeve të studimit”. Të gjitha lëndët janë të përfshira në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL.</p> <p>Në dokumentin “Formati i Syllabusit Cikli i Parë dhe i Dytë” (ref. 19.1), IAL ka miratuar formatin e përgjithshëm të programeve lëndore, ku përfshihen: të dhëna të përgjithshme të kursit; përmbledhje dhe rezultatet; konceptet themelore; temat e kursit; forma e kontrollit të dijeve; literatura (bazë dhe e detyrueshme); vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës.</p>

	Programet konsultohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe miratohen nga drejtuesi i departamentit.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	<p>GVJ konstatoi në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe nga vizita në institucion gjatë takimeve me anëtarë drejtues të njësive bazë dhe kryesore se programet mësimore dhe përmbajtjet e tyre lëndore janë në përmirësim të vazhdueshëm. Kjo konsiderohet si një aspekt pozitiv dhe shpesh i domosdoshëm për profile teknike si ai i Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile. GVJ gjithashtu vuri re se një nga arsyet e bashkëpunimit të Bordit të Punës, të përbërë nga alumni të UET, me strukturat e IAL ishte pikërisht mundësia e përmirësimit të programeve sipas asaj çfarë tregjet e punës kërkojnë për këto drejtime.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit, pika 10, parashikohet se Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Programet lëndore përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri, për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit për studentët. Sipas shpjegimeve gjatë vizitës, ato kontrollohen dhe nga Zyra e Cilësisë së IAL.</p> <p>Nuk ka një dosje në anglisht për këtë program studimi, pasi është licensuar në gjuhën shqipe. Nuk ofrohen lëndë specifiku në këtë gjuhë.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësim	Përmirësim pjesërisht	Përmirësim kryesisht	Përmirësim plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>GVJ evidentoi që ngarkesa e programit të studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike është në përputhje me nenin 75, pika 6, të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i cili përcakton se programet profesionale organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. Nga Plani mësimor del sel se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për leksionet 1 kredit është ndarë në 11.2 orë në auditor/13.8 orë punë e pavarur - Për seminaret 1 kredit është ndarë në 7 orë në auditor/18 orë punë e pavarur - Për projektet 1 kredit është ndarë në 12 orë në auditor/13 orë punë e pavarur - Për praktikën mësimore 1 kredit është ndarë në 21.3 në auditor dhe 3.7

	<p>punë e pavarur.</p> <p>- Për punimin e diplomës 1 kredit është ndarë në 2 orë në auditor/23 orë punë e pavarur.</p> <p>Në lidhje me raportet mes orëve në auditor dhe punës së pavarur, GVJ konstaton që ato ruhen në mënyrë të kënaqshme, me përjashtim të projekteve dhe praktikës mësimore, ku orët e pavarura duhet të jene më tepër se ato në auditor.</p> <p>[Plani mësimor MSH Inxhinieri Informatike]</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ, pas një shqyrtimi të detajuar të përmbajtjeve të veprimtarive dhe të emërtimeve të tyre, të shpërndarjes së lëndëve dhe ndarjes së tyre në profilet përkatëse të programit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile është i mendimit se disa lëndë duhet të rishikojnë përmbajtjen e tyre në syllabus-et përkatës. Kështu p.sh. GVJ sugjeron:</p> <p>I. <u>Korigjime në emërtimet e lëndëve</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Të hiqen termat “E avancuar”, p.sh. lënda që diskuton për metodat e kërkimit, duhet të saktësohet në program edhe arsyeja e përcaktimit “të avancuara”, pra çfarë ka më tepër kjo lëndë se sa thjesht lënda/drejtimi “Metoda Kërkimi”. 2) Lënda “Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit” që vjen nga Management Information Systems, duhet të emërtohet si “Sistemet e Informacionit të Menaxhimit”. 3) “Kriptografi dhe Ethical Hacking” është bashkim i dy disiplinave apo moduleve mjaft të gjera brenda Sigurisë së Informacionit. Do të rrezikohet që dija në to të jepet në mënyrë sipërfaqësore, por, në përmbajtje të temave përgjatë javëve, kjo lëndë është vetëm Kriptografi. Sugjerojmë ndryshimin e emrit ose të temave. 4) Lënda “Menaxhim në Big Data” – titulli duhet riformuluar (p.sh. “Menaxhim i Big Data”, ose “Hyrje në Big Bata”). Lënda është shumë teorike e ndërkohë mund të ofroheshin një mori ushtrimesh praktike e aplikime të të dhënave në këtë fushë. Literatura duhet të azhurnohet. 5) Lënda “Zhvillim uebi: aplikime dhe programim”, GVJ sugjeron riemërtimin si thjeshtë “Programim në ueb”. <p>II. <u>Korigjime në brendinë e lëndëve</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 6) Në brendësi të programeve lëndore të detajohen orët/pjesët praktike në mënyrë më konkrete. 7) Lëndët në përgjithësi kanë nevojë për një rishikim të përmbajtjes së tyre në mënyrë që të eliminohen përsëritjet (sidomos temat dhe syllabus-et që lidhen me bazat e të dhënave), të jenë të linjëzuara në të gjithë planin e programit mësimor, si dhe të zgjidhen në mënyrë të tillë, që të jenë saktësisht thelbi i



secilit prej profileve. P.sh.

- a. lënda “Menaxhimi i riskut në IT”, shihet më shumë si lëndë e mirëfilltë në Siguri Informacioni ose Sistemesh Kompjuterike;
- b. lënda “Aplikimi i Sistemeve të Informacionit” është në përmbajtjen e saj “Inxhinierim softesh” e pastër e për pasojë GVJ sugjeron riemërtimin e saj;
- c. lënda “Zhvillim i avancuar i softuerëve” është në përmbajtjen e saj vetëm “Programim në platformat mobile”, si dhe lënda SQL server dhe platformat e raportimit – në syllabus ofrohet në semestrin e parë, duhet rregulluar e të përshtatet me kurrikulën. Përmbajtja është qartësisht “Data Mininig”, prandaj GVJ rekomandon të ndryshohet titulli i lëndës, ose të ndryshojnë temat.

III. Azhornimi i literaturës që për profilet IT mund të jetë mjaft problematike.

- 8) Syllabusi i lëndës “Metoda Kërkimi të avancuara” – ka literature mjaft e vjetër. Në syllabus kjo lëndë nuk përmend që i ofrohet programit MSH Inxhinieri Informatike. Sic edhe e përshkruan vetë, kjo lëndë *aftëson studentin me metodologjitë bazë në shkencat sociale dhe ekonomike*. Ato vërtetë vlejné dhe mund të përafrohen me shkencat natyrore apo inxhinierike, por ndryshimi është vecanërisht i dukshëm në fushat e aplikimit të tyre.

IV. Pasaktësi/mospërputhje në dokumentacion

- 9) Lënda “Kërkime operacionale në syllabus” cilësohet që jepet në vitin e parë, semestri i parë (nuk përputhet me kurrikulën).
- 10) Syllabusi i lëndës “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” (Profili “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”) – në syllabus emërtohet si “Hartim dhe menaxhim projektsh”, i dorëzuar nga IAL për MSH “Inxhinieri Informatike” është i nivelit BA. Si syllabus është shumë i mirë dhe bashkëkohor, i përshtatshëm dhe për programet MSH, por duhet azhurnuar si dhe përshtatur detyrimet e këtij cikli.
- 11) Ka disa lëndë që lektorët që japin lëndën dhe në syllabus nuk përputhen emrat me ato të evidentuara në listat e departamentit për lëndët e ndryshme.:
 - a. Dizajnimi dhe Zhvillim i sistemeve IT (mungon P. P. në tabelë)
 - b. Aplikimi i sistemeve të informacionit (mungon A. K. në tabelë)
 - c. Kontrolli dhe auditimi i sigurisë në rrjetat kompjuterike (mungon A. K. në tabelë)
 - d. Vlerësim ekonomik projektsh (në syllabus e jep V. K., në departament

A. Xh.)

e. Zhvillimi i avancuar i softëerëve (mungon M. D.)

V. Përvec këtyre sugjerimeve, GVJ liston më poshtë dhe aspekte që lidhen me lëndët vec e vec:

- 12) Syllabusi i lëndës “Dizenjim dhe zhvillim i sistemeve IT” është kaotik në përmbajtje. Ka ngjashmëri konceptuale me lëndën “Aplikimi i sistemeve të informacionit”, por temat janë specifike në komponentë të dizenjimit të një sistemi, duke bërë kapërcime që nuk lidhen mirë mes komponentëve të ndryshëm të stack-ut të zhvillimit të një produkti web-based.
- 13) Syllabusi i lëndës “Inxhinieri Softuerike” tenton të ndërtojë një strukturë tjetër të qasjes ndaj procesit real të inxhinierimit të një produkti softuer duke anashkuar kalimin natyror nëpër fazat e tij, por duke u përqëndruar në çështje më të avancuara (që për këtë program studimi mund të jenë përtej nevojave dhe aftësive). Gjithashtu, nga 13 tema me përmbajtje teknike, 4 të parat janë të dedikuara për “Design Patterns” që është një qasje e debatueshme në qarqet e inxhinierëve të softit, edhe pse padyshim ka vlerat e veta teknike. Ndoshta kjo zgjedhje është bërë, pasi studentët kanë si lëndë të detyrueshme “Aplikimi i Sistemeve të Informacionit”, që konkretisht është në përmbajtje “Inxhinieri Softuerike”, por GVJ sugjeron që të mos krijohen keqkuptime në konceptet themelore të dijës tek studentët. Dhe së fundmi, një pjesë e literaturës në këtë syllabus është vecanërisht e vjetër, e vitit 1995.
- 14) Lënda “Inteligjence artificiale” në syllabus cilësohet se jepet në semestrin e dytë. Tek përmbledhja e lëndës cilësohet “*IA është një drejtim tërësisht i ri i IT-së...*” ndërkohë që ky drejtim ka mbi 40 vjet që zhvillohet brenda IT-së. Gjithashtu, citohet se: “... *Mungesa e laboratorëve na detyron të trajtojmë temat vetëm në aspektin teorik*”. GVJ mendon se kjo vlen vetëm për temat e Robotikës, ndërkohë shumë të tjera mund të shfrytëzohen nga studentët për të koduar algoritmet e ndryshme të IA dhe Machine Learning.
- 15) Vlerësim ekonomik projektsh – GVJ mendon që për një student të MSH Inxhinieri Informatike, kjo lëndë të shkrihet në një nga lëndët ekzistuese e në vend të saj të ofrohet një përmbajtje më esenciale për profilin e “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” (p.sh. Scrum, Agile apo metodologji të tjera që bashkojnë këto fusha ngushtësisht dhe që vëmë re se mungojnë në kurrikulën e këtij profili)
- 16) Syllabus i lëndës “Adminisitrimit i bazave të të dhënave” (i avancuar), mbështetet kryesisht në librin “Fundamentals of Database Systems”, të Ramez Elmasri, et.al, edicioni i gjashtë. Ky tekst nuk paraqet një nivel të avancuar, prandaj GVJ sugjeron heqjen e emërimit “e avancuar” nga emërtimi i lëndës dhe azhurnimin e literaturës me botime më të reja, pasi aktualisht është i vitit 2011. Një dekadë më tutje sistemet e bazave të të

	<p>dhënave kanë pësuar ndryshime të qënësishme, vecanërisht praktike.</p> <p>Për ta përmbledhur, duhet të qartësohen të gjitha pikat e mësipërme të sugjeruara nga GVJ në lidhje me lëndët e ofruara në programin e studimit, emërtimet, përmbajtjet e tyre, zhvillimin se në cilin semester jepen, si dhe lektorët përkatës.</p> <p>Të rimendohen disa lëndë, të rishihen kurrikulat si një e tërë e të bëhen ndryshimet e duhura për ta përafuar këtë program edhe më mirë me tregun e punës dhe me zhvillimin e aftësive hulumtuese të studentëve.</p> <p>[Syllabuset e lendeve; ref. 19]</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GV konstaton që shpërndarja e ngarkesës mësimore në katër semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> <p>Cdo lëndë në programin e studimit ka 6 kredite dhe ngarkesa nëpër lëndë janë të përafërta. Përjashtim ka Diploma, e cila ka 18 ECTS, si dhe “Praktika” me 12 ECTS, pasi është më shumë punë e pavarur jashtë auditorit.</p> <p>GVJ konstaton se programi në përgjithësi synon nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore, si dhe përfitim të aftësive praktike, e bërë kjo në përputhje me synimet e një programi master shkencor. Konkretisht në auditore, në bazë dhe të vizitës së GVJ në IAL në takimin me studentë, u vu re një nivel mesatar kompetencash.</p> <p><i>GVJ sugjeron rritjen dhe përmirësimin e anës praktike të secilës lëndë të profilit, si dhe një përjashtim tjetër në kriteret e pranimit të studentëve në programin master shkencor të kësaj natyre, sic është shprehur dhe në kriteret e mësipërme. Kjo do të rrisë cilësinë e programit në tërësi dhe ngritjen e kompetencave për profesionistë IT që zotërojnë një diplomë të nivelit të dytë. Sugjerojmë që kurrikula për cdo profil të shihet dhe të kompaktësohet, në mënyrë që të evitohen përsëritjet, të shtohen në to saktësisht çfarë është parësore në aspektin hulumtues, si dhe të ngrihen kapacitetet e stafit që angazhohet në këtë program.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim</p>	<p>GVJ vëren që ky program është i harmonizuar me zhvillimet ekonomike dhe teknologjike të vendit tonë, është i përshtatshëm për vendet e punës të ofruara në fushën e IT (në nivel junior ose si specialist sipas secilit profil), por nevojitet të saktësohet më shumë brenda programeve lëndore, në lëndë të vecanta aftësitë praktike dhe qasjet kërkimore-shkencore, nga të cilat do të përfitojë studenti.</p> <p>Raporti Teori Praktikë, i përllogaritur si raporti: (orë totale leksioni + orë totale seminari) / (orë Lab + Ushtrime + praktike + tjetër), në programin e studimit është përllogaritur në bazë të lëndëve të kategorive A, B dhe C. Sipas këtyre llogaritjeve, secili profil ka në përbërje të strukturës mësimore 15 lëndë me nga 6 ECTS, të ndara si më poshtë:</p> <p>6 ECTS x 15 lëndë = 90 ECTS</p>

<p>në përfundim të studimeve.</p>	<p>2.5 ECTS leksione x 15 lëndë = 37.5 ECTS</p> <p>2 ECTS seminare x 15 lëndë = 30 ECTS</p> <p>1.5 ECTS project/detyra x 15 lëndë = 22.5 ECTS</p> <p>Pra, TEORI janë 67.5 ECTS, kurse PRAKTIKE janë 22.5 ECTS. GVJ konstaton një raport të lartë të teorisë ndaj praktikës, vetëm për lëndët e kategorive A, B, C. Por, këtyre vlerave nëse i shtojmë 18 ECTS të Praktikës Profesionale dhe 12 të Punimit të Diplomës (lëndët e kategorive D dhe E), atëherë raporti përmirësohet. Gjatë vizitës në IAL në takimin me stafin dhe studentët konstatuam që shumë prej lëndëve teknike kryejnë punë praktike në orën e seminarit, disa edhe në atë të leksionit, gjë që është mjaft positive për aftësimin praktik dhe përlogaritë e raporteve teori/praktikë edhe pse joformalisht.</p> <p>Gjithashtu, GVJ pohon që lëndët mbështeten nga literaturë e huaj të rëndësishme të fushës, që janë ofruar dhe në universitete të tjera jashtë vendit, por konstatohet që këto burime nuk janë rifreskuar me materiale të reja në një pjesë të lëndëve, proces që IAL e kryen për cdo program studimi në fillim të vitit akademik. Një pjesë e mirë e tyre kanë literaturë të 2-3 viteve të fundit, gjë që është përsëri mjaft positive. GVJ e ngre këtë çështje pasi janë një pjesë prej lëndëve mjaft teknike dhe materialet e para 4-5 viteve mund të ta hedhin poshtë tërësisht teorinë dhe praktikën aktuale.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabusët (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Sipas RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore Mësimore e Programit), Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë përditëson në mënyrë periodike literaturën bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit. Këto ndryshime bëhen në fillim të secilit semestër, ku theksimi është në përfshirjen e botuesve të rëndësishëm si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, si edhe botime me njohuri bazë ose të avancuara, të të njëjtave kritere, të shtëpive botuese Sage, Routledge, Pearson dhe Elsevier. Pavarësisht titujve të vendosur në syllabus-et e lëndëve përkatëse, të cilët janë tekste mjaft të mira në vetvete, GVJ konstaton që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Literatura e cituar nën seksionet: a. Literatura bazë e detyrueshme, dhe b. Literatura e rekomanduar, nuk ndjek në mënyrë konsistente të njëjtin standard referimi (p.sh. APA style, apo të tjerë). 2. Në këto bibliografi, në pjesën më të madhe të tyre, mungon vendosja e vitit të botimit (i detyrueshëm në cdo standard). Për pasojë, nuk mund të themi kohën e botimit të tyre. Në të gjitha rastet që kjo është evidentuar, GVJ-së i është dashur të kërkojë titujt për të saktësuar vitin e tyre të botimit. Një punë e tillë do duhej të ishte bërë në syllabus, do duhej të ishte nxjerrë në pah nga përgjegjësit e grupit mësimor, që janë konsultuar e kanë firmosur, si dhe së fundmi do të duhej të ishin verifikuar nga vetë ekipi i RVB, kur pohojnë që literaturat janë të azhornuara. <p>Një pjesë e lëndëve i kanë vitet të shprehura në literaturat e lëndëve, por këto janë mbi 5 vite të vjetra, pra më herët se 2015. Kjo shihet dhe në lëndë që kanë</p>

	<p>pësuar një ndryshim mjaft të shpejtë vitet e fundit. Gjithsesi, krahasuar dhe me programe të tjera të ngjashme, ky program studimi ka një përmbajtje mjaft të mirë literature si dhe strukturë të detajuar të syllabuseve, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.</p> <p>[Rregullore Mësimore e Programit]; [Syllabuset e lëndëve]; [RVB]</p>			
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Në RVB, raporti shpreh se programi synon të transmetojë aftësi dhe shprehi te studentët për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, mbështetur edhe në lidhjet e krijuara me partnerët konkretë të tregut të punës të përfaqësuar në Bordin e Tregut të Punës të Departamentit, si dhe përmes programit 500+. Pavarësisht pohimit të kryerjes së konsultimit, duhet që IAL të dokumentojë propozimet e ardhura nga bashkëpunëtorët, ose formën e komunikimit të tyre, si dhe ndryshimet përkatëse që mund të kenë ndodhur në syllabuset e lëndëve, apo në kurrikulën e përgjithshme për seclin profil.</p>			
<p>Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve</p>	<p>GVJ konstaton që studentët e diplomuar nga programi i studimit Master I Shkencave "Inxhinieri Informatike", me 5 profile, nuk zotërojnë njohuri të avancuara, por mesatare, për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor. Përpjekjet janë mjaft të mira nga ana e departamentit për t'i inkurajuar ata në pjesëmarrje, por nga të dhënat tabelare të paraqitura nga IAL ("Tabela përmbledhëse për Aneks RVB", ref. 0.2, tabela 22), kjo pjesëmarrje është tejet e ulët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve".

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave "Inxhinieri Informatike" me 5 profile është me grada dhe tituj, konform kërkesave të legjisllacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve", ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të</p>	<p>Sipas VKM nr. 418, janë përcaktuar raportet e personelit akademik me kohë të plotë/student, ku personeli akademik duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore.</p> <p>Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit përbëhet nga 13 anëtarë të personelit akademik, 7 të angazhuar me kohë të plotë dhe 6 me kohë të pjesshme.</p> <p>Raporti numerik del 54% PAE /46% PAK.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 41

programit të studimit.

Nga pikëpamja e kualifikimit akademik personeli në total, për vitin akademik 2020-2021, përbëhet nga:

- 2 Prof. Dr.,
- 3 Prof. Asoc. Dr., dhe
- 5 Dr.
- 3 MSc.

Në bazë të të dhënave tabelare të vëna në dispozicion nga IAL ("Të dhëna tabelore për personelin akademik") dhe CV e tyre, anëtarët e stafit të ftuar vijnë nga institucione publike dhe private dhe kanë profil të përshtatshëm për tu anagazhuar në programin e studimit.

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesor	3		2		3	
Prof. Asoc	1		2	1	2	1
Doktor/Docent		2	2	4	5	2
Msc.		1	1	1	1	1
Gjithsej	4	3	7	6	11	4

Përvec PAE, departamenti ka të angazhuar dhe 8 PAK. Nga tabela e ngarkesës në dokumentin "Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik", vërejmë që:

PAE	PAK
720 orë	540 orë

PAE zë 57% të ngarkesës totale të orëve mësimore. GVJ konstaton që IAL ka ndërtuar një strukturë mësimore që duhet ende të përputhet me ligjin. Gjithsesi, konsiderojmë që sfidat për të pasur një staf të qëndrueshëm në fushën e IT janë jo të vogla, prandaj pasurimi i departamentit me lektorë të rinj me tituj të kategorive Doktor dhe Profesor është e domosdoshme. Nga të dhënat, 2 anëtarë të stafit për vitin akademik 2020-2021, janë me gradën Master.

[Të dhëna tabelore për personelin akademik], [Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik]

Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Sipas RVB, përzgjedhja e pedagogëve që do të japin një lëndë të caktuar realizohet bazuar në ekspertiza akademike dhe kërkimore të pedagogut, përvojës në fushën e mësimdhënies. Si rregull, anëtari më i kualifikuar i personelit akademik mbulon lëndën/lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit përkatës.

GVJ e konstaton që, sipas Curriculum Vitae, ata të cilit IAL i ka vënë në dispozicion Curriculum Vitae, ky kriter plotësohet, por ka ende mundësi për

	tu përmirësuar.			
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga shpjegimet e marra gjatë vizitës së IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton që institucioni ka një sërë marrëveshjesh me biznese, kompani, apo institucione publike, të cilat synojnë të vendosin një bashkëpunim të mirë për kryerjen e praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Praktika profesionale është gjithashtu një proces i mirëmenaxhuar nga institucioni, ku një pjesë të semestrit të dytë studentët ndjekin zhvillimin e proceseve dhe fitojnë eksperiencë në lidhje me mjedisin e punës. Në fund të kësaj periudhe, secili prej tyre mbron eksperiencën e fituar përpara një komisioni të ngritur nga departamenti. Viti pandemik ka bërë që si praktikant profesionale, ashtu edhe mjaft aktivitete të tjera të qënësishme të IAL të zhvillohen të reduktuara, ose online.</p> <p>Pas realizimit me sukses të praktikës profesionale, si dhe përmbylljes së të gjithë detyrimeve ndaj IAL, studentët kalojnë në procesin e punimit të diplomës. Atyre iu ofrohen nga IAL dhe seanca informuese në lidhje me metodologjitë e ndjekura në implementimin dhe shkrimin e diplomës (process i cili ndahet në të dy semestrat e vitit të dytë të programit të studimit).</p>			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit	Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që në nivel fakulteti institucioni ka zyrën e IT, stafi i të cilit merret me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore. Kjo zyrë ka katër punonjës, të cilët punojnë si në mbështetje të programit mësimor, ashtu edhe me çështje të infrastrukturës që IAL zotëron dhe menaxhon për orët praktike të lëndëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL, në Statutin e UET, neni 30, pika 30.4 parashikon se çdo program studimi, konsultohet në mënyrë të herëpashershme me Bordet e Tregut të Punës, përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, dhe ai mund të ndryshojë për t'iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Këtë, GVJ e konfirmon dhe nga shpjegimet e dhëna gjatë vizitës në institucion, por që kriteri (sic është i shprehur në këtë raport) të

	konsiderohet i plotësuar, duhet që këto konsulta e propozime, që më pas kthehen në vendime në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit, të jenë dhe të dokumentuara.			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	Në IAL, prej disa vitesh, Bordi i Tregut të Punës është krijuar me anëtarë nga radhët e UET Alumni, të cilët kanë zhvilluar një karrierë të spikatur profesionale pranë institucioneve ku janë punësuar. Një herë në muaj, Departamenti zhvillon mbledhje të hapur për studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit e më gjerë. GVJ nuk ka në dispozicion një dokument që e vërteton reflektimin e tyre në programin mësimor (procesverbal, memo, shkresë tjetër).			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.	GVJ konstaton se IAL angazhohet seriozisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë UET, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ALUMNI-t në strukturat konsultuese e drejtuese të universitetit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete/projekte zhvilluese të UET. Një politikë e tillë është ndjekur në mënyrë të vazhdueshme nga UET dhe vazhdon të jetë në qendër të Planit Strategjik 2015-2020, 2021-2025 pjesa “Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore”.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi	Sipas prioritetëve të caktuara për vendin tonë, duke qenë se profilet me drejtim IT janë gjithmonë të kërkua e për të cilat ka mjaft nevojë tregu, edhe programi i Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile është pikërisht rezultat i nevojës për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës për kualifikimin e nëpunësve të angazhuar në procese pune të lidhura me informatikën. Një inkurajim për zhvillimin e këtij programi, IAL e merr dhe nga UET Alumni nëpërmjet Bordit të Tregut të Punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ konstaton që programi i studimit përcakton qartë objektivat kryesorë dhe prioritetet e tij në disa dokumente kryesore, si Statuti i UET, apo dhe analiza e bërë për tregun e punës para dhe pas hapjes së programit të studimit. [Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit, ref. 16].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë	Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë, pranë FIJA, është njësia bazë që administron veprimtaritë e mësimdhënies të programit të studimit MSH në Inxhinieri Informatike me 5 profile. Ky program është hapur për herë të parë në vitin akademik 2018-2019, ku ka pasur 23 studentë të regjistruar në të katër

<p>kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>profilet e tij (59 studentë në vitin 2019-2020). Ajo çfarë vihet re nga të dhënat tabelarë (“Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave”) është se profili “Menaxhim dhe vlerësim projektesh” ka pasur 0 dhe 3 studentë të interesuar në secilin vit akademik. Ky rezultat duhet të trajtohet seriozisht nga njësia bazë. Në fakt ky është një sugjerim që vjen natyrshëm dhe nga GVJ, pasi sipas kurrikulës së përbashkët të zhvilluar nga studentët e 5 profileve, ata janë me natyrë shumë më teknike sesa profili menaxherial të programit master.</p> <p>Personeli akademik në këtë rast, do jetë dhe më kompakt dhe i përqëndruar në profile më të ngjashme të ofruara brenda të njëjtit program master, krahasuar me një ndërveprim më të lartë me stafet e departamenteve të tjera. Kompaktësia e stafit, e programeve, profileve, etj, do të ishte një stimul edhe më i fortë për bashkërendimin e veprimtarive kërkimore në fushën e IT.</p>			
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Departamenti, si dhe vetë IAL kanë në focus të tyre angazhimin në projekte të ndryshme, e kjo për disa arsye. Një prej tyre është dhe përfshirja e studentëve në paketa të ndryshme pune, në programe shkëmbimi, në aktivitetet të tjera që IAL organizon në kuadër të përmirësimit të jetës universitare. Vlerësojmë që programi Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile ka shumë mundësi në lëndët e tij të angazhojë studentët në detyra konkrete, prandaj si GVJ sugjerojmë që kjo gjë të theksohet edhe më shumë. Sot, IT është në qendër të pjesës më të madhe të fushave të tjera të kërkimit, prandaj me pak punë, burime e administrimin e duhur mund të realizohen ide nga më të ndryshmet</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.</p>	<p>Teorikisht ky program studimi mund të fokusohet në hartimin dhe zbatimin e studimeve të ndryshme rajonale dhe kombëtare, por zbatimi konkret i tyre mund të kërkojë dhe pak kohë sa ky program të forcohet mjaftueshëm. Duke qenë në akreditimin e tij të parë, besojmë se në të ardhmen këto produkte do të jenë më të prekshme.</p>			
<p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>Sipas RVB, aktivitetet studimore, etj, mbështeten financiarisht nga UET. Burimet për financimin e tyre janë të dyfishta: të brendshme dhe donacionet e jashtme.</p> <p>Gjatë vizitën në IAL, në takimin me stafin drejtues, GVJ u njoh me praktikën e financimit të publikimeve për titujt akademikë, e cila vihej në dispozicion të anëtarëve të stafit.</p> <p>[Vizita në IAL]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.8
Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	IAL ka një praktikë mjaft të mirë në ofrimin e programeve të reja, në organizimin e një jete universitare mjaft aktive, në krijimin e grupeve të ndryshme të debatit, brainstorming, diskutimeve shkencore, etj. IT si drejtim është relativisht i ri në UET, por drejtimet e tjera, duke qenë se kanë kaluar nëpër këto procese, mund të shërbejnë si një udhëzues mjaft efektiv për ta cuar dhe drejtimin e Teknologjisë në të njëjtat nivele.			
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Personeli akademik i DIT është mjaft i kualifikuar në profilet përkatëse brenda Informatikës, gjë që e bën më të lehtë angazhimin e departamentit. Një ndihmesë të madhe jep dhe zyra e Projekteve me përfshirjen e stafit në detyra të ndryshme. Gjatë vizitës GVJ u njoh me praktikën e shpërndarjes së informacioneve në lidhje me bashkëpunimet, apo projektet ku stafi dëshiron të angazhohet.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	Njësia përgjegjëse, DIT, nuk organizon një aktivitet specifik për stafin dhe studentët e programit të studimit, por IAL e ka përfshirë këtë drejtim në konferenca të ndryshme periodike që zhvillon. Sic kemi sugjeruar dhe më parë, do ishte mjaft e rëndësishme të krijohet konferenca studentore vetëm për profilin IT, në mënyrë që studentët të kuptojnë rëndësinë e komunikimit të kërkimit shkencor, të aplikojnë mendimin kritik, debatin, si dhe të implementojnë metodologjitë e ndryshme dhe praktikatat e mësuara në auditor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave	GVJ konstaton që institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në përgjithësi. Kështu, në "Rregulloren e UET" përshkruhen në mënyrë të

<p>të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.</p>	<p>detjuar mënyrat e hartimit të syllabus-eve, metodat e mësimdhënies, sistemi i kontrollit të dijeve, etj. Për të verifikuar implementimin e tyre, GVJ kontrolloi dhe programet e lëndëve, në të cilat saktësohen edhe me tepër se cilat metodologji do ndjekë lektori në leksion apo seminar.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Në bazë të RVB, dokumentave të vënë në dispozicion, si dhe shpjegimeve të marra gjatë vizitës në IAL, konstatohet se institucioni zhvillon mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të cilësisë së mësimdhënies së stafit akademik. Këto mekanizma janë: (a) të drejtpërdrejta nëpërmjet asistimit në sallë nga strukturat e larta të njësisë bazë/kryesore; (b) vlerësimi nga studentët në fund të semestrit me anë të pyetësorëve online; (c) nëpërmjet një strukture studentore të quajtur focus-group; (d) vetëvlerësimi; (e) Komisioni i Vlerësimit të Përformancës që ngrihet nga Rektori; (f) Leksione të hapura.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi që në IAL funksionon një sistem kompleks për menaxhimin e proceseve mësimore (mësimi, vlerësimi të lëndës, frekuentimit, etj) që përfshin dhe menaxhimin e vlerësimit të studentëve për secilën lëndë në fund të semestrit. Këto vlerësime janë jo vetëm për aspekte të mësimdhënies, por edhe në drejtimin e etikës së komunikimit, mbështetjes së studentëve si dhe mbarëvajtjes së përgjithshme të orës së mësimi dhe kërkesave të studentëve që lidhen me to. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh konkretisht me disa shembuj të vlerësimeve të pedagogëve.</p> <p>Studentët mund të shprehin mendimet apo ankesat e tyre edhe në mbledhjet e departamentit, ose me kërkesë drejtuar përgjegjësit të departamentit, si dhe në struktura të tjera, si ajo e Zyrës së Kujdesit të Studentit.</p> <p>[Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë], [Plani Veprimi KSBC], [Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022]</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në bazë të RVB, rezultatet e vlerësimit përpunohen nga KSBC, dhe nga zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Përgjegjësi i Departamentit. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme.</p> <p>Gjatë vizitës u verifikua që cdo rezultat i vlerësimit nga studentët arkivohet në dosjen personale të pedagogut. U panë disa prej tyre. [Vizita në Burimet njerezore]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>Në dokumentin “Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë” pika F. VII. 3, theksohet që ‘...qëllimet e tij janë: rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET, të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore në UET, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore...’</p> <p>Kontrolli periodik dhe shumëplanësh, që u evidentua të zhvillohej në institucion, bën që personeli akademik të mund të mësojë praktikat e mira,</p>

	si në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies, ashtu edhe në aspekte të tjera të punëve të tij brenda institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kursi, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në bazë të dokumentave të ndryshëm të vënë në dispozicion të GVJ, si dhe nga vizita gjatë institucionit, u konstatua që procesi mësimor zhvillohet me leksione, me seminare, leksion/seminare, me detyra praktike dhe me detyra kursi, praktikatat profesionale, punim diplome ose provim të përgjithshëm përfundimtar.</p> <p>Si pasojë e Covid-19, IAL hartoi dhe nxorri në fuqi një rregullore ("Rregullore tranzitore për zhvillimin e procesit akademik gjatë vitit 2020-2021", ref. 5.2), sipas së cilës mësimi do të zhvillohej online.</p> <p>Sipas syllabus-eve të lëndëve u vu re që përvec provimit përfundimtar, kontrolli i dijeve bëhet i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit. Institucioni ka zhvilluar dhe leksione të hapura me ekspertë të IT, apo përfaqësues të kompanive që operojnë në fushën e IT, si dhe ka vendosur në vlerësim 10% të aktivizimit të studentëve gjatë qëndrimit të tyre online.</p> <p>[Syllabuset e lëndëve; ref. 19]; [Rregullore tranzitore për zhvillimin e procesit akademik gjatë vitit 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Sipas RVB, por edhe në bazë të dokumentacionit të konsultuar, GVJ evidenton që personeli akademik ka respektuar diversitetin e studentëve. Sipas vizitës në IAL, në takimin me studentët, duke qenë se shfaqin heterogjenitet në formimin e tyre Bachelor, ata mendojnë që shtimi i pjesëve praktike në lëndët e profilit do ishte edhe më në dobi të avancimit të tyre praktik dhe për pasojë rritjes së mundësisë së punësimit të tyre në një profil të fushës së IT.</p> <p>[RVB]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave</p>	<p>Sipas RVB, sigurimi i brendshëm i cilësisë në institucion lidhet dhe me trajnimin e pedagogëve. Institucioni ka një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore.</p>

<p>didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vuri re anën logjistike të sallave, të bibliotekës apo të ambienteve të tjera, të cilat vërtetojnë përdorimin e pajisjeve dhe metodave bashkëkohore të të nxënit.</p> <p>Institucioni ka të ngritur dhe Komisionin e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik, i cili vlerëson të gjithë personelin e angazhuar me kohë të plotë dhe të ftuar. Raporti përfundimtar i performancës ndihmon stafin të përmirësojë aspekte të caktuara, si dhe vlen si bazë për zhvillimin e marrëdhënieve të punësimit. Gjithashtu institucioni kryen dhe trajnimin në vazhdimësi të personelit: (a) certifikata e mësimdhënies; (b) certifikata e kërkimit shkencor; (c) certifikata e drejtimit të grupit kërkimor; (d) certifikata për menaxhimin; etj, të cilat janë të detyrueshme për anëtarët e stafit të vendosur në pozicionet përkatëse.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Pas shqyrtimit të Curriculum Vitae të dorëzuara nga IAL për anëtarët e stafit që japin mësim në programin Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, GVJ arrin në përfundimin që ky personel akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive, si pasojë e edukimit të tyre, përvetësimit të titujve dhe gradave apo edhe nga eksperiencia e tyre profesionale në kompani apo projekte IT. Për lëndët e profesionit sugjerohet rishikim i programeve, si dhe i literaturave.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas strukturës organizative të UET, ngritja e zyrave të ndryshme, apo bërja pjesë e kompetencave të përgjegjësve të departamenteve, dekanëve, apo stafeve të tjera menaxhuese të institucionit, të vlerësimit të performancës së lektorëve nga studentët, bën që GVJ të konstatojë që IAL e vlerëson dhe përpiket të përmirësojë mësimdhënien në përgjithësi. Ka pasur raste, sipas informacioneve të marra gjatë vizitës, që këto vlerësime kanë qenë përcaktuese për vazhdimësinë e punës në UET. Studentët mund të japin dhe sugjerime në lidhje me kurrikulën e programit, si dhe janë përfshirë dhe në strukturat organizative sipas legjisllacionit në fuqi.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ evidentoi që një pjesë e mirë e pedagogëve prezentë në takim përdorin metoda interaktive dhe diskutimi me studentët. Vlen për tu përmendur që lëndët që zhvillohen nga departamente të tjera përshtaten dhe për profilin e IT (p.sh. Aftësitë Menaxheriale). Nga vëzhdimi i syllabus-eve të detajuar të lëndëve, GVJ konstaton dhe lëndë të caktuara që përfshijnë diskutimin e rasteve, punën në grup, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Sipas RVB, stafi akademik inkurajon autonominë dhe mendimin kritik të studentëve nëpërmjet literaturës së rekomanduar, ose artikujve shkencorë të dhënë për t’u studiuar në mënyrë të pavarur Kështu, GVJ konkludon se në këtë mënyrë arrihet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit jashtë auditorit, në mënyrë të pavarur. Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve, detyrat e kursit në programet master zhvillohen përmes prezantimeve në grup të studentëve. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe aftësitë e punës në grup, si edhe bën që studentët të mësojnë nga njëri-tjetri.</p>

	[CV të stafit; ref. 20] [Syllabuset e lëndëve, ref. 19]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Gjatë vizitës në institucion, në bazë të RVB, si dhe duke shqyrtuar dokumentin “Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit”, GVJ konkludon që procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore. UET ka në dispozicion 3 godina: A, B dhe C. Në godinën B ndodhen 4 laboratorë informatike me kapacitete (25 PC, 35 PC, 35 PC dhe 80 PC) ku zhvillon një pjesë të leksioneve edhe Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile. Në bazë të vizitës dhe RVB ambjentet e UET janë të pastra si rrjedhojë e punës që bëhet nga stafi i punësuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e ambjenteve të institucionit, por edhe si masë shtesë kundër Covid-19. Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, UET ka 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. [Infrastruktura në funksion të programeve të studimit [Inventari i teksteve], [Vizita në institucion]
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.	Në bazë të dokumentacionit, institucioni ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Përmendim sistemin MOODLE (UET LMS), që bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ky sistem u demonstrua dhe gjatë vizitës në IAL në mënyrë të detajuar. [Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS], [Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS], [UET LMS - Guide për pedagogun], [UET_LMS_Guide për studentet]
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ mundi të shihte nga afër ambjentet e Bibliotekës së UET. U konstataua literatura në dispozicion të studentit në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore të Masterit të Shkencave “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile. Sipas RVB, Biblioteka e UET furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e	

studimit.	<p>në mbështetje të programeve. Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia.</p> <p>[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit [Inventari i teksteve], [Vizita në institucion] [Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS], [Urdher Mbi zbatimin e platformes LMS], [UET LMS - Guide për pedagogun], [UET_LMS_Guide për studentet], [Syllabusët e lëndëve]</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Sipas RVB dhe inventarit të teksteve, konstatohet një numër i pakët botimesh në funksion të programit të studimit. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Biblioteka ka 12 kompjutera dhe gjithë ambjenti është i mbuluar nga rrjeti wireless.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, si dhe nga informacioni i marrë nga dokumenti "Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit", Godina C (Biblioteka) është gjithsej me një sipërfaqe 300 m², e pajisur me ambjente komode, të ngrohta, dhe me orare të përshtatshme për studimin e pavarur të studentëve.</p> <p>[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit], [Inventari i teksteve], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Sikurse u përmend në kriteret e mësipërme, në mjediset e IAL është lehtësuar aksesimi në libraritë online si për personelin akademik, ashtu edhe për studentët. Biblioteka është e pajisur me PC, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online).</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e laboratorëve apo objektivave të tjera mësimore. Konkretisht, në dispozicion të studentëve janë 4 Laboratorë Informatike, përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor rreth 45 m²; - Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) – 160 m². - Studenti mund të punojë në Bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo punimin e diplomës që duhet të shkruajë. <p>[Infrastruktura në funksion të programeve të studimit], [Vizita në institucion]</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning)</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ mundi të shohë të demonstroi platformën online UET LMS, e vënë në dispozicion të lektorëve dhe</p>

dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	<p>studentëve. Sipas Urdherit administrativ për LMS, nr. 09/2017 “Mbi zbatimin e plotë në procesin mësimor administrativ të platformës UET LMS”, personeli akademik, në kuadër të dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies në UET dhe menaxhimin efektiv të tij, urdhërohet vendosja në efikasitet të plotë e platformës UET LMS me të gjitha funksionet e saj. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon syllabusin, prezantimet, leksionet, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj. Detajet e tjera të platformës janë të sqaruara në dokumentacionin e dorëzuar.</p> <p>Platforma Moodle mbi të cilën ngrihet dhe është personalizuar UET LMS lejon që të gjithë përdoruesit e saj (lektorë, studentë apo administratorë, etj), të mund të komunikojnë mes tyre, të bëjnë upload të dokumenteve, të disutojnë në forume, si dhe të mund të shkarkojnë leksionet dhe cdo material tjetër të vendosur në dispozicion nga lektori i lëndës.</p> <p>[Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS], [Urdher Mbi zbatimin e platformës LMS], [UET LMS - Guide për pedagogun], [UET_LMS_Guide për studentet], [Syllabuset e lëndëve]</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.</p>				
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Në dokumentin e vënë në dispozicion (B. II. Mbi punimin e diplomes/disertacionit) qartësohet mënyra e zgjedhjes dhe miratimit të temës. Sipas pikës B. II. 2., në fillim të muajit tetor, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. Studentët, në bazë të mesatares, mund të realizojnë si punim diplome: (a) projekt profesional me karakter aplikativ/praktik; (b) studim i një rasti ose studim krahasues që hyn shumë thellë në problematikën e një rasti të veçantë studimi (“case study”), (c) shkrim i një projekti profesional, ose (d) ndërtim i një aplikacioni për programe në fushat si informatika.</p> <p>I gjithë procesi nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrojtja e temës, është i rregulluar në dokumentacionin e IAL. Pedagogët udhëheqës realizojnë seancat metodologjike për të asistuar dhe mbështetur studentët gjatë fazës së shkrimit të temës, sipas një kalendari takimesh, të shpallur.</p> <p>[Mbi punimin e diplomes/disertacionit]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>



<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Në IAL Universiteti European i Tiranës, vepron Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ndër detyrat e kësaj strukture është të vlerësojë periodikisht veprimtaritë e mësimdhënies si dhe ato të kërkimit shkencor. Gjithashtu, Zyra e Standarteve dhe Cilësisë kujdeset për kuadrin rregullator të institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Përveç këtyre strukturave të dedikuara janë dhe strukturat drejtuese dhe autoritetet të institucionit, të cilat janë gjithashtu përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p>[Statuti i UET]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>Për programin Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, është përgjegjës departamenti i “Teknologjisë dhe Informatikës”, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. Ai kujdeset për cilësinë e mësimdhënies, përzgjedh personelin akademik, si dhe bën shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me rregullatorët e institucionit si dhe bazuar në ligjet e arsimit të lartë.</p> <p>Programi mësimor ka dhe një staf të dedikuar, që është koordinatori i programit, përgjegjës për ecurinë e zhvillimin e kurrikulës, për të garantuar respektimin e parimeve dhe kriterëve të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara, e për të siguruar përditësimin e tyre me të rejat e shkencave përkatëse dhe kërkesat e tregut të punës. Për programin në fjalë koordinatore është zgjedhur një lektor me titull Prof. Dr., që plotëson kriteret e vendosura në ligj. Koordinatori është anëtar efektiv departamentit, detyrat e së cilit janë të caktuara në Aneksin “Për përcaktimin e detyrave të koordinatorit të programit të studimit”.</p> <p>[Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi si nga RVB, ashtu dhe nga vizita në IAL që departamenti “Teknologji dhe Informatikë” mbështet zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Sistemi UET LMS është një prej tyre.</p> <p>[Vizita në IAL]; [Raporti i Vlerësimit të Brendshëm]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Në dokumentet e vëna në dispozicion, si dhe gjatë takimit me stafin e departamentit “Teknologji dhe Informatikë”, GVJ konstatoi që ky staf mbështetet dhe inkurajohet të kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme. Kështu, në Statutin e UET (pika 36.2), në Strategjinë e Kërkimit Shkencor në UET 2017-2020, vërehet që institucionit e ka në vëmendje kualifikimin e përhershëm të stafit akademik dhe studentëve.</p> <p>Një aspekt tjetër shumë domethënës që vërteton këtë pjesë, sipas GVJ, është dhe pjesëmarrja mjaft aktive e anëtarëve të institucionit në projekte të ndryshme ndërkombëtare, në të cilët janë angazhuar edhe si</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe</p>	<p>Një aspekt tjetër shumë domethënës që vërteton këtë pjesë, sipas GVJ, është dhe pjesëmarrja mjaft aktive e anëtarëve të institucionit në projekte të ndryshme ndërkombëtare, në të cilët janë angazhuar edhe si</p>




implementimit të metodave të reja.	<p>kërkues shkencorë, por edhe janë trajnuar, kualifikuar, udhëtuar në institucione të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Sipas RVB, personeli akademik i UET mund të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar trajnimet e herëpashershme nga lektorë të ftuar, apo anëtarë të personelit të UET (zyra e IT, apo njësi të tjera). Dhe, në dokumentin “Të dhëna për trajnime profesionale”, GVJ gjen një mori aktivitete, seminaresh e trajnimesh.</p> <p>[Statuti i UET]; Strategjia e Kërkimit Shkencor në UET 2017-2020; Vizita në IAL; Të dhëna për trajnimet profesionale</p>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>Sipas RVB, përdorimi i metodave të reja në mësimdhënie mbetet përgjegjësi individuale e personelit akademik. Institucioni bën përpjekje për të promovuar përdorimin e këtyre metodave, por përsëri vihet re se përvetësimi dhe shfrytëzimi i tyre në mësimdhënie përqafohet më kollaj nga brezi i pedagogëve të rinj, ndërkohë që përdoren më pak nga brezi i atyre me më shumë përvojë (vite eksperiencë pune).</p> <p>Kjo u konfirmua dhe nga takimi në institucion me strukturat drejtuese të zyrës së IT. [Vizita në IAL]</p>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Në IAL, u konstatua nga GVJ që personeli inkurajohet të testojë metoda të reja bashkëkohore. Shembull për këtë është sistemi UET LMS. Si protokoll pune, nëse gjatë punës së tyre lektorët vënë re se një eksperiencë e re është efektive, ata raportojnë për rezultatet në mbledhjen e departamentit, me synim që kjo eksperiencë pozitive të përhapet dhe shfrytëzohet edhe nga kolegët e tjerë.</p>			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	<p>Për të plotësuar ngarkesën mësimore me lektorë që janë edhe profesionistë të IT, në institucion bëhet i mundur edhe angazhimi i lektorëve të ftuar. Sipas RVB, ky shihet si element shumë i rëndësishëm për pasurimin e procesit të mësimdhënies dhe lidhjen me tregun e punës, e sidomos në rastin e programit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile. Këto burime njerëzore shërbejnë për të katalizuar dhe anëtarë të tjerë të stafit, për tu përshtatur sa më mirë me ndryshimet mjaft të shpejta që pëson fusha e IT.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e	Në lidhje kriteret dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve

<p>testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>dhe aftësive profesionale, IAL ka të përcaktuara në dokumentin “Rregullore mësimore e Programit të Studimit”, sipas të cilës: nota përfundimtare është rezultante elementeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshme në masën 80%. b) Niveli i diskutimit në seminare 10% c) Detyre kursi 20% d) Provimi përfundimtar 70% <p>Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit përcaktohen në programin e lëndës dhe i bëhen të ditura paraprakisht studentëve.</p> <p>[Rregullore mësimore e programit të mësimit]</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas RVB, studentët njihen me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës, në fillim të çdo semestri. Njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me email nga koordinatori i departamentit.</p> <p>Gjithashtu në Rregulloren Mësimore, pohohet që, në fillim të çdo semestri studentit i vihet në dispozicion programi i çdo lënde që ofrohet. Këto programe depozitohen në librarinë e Universitetit, si dhe mund të publikohen në formën e një broshure nga UET-i. Këto programe depozitohen në librarinë e Universitetit, si dhe mund të publikohen në formën e një broshure nga UET-i.</p> <p>Programet me lëndët dhe strukturën e tyre gjenden të afishuara edhe në faqen ueb të IAL.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Në dokumentin e RVB, shprehet që vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe ka qëllim të trefishtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Nxit studentin që të mësojë gjatë gjithë vitit; b. Prodhon një vlerësim më objektiv të studentit, duke e ndarë notën në disa komponentë në krahasim me vlerësimin e bazuar vetëm në një provim; c. Shërben për të vlerësuar ecurinë e kursit gjatë semestrit, nëse studentët janë duke e kuptuar materialin që po ofrohet në kurs. <p>Në Rregulloren e UET parashikohen forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive, me qëllim që pedagogu të mund të zgjedhë atë që i përshtatet më mirë natyrës së lëndës dhe evidenton më mirë rezultatet e synuara të të nxënës, të ndara këto sipas tipologjive të lëndëve. Përgjatë pandemisë, format e mëparshme të vlerësimit janë modifikuar, në mënyrë</p>

	që t'i përshtaten situatës ku cdo aktivitet do të zhvillohej online. [RVB]; [Rregullore mësimore e programit të studimit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Sipas të dhënave të reflektuara në syllabus-et e lëndëve, e në bazë të Rregullores Mësimore të Programit të studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit është shumë e elementëve të mëposhtëm: a. Nivelit të diskutimit në seminare b. Detyrës së kursit (ese, prezantime, projekte)/dy detyra praktike c. Provimit përfundimtar. Kjo, për GVJ, vërteton shpërndarjen e vlerësimit përgjatë gjithë semestrit. Gjithashtu, IAL i ka kushtuar mjaft rëndësi mbarëvajtjes së provimeve. Në KSBC, i kushtohet një seksion i vecantë mbarëvajtjes së provimeve të ndërmjetme/përfundimtare, cilësisë së korrigjimit të tyre për nivelet BA, MP, MSH. [Metodologjia e punës së KSBC_Provimet], [Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni bashkëpunon me AADF (Albanian-American Development Foundation) dhe po përdor një sistem të vlerësimit elektronik: “Clean score”. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme: si në nivelin bachelor dhe master në programe të tjera studimi të IAL. Përgjatë pandemisë, IAL ka implementuar dhe platformën Microsoft Teams, krahas programeve të tjera që ishin <i>in-place</i> në ndihmë të procesit mësimor.
Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ kupton që komisionet e vlerësimeve ngrihen vetëm në rastin e Praktikave Profesionale, si dhe për mbrojtjen e diplomës. Sipas RVB dhe në bazë të informacionit të marrë gjatë vizitës në IAL, në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korrigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel	Gjithashtu, institucioni ndjek dhe një procedurë të mirërregulluar për rastet kur student ka ankesë për pikët e vlerësimit të lëndës. Në rastet kur këto paqartësi nuk shuhet, Përgjegjësi i Departamentit ngrë një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e ankesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë.

dhe/ose kamera sigurie.	Në dokumentin “Format Raporti për provimet”, KSBC realizon një relacion mbi kontrollin e ushtruar për zhvillimin e provimeve (të ndërmjetme/ përfundimtar) në nivelin bachelor/master. Aty listohen problematikat e përgjithshme të kontrollit, si dhe të dhëna të përgjithshme të provimit.
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Një aspekti i rëndësishëm i mbarëvajtjes së provimit është dhe shoqërimi i korigjimit të tyre me komente. Në fakt, në dokumentin “Formati i tezës së provimit përfundimtar”, listohen seksionet e detyrueshme (kontroll njohurish; pyetje analitike; “mbaj qëndrimin tënd”), si dhe komente të pedagogut rreth përgjigjes së kategorisë së tretë të pyetjeve, që mund të jenë në ndonjë rast subjektive sipas studentëve.</p> <p>[Format raporti për provimet]; [Formati i tezës së provimit përfundimtar]</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion (Rregullore e UET, Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi, pikat 33.1 – 33.3) GVJ konstaton që IAL ka të rregulluar rastet e evidentuara të plagjiaturës së esesive dhe diplomave, apo kopjimit në detyra. Kështu, plagjiatura e provuar në paraqitjen e esesë dhe të diplomës ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese; kopjimi nga materiale të shkruara ose nga fleta e provimit të studentëve të tjerë si edhe çdo komunikim me të tjerët gjatë orës së provimit dënohet me ndërprerjen e provimit dhe studenti vlerësohet me notën 4 (katër). Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Universiteti.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh dhe me programin Turnitin, të cilin IAL e ka vënë në dispozicion të gjithë stafit akademik dhe drejtues, për kontrollet e plagjiaturës</p> <p>[Rregullore e UET, Neni 33 Plagjiatura dhe kopjimi]; [Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në IAL, dorëzimi i vlerësimeve të provimeve duhet të bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Vlerësimi për komponentët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. Jo vetëm provimi përfundimtar, por ndër vlerësimet e lëndëve është dhe detyra e kursit apo esse-ja, e cila gjithashtu rregullohet në dokumentin e përmendur në këtë kriter, pika 5.6. Në syllabuset e programit të studimit, vlerësimi i provimit të ndërmjetëm është eliminuar nga një pjesë e madhe e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Për vlerësimet e vendosura nga pedagogu, sipas RVB, studenti informohet në kohë reale përmes sistemit online, si dhe për seancat sqaruese merr informacionit nga koordinatori e programit.</p> <p>Në lidhje me kërkesën për rishikim të vlerësimit, në rregulloren e</p>

	<p>programit, pika 5.7, studenti ka të drejtë të ngrejë një ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën.</p> <p>[RVB]; [Vizita në IAL]; [Rregullore e programit të studimit]</p>								
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>GVJ konstaton në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, si dhe gjatë vizitës se, studenti i cili mendon se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, t'i drejtojë përgjegjësit të departamentit një kërkesë. Me marrjen e saj, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë. Vlerësimi i Komisionit është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit fimosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të vecanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave "Inxhinieri Informatike" me 5 profile, sipas dokumentit "Rregullore Mësimore e Programit", ka si qëllim ta pajisë studentin me: njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit (specifikisht atë të Informatikës dhe profileve të saj); aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; formim qytetar të përgjithshëm; etj. GVJ mendon se IAL ka arritur të garantojë në mënyrë të kënaqshme zhvillimin e aftësive profesionale dhe të vecanta të studentëve, por sugjerojmë përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulës, azhurnimin e literaturave, si dhe shtimin e aktiviteteve hulumtuese të studentëve, apo vetë pjesëve praktike në lëndët e profilit, sikurse kemi evidentuar në kriteret e tjera më sipër.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Detyrat e ndryshme të kursit, projektet, literaturat ndihmëse në gjuhën angleze, mendojmë se zhvillojnë aspekte të komunikimit dhe ndërveprimit në grup. Këto detyra janë një mënyrë edhe për të analizuar kompetencat e aftësitë e studentëve e për të kuptuar më shumë nga pedagogu se çfarë ata kanë përfituar nga lënda.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave "Inxhinieri Informatike" me 5 profile, pedagogu, në orën e fundit të mësimin, përveçse ndalet edhe njëherë</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe</p>	

<p>orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>në çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, jep edhe orientimet e nevojshme se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementët që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit, si dhe në oraret online.</p> <p>Ky komunikim mes pedagogut dhe studentëve, qartësimi i detajeve të ndryshme të lëndës, si dhe i gjithë procesi mësimor u vërtetua dhe nga vizitës në institucion nga GVJ, ku studentët u shprehën mjaft të kënaqur.</p> <p>[Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas RVB, personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit si orë të klubit të IT apo pjesë të forumeve e workshopeve të ndryshëm, ku studentët kanë mundësinë e zgjerimit të dijeve dhe prezantimit me risi të reja në fushën ku ata studiojnë. Kjo u bë e ditur edhe gjatë vizitës në institucion, ku GVJ u informua nga drejtuesit e njësisë bazë.</p> <p>[Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në programin Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, lëndë të caktuara të programit zhvillohen në laboratorët e informatikës, ku studentët e këtij masteri anën teorike të leksioneve të marra e zbatojnë praktikisht. Kjo u konstatua nga GVJ gjatë vizitës në IAL. Gjatë vitit pandemik, lektorët qëndronin një pjesë në ambjentet e IAL ku shpjegonin e diskutonin me studentët nëpërmjet pajisjeve audio-vizive.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Sipas RVB dhe e konfirmuar gjatë vizitës në institucion, puna në grup dhe diskutimet janë një pjesë shumë e rëndësishme në UET për arritjen e objektivave mësimore pasi sa më shumë ide të shpalosen nga studentët aq më e thjeshtë bëhet të kuptuarit e leksionit dhe zgjidhja e problematikave të caktuara.</p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Programi mësimor i Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, në lëndët e tij ka krijuar një klimë të mirë për zhvillimin e ideve inovative e kjo lidhet ngushtë me vetë natyrën që programi ka. Duke qenë i orientuar drejt profileve informatike, me natyrë të aplikuar, pjesa e studimeve të avancuara kërkimore e shkencore mund të mbulohej nga ky program në mënyrë edhe më të thelluar. Një inkurajim i mirë që i jepet studentëve është për të marrë pjesë në projekte të ndryshme të shkëmbimit si ai Erasmus+.</p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht</p>	<p>GVJ konstaton, gjatë takimit me përfaqësuesit e IAL, që angazhimi i studentëve në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare është një pjesë e rëndësishme e jetës universitare. Shumë prej tyre kanë përfituar dhe nga programet e shkëmbimit, si ai Erasmus+. Në lidhje me studimet e</p>

ato.	<p>avancuara kërkimore e shkencore apo mbështetja financiare e tyre, kjo nuk evidentohet në dokumentet e dorëzuara nga IAL.</p> <p>Në RVB përmendet që në shkurt 2019, institucioni ka realizuar aktivitetin Shkolla Dimërore e Inovacionit. Ky program (bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion), i drejtohet gjimnazistëve dhe synimi i këtij projekti është përmirësimi i përfshirjes sociale të të rinjve ekonomikisht të pafavorizuar, të rinjve në rrezik, kryesisht gjimnazistë të cilët kontribuojnë me ide inovative në fusha të ndryshme si: inxhinieri, arkitekturë, teknologji, por jo për studentët e IAL, apo punën e tyre kërkimore-shkencore.</p>			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	<p>UET mbështet këshillat e studentëve nga ana logjistike dhe mund të financojë projekte të tyre. Gjithashtu, evidentohet se një pikë e fortë e institucionit tonë është bashkëpunimi shumë i suksesshëm falë zyrës së projekteve ku mundësohet shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar nëpërmjet programave Erasmus, projekt ky që ka funksionuar shkëlqyer e më së miri në gjithë tërësinë e tij.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton që institucioni harton rregullore të posaçme për provimin final apo atë të mbrojtjes së diplomës. Kështu, këto saktësohen në dokumentet: (1) B.II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit; (2) Rregullore e UET. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që procesin e zhvillimit të diplomës, ndarjes së procesit përgjatë dy semestrave, orientimit të bërë nga pedagogu udhëheqës, etj.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Sipas RVB, studentët e programit Master i Shkencave “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, në përfundim të studimeve të tyre realizojnë një punim diplome në formën e rastit studimor, rast krahasues ose projektit kërkimor. Gjithashtu departamenti ofron tek studentët dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e këtij detyrimi konform përcaktimeve në rregullore. Seancat metodologjike të zhvilluara në mënyrë të dedikuar gjatë semestrit të dytë të programit, i ndihmojnë studentët të kuptojnë edhe më mirë mënyrën e zhvillimit të punimit/provimit si dhe mbrojtjes së diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/	

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Në dokumentin B. II. Mbi punimin e diplomës/disertacionit, pika B. II. 2.1 – B. II.2.4, GVJ konstaton mënyrën e përcaktimit të temave të diplomave për programet master. Në fillim të muajit tetor, çdo Departament organizon mbledhjen e Bordit të Tregut të Punës për të konsultuar tematikat e ndryshme, që mund të shërbejnë si objekt studimi në nivel diplome, si edhe për të identifikuar udhëheqësit potencialë të këtyre studimeve. Më pas, cdo anëtar i personelit akademik, brenda muajit tetor, njofton/përditëson fushat e tij të ekspertizës dhe ofron propozime konkrete për tema diplome ku është i gatshëm të udhëheqë studentë, duke mundësuar krijimin e një inventari me tema diplomash. Së fundmi, studenti plotëson formularin e aplikimit në konsultim paraprak me një pedagog dhe e dorëzon atë brenda afatit të shpallur. Në rast të mosrespektimit të afatit, studentit i shtyhet tema për në sezonin tjetër. Orientimi i studentëve vazhdon dhe pas zgjedhjes së temës për cdo vështirësi që mund të hasë studenti.</p> <p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve të gjitha kapacitetet e tij logjistike dhe infrastrukurore, si biblioteka, laboratorët si dhe asistencën e vazhdueshme të pedagogut udhëheqës.</p> <p>[Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas dokumenteve të vëna në dispozicioni, si dhe RVB, udhëheqësi në seancat metodologjike duhet të trajtojë çështje të tilla si: (a) përcaktimin shkencor të objektit të studimit; (b) diskutimin e dobisë së punimit; (c) përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet; (d) Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre; etj. Pra, udhëheqësi shihet se ka një rol kyc në mbarëvajtjen e procesit të diplomës, si dhe në garantimin e cilësisë duke u kujdesur që të ndiqen parimet dhe metodat e duhura shkencore. Në mbyllje të punimit, studenti e dorëzon tek udhëheqësi, i cili e miraton ose jo atë. Një student nuk mund të mbrojë diplomën nëse ai nuk ka shlyer të gjitha detyrimet, si dhe nëse nuk ka mbrojtur praktikën, pra nevojitet formimi i tij i plotë teorik dhe praktik, para se të kalohet në diplomë apo provimin përfundimtar të ciklit të dytë.</p> <p>[Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]; [Vizita në IAL]; [Raporti i Vlerësimit të Brendshëm]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas dokumentit B. II, në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë. Studenti që merr notë jokaluese në sezonin e parë të mbrojtjes së diplomës ka të drejtë të paraqitet për mbrojtje në sezonin e ardhshëm. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezultojnë mbetës, studentit duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni, GVJ evidenton formatin e diplomës, si dhe suplementin e saj. Për programin MSH Inxhinieri Informatike,</p>

diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	janë dorëzuar 4 variante të ndryshme suplemente diplomash, nga një për cdo profil. Sipas Rregullores së UET, student që ka plotësuar të gjitha detyrimet, pajiset nga institucioni brenda 6 muajsh me diplomën përkatëse, bashkë me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve. Studenti pajiset me to në përmbyllje të studimeve. Formati i diplomës dhe suplementi i saj janë dokumente të miratuara nga IAL.			
	[Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit]; [Model diplome]; [Suplementi diplomes]			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në Rregulloren e UET (pika 40.1), GVJ konfirmon që në përfundim të studimeve vihet në dispozicion të studentëve diploma, suplementi i diplomës dhe certifikata e notave. Programi i studimit përmendet ne Suplementin e diplomes si pjese e aneksit 1. Ky aneks nuk gjendet i bashkengjitur ne supplement ne dokumentacionin e dorezuar nga IAL.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Sipas RVB, por edhe nga vizita e kryer në institucioni, GVJ konstatoi që institucioni ruan duke magazinuar për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse ato kërkohen. Nga depozitimet përkatëse të dokumentacioneve mund të gjendet në çdo moment një kopje respektive duke verifikuar zbatimin e rregullores në çdo pike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të	Institucioni i disponon të dhënat e personelit të angazhuar në MSH në "Inxhinieri Informatike", të ndarë sipas viteve akademike dhe semestrave. GVJ verifikoi gjatë takimit me zyrën e burimeve njerëzore dy dosje të dokumentacionit të personelit akademik, të përzgjedhura në mënyrë rastësore: një dosje për personelin me kohë të plotë (PAE) dhe një dosje për personelin me kohë të pjesshme (PAK).

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

faqe 62

<p>personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Dosja e anëtarit të PAE, me gradë Doktor, përmbante:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontratë punësimi (PAE) • Diplomë për Kandidat i Shkencave • Librezë pune dhe librezë shëndetësore • Vlerësimi nga studentët • Fotokopje e kartës së identitetit <p>Dosja e anëtarit të PAK, me kualifikim MSc, përmbante:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontratë punësimi (PAK) • Shtojcë kontrate punësimi • Curriculum Vitae • Diplomë Master Shkencor • Diplomë Master i Nivelit të Dytë (MND) • Librezë shëndetësore • Vërtetim punësimi full-time (Ministria e Financave) <p>[Aneksi 24: "Te dhenat tabelore per personelin akademik"]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Referuar rregullores së zyrës së Burimeve Njerëzore të UET, seksioni G.1, "Politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik", institucioni ka hartuar procedura konform ligjeve në fuqi për rekrutimin e personelit akademik. Gjithashtu, nga takimi me përfaqësuesen e zyrës, dhe me stafin, gjatë vizitës në institucion, GVJ krijoi bindjen se këto procedura janë zbatuar nga zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>[Aneksi 11: "Rregullore për burimet njerëzore"]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni harton kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit. Këto kritere janë publikuar qartësisht në shpalljet e ndryshme për vende vakante.</p> <p>Shembull të këtyre shpalljeve janë vënë në dispozicion në Aneksin 11.1.</p> <p>[Aneksi 11.1: "Shembull thirrje për staf akademik"]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>Institucioni, si pjesë e procedurës së rekrutimit, i ka shpallur vendet vakante në media të ndryshme, si faqja zyrtare, mediat sociale, dhe gazetën e universitetit, "Liberale". Këto shpallje janë transparente për kriteret e përgjithshme dhe specifike të rekrutimit, hapat që ndiqen, dhe dokumentacioni i kërkuar.</p> <p>Gjithashtu, referuar rregullores së zyrës së Burimeve Njerëzore, janë disa faza seleksionimi, të cilat garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Këto faza përfshijnë përzgjedhjen paraprake nga zyra e Burimeve Njerëzore, përzgjedhjen nga departamenti për fazën e intervistës, ngritjen e Komisionit të Rekrutimit, vlerësimin e kandidatëve me pikë nga secili anëtar i komisionit, mbajtjen e një leksioni të hapur nga kandidatët me pikët më të larta, dhe shpalljen e rezultateve.</p> <p>[Aneksi 11: "Rregullore për burimet njerëzore"], [Aneksi 11.1: "Shembull thirrje</p>

	për staf akademik”]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	GVJ vlerëson se institucioni i ka krijuar personelit mjedisin dhe mundësitë e përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave, si të mësimdhënies, kërkimit shkencor, ashtu edhe të shërbimeve ndaj institucionit.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni është angazhuar për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit nëpërmjet organizimit të disa trajnimeve profesionale, seminareve, dhe webinarëve.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka aplikuar skema për nxitjen e kërkimit shkencor. Një prej tyre është alokimi i një fondi shpërblimi për personelin akademik që boton në revista shkencore të indeksuara nga Thomson Reuters. Gjithashtu, nëpërmjet Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve, disa prej anëtarëve të stafit akademik të Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë janë përfshirë në projekte ndërkombëtare.</p> <p>Institucioni ka mundësuar edhe mobilitetin e stafit nëpërmjet projektit “Erasmus +” duke i dhënë mundësinë pedagogëve të shkëmbejnë eksperiencën në mësimdhënie me lektorë në universitete të tjera jashtë vendit. Mobiliteti i stafit pësoi ndërprerje në vitin 2020, për shkak të kufizimit të lëvizjeve gjatë pandemisë Covid-19.</p> <p>[Aneksi 33: “Të dhëna për trajnime profesionale”], [Vizita në IAL], [Aneksi 3.2: “Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025”], [dok shtesë: “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit”]</p>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ka aplikuar metoda inovative të mësimdhënies dhe ka adoptuar teknologji të reja. Në dispozicion të programit të studimit janë vënë laboratorët kompjuterikë të pajisur me PC me programe softuerike specifike për programin e studimit. Gjithashtu, një laborator i ri Virtual Reality (VR) pritet t’u vihet në dispozicion edhe për studentët e informatikës në përgjithësi, si dhe për programin e studimit në fjalë, ku do të zhvillojnë detyra të ndryshme kërkimore në bashkëpunim dhe me degë e profile të tjera. GVJ u njoh nga afër me këtë laborator të dedikuar gjatë vizitës në IAL dhe vlerëson nivelin e lartë të infrastrukturës në dispozicion. Stafi i IT që shoqëronte, demonstroi përdorimin e pajisjeve dhe softuerëve të Realitetit Virtual dhe atij të Augmentuar.

	<p>Për sa i përket programeve softuerike në mësimdhënie, vlen të përmendet përdorimi i rregullt i sistemit të menaxhimit të mësimdhënies, UET LMS, i bazuar në programin open-source, Moodle. Ky sistem ka lehtësuar ndjeshëm komunikimin student-pedagog gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.</p> <p>Një rol gjatë pandemisë ka luajtur gjithashtu sistemi Microsoft Teams, i cili ka mundësuar mësimdhënien sinkrone në distancë me audio dhe video.</p> <p>[Vizita në IAL], [Aneksi 46.1: “Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS”], [Aneksi 46.4: “Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS”]; [Vizita në IAL]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>GVJ konstaton angazhim optimal të personelit për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Personeli akademik angazhohet në ofrimin e lëndëve të programit, duke patur një limit të ngarkesës mësimore sipas numrit të lëndëve dhe numrit të orëve vjetore të mësimdhënies. GVJ vlerëson se specializimet dhe kompetencat e personelit akademik, sipas CV-ve të tyre, përputhen përgjithësisht me lëndët që ata mbulojnë në programin e studimit. Programi i studimit koordinohet nga një Koordinator me gradë shkencore. Institucioni gjithashtu angazhon një koordinatore administrative në rang fakulteti, e cila kujdeset për komunikimin me studentët e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.</p> <p>GVJ gjithashtu vlerëson se strukturat administrative mbështetëse të ngritura në nivel institucional, angazhohen në mënyrë të kënaqshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. GVJ vlerëson se këto struktura janë një pikë e fortë e institucionit, duke ofruar mbështetje të rëndësishme për programet e studimit.</p> <p>[Aneksi 25: “Ngarkesa mesimore ne auditor e stafit akademik”], [Aneksi 20: “CV-të e personelit”, Aneksi 25: “Ngarkesa mesimore ne auditor e stafit akademik”], [Aneksi 36: “Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit”], [Vizita në IAL]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të</p>	<p>Aneksi 42 i dosjes së vetëvlerësimit: “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit”, i paraqet të dhënat e infrastrukturës në nivel institucional, pasi të gjitha programet e studimit shfrytëzojnë të njëjtat mjedise. Pra, nuk ka mjedise të dedikuara vetëm për një program studimi siç është MSH në “Inxhinieri Informatike”. Institucioni kujdeset gjatë</p>

<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Ilogaritjes së kuotave të pranimit të secilit program studimi që mjediset të jenë të mjaftueshme në raport me numrin e studentëve.</p> <p>Duke marrë në konsideratë punësimin e një pjese të studentëve, institucioni e ka përshtatur orarin mësimor të këtij programi studimi që mësimi të zhvillohet pasdite gjatë ditëve të javës si dhe të shtunën paradite.</p> <p>Për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, institucioni ka në dispozicion 19 salla për leksione dhe 14 klasa për seminare, të kapaciteteve të ndryshme. Sallat e leksioneve dhe klasat e seminareve janë të pajisura me PC, video projektorë dhe sisteme audio (foni). Këto ambiente u verifikuan gjatë vizitës në institucion.</p> <p>GVJ arrin në konkluzionin se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike.</p> <p>[Aneksi 42: “Infrastruktura në funksion të programeve të studimit”]</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në IAL, ekspertët verifikuan ambientet, laboratorët e kompjuterave dhe sallat e leksioneve. Institucioni ofron disa laboratorë informatike për studentët e programit të studimit, të pajisur me kompjutera (PC), të specifikave të kënaqshme.</p> <p>Gjithashtu, sallat e leksioneve janë të pajisura me PC, video projektor, dhe sisteme audio, në mbështetje të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratorët përmbajnë kompjutera (PC) me specifika hardware të kënaqshme (CPU, RAM, SSD, etj.), dhe programe software të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të lëndëve të natyrës praktike (programim, zhvillim software-sh, rrjeta kompjuterike, baza të dhënash, etj.), aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Një prej laboratorëve kishte pajisje shtesë të rrjetave kompjuterike dhe komponentë hardware të ekspozuar, për të shpjeguar nga ana praktike rrjetat kompjuterike dhe arkitekturën e kompjuterave.</p> <p>Institucioni gjithashtu ka ndërtuar një laborator të ri Virtual Reality (VR), i pajisur me headset-e VR dhe disa software fillestarë për vizualizimin 3D të koncepteve mësimore. Software-t fillestarë ishin kryesisht të fushës së mjekësisë, por ky laborator pritet që, me software shtesë, t’u vihet në dispozicion edhe studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Si konkluzion, referuar vizitës së GVJ në institucion dhe dosjes së vetëvlerësimit, ekspertët mendojnë se mjediset e praktikës, kryesisht laboratorë kompjuterikë, i plotësojnë nevojat për aftësimin praktik të studentëve të programit të studimit. Referuar Aneksit 42, institucioni siguron katër laboratorë të teknologjisë së informacionit, si më poshtë:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> • Lab 205 B, me 25 kompjutera dhe sipërfaqe 45 m² • Lab 206 B, me 35 kompjutera dhe sipërfaqe 45 m² • Lab 207 B, me 35 kompjutera dhe sipërfaqe 45 m² • Lab 208 B, me 80 kompjutera dhe sipërfaqe 160 m² <p>Laboratorët e sipërpërmendur janë vënë në dispozicion të studentëve të programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion, ekspertët verifikuan se kompjuterat e laboratorëve të sipërpërmendur ishin të pajisur me një numër programesh profesionale si: Java JDK, NetBeans, Apache Tomcat, MS SQL Server, Visual Studio, etj., në përputhje me natyrën e programit MSH në “Inxhinieri Informatike”. Kompjuterat ishin të lidhur në rrjetin lokal të institucionit dhe gjithashtu kishin qasje në Internet. [Vizita në IAL]</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Institucioni ua ka ofruar studentëve mundësinë që ta zhvillojnë praktikën profesionale pranë mjediseve të tij.</p> <p>Në këtë rast, studentët kanë patur mundësi ta zhvillojnë praktikën në njësi të ndryshme administrative të institucionit si Zyra e IT, Biblioteka, Zyra e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyra e Karrierës dhe Praktikave, Zyra e Aktiviteteve, ose pranë koordinatorëve të departamenteve.</p> <p>Megjithatë, në marrëveshje me institucione ose kompani të ndryshme, shumica e kërkesave për praktikë janë akomoduar jashtë mjediseve të institucionit.</p> <p>[RVB], [Takimi me studentët]</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit dhe vizitës në institucion, konstatohet se institucioni vë në dispozicion të studentëve një bibliotekë mësimore. Kjo bibliotekë ka sipërfaqe totale prej 300 m² dhe është e vendosur në një godinë të dedikuar, godinën C.</p> <p>Biblioteka e institucionit është e pajisur me literaturë fizike, në pjesën më të madhe me libra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj (kryesisht anglisht). Gjithashtu, në bibliotekë u evidentuan botime periodike si revista shkencore të “UET Press” dhe disa shtëpive të tjera botuese.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë, u evidentua literaturë fizike e pakët për</p>

<p>moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>fushën e informatikës, të vendosur në raftet e fushës së Ekonomisë. Gjithashtu, referuar inventarit të teksteve, ekspertët mendojnë se nevojiten tekste më bashkëkohore dhe më të përshtatshëm për lëndët e programit të studimit.</p> <p>Megjithatë, së fundmi, institucioni ka përfituar një donacion të ri librash nëpërmjet projektit “International Book Project”. Gjatë vizitës, librat e donacionit ishin ende të vendosur në kuti, për shkak të numrit të madh të tyre dhe mungesës së rafteve. Përgjegjësjë e bibliotekës shpjegoi se një pjese e konsiderueshme e teksteve u përkasin fushave inxhinierike dhe informatike, duke hapur dhe verifikuar disa prej kutive. Megjithatë, është i paqartë numri i teksteve të informatikës në këtë donacion dhe sa të përshtatshëm e bashkëkohorë janë për mbulimin e lëndëve të programit të studimit. Pritet që tekstet e reja t’u vihen në dispozicion studentëve pas transferimit në kampusin e ri.</p> <p>[Aneksi 42: “Infrastruktura në dispozicion të programeve të studimit”], [Aneksi 45: “Inventari i teksteve për fushën e programit të studimit”], [Vizita në IAL]</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni u jep qasje studentëve në biblioteka on-line, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • EBSCO • SAGE • Questia <p>Bibliotekat on-line të mësipërme nuk janë specifike për fushën e programit të studimit, por ndër-disiplinare, ku mbulohet edhe fusha e informatikës.</p>				
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me 14 kompjutera (PC) dhe programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin e bibliotekave on-line nga ana e studentëve.</p>				
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni i specifikon procedurat për pasurimin e bibliotekës në rregulloren e bibliotekës. Kërkesa për tekste të reja kryhet nga drejtuesi i departamentit nëpërmjet formularit për pasurimin e fondit të bibliotekës.</p> <p>[Aneksi 45.1, pika E.IV.4: “Pasurimi i Bibliotekës”], [Aneksi 45.2: “Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë”]</p>				
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në oraret 9:00 - 20:00 për ditët e hënë – e premte, dhe 10:00 – 17:00 për ditën e shtunë. Ky orar është në përputhje me orarin e zhvillimit të mësimi për programin e MSH në “Inxhinieri Informatike”, që është 17:00 - 20:00 gjatë ditëve të javës si dhe të shtunë paradite.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk</td> <td>Përmbushet</td> <td>Përmbushet</td> <td>Përmbushet</td> </tr> </table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet		

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni disponon një sistem informacioni për menaxhimin e universitetit, i quajtur UET UMS (University Management System). Ky sistem administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit MSH në "Inxhinieri Informatike". Funksionaliteti i këtij programi dokumentohet në Manualin e Përdoruesit për Sistemin UMS. [Aneksi 46: "Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS"]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstaton se sistemi i brendshëm i menaxhimit, UET UMS, përmban module të ndryshme që lejojnë administrimin e informacionit dhe dokumentacionin prej personelit të IAL dhe ofron ndihmë të rëndësishme në proceset e tyre të përditshme. [Aneksi 46: "Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS"], [Takimi me Përgjegjësin e Zyrës së IT]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ arrin në konkluzionin se sistemet menaxhimit UET UMS dhe UET LMS sigurojnë akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit, sipas nevojave të tyre përkatëse. Gjatë vizitës, përgjegjësi i Zyrës së IT demonstroi se është bërë një integrim ndërmjet këtyre dy sistemeve, pasi sistemi UET LMS i lexon një pjesë të rëndësishme të të dhënave nga databaza e UMS. Kjo arrihet nëpërmjet moduleve shtesë të zhvilluara nga përgjegjësi i IT, të cilat mundësojnë funksionalitete dhe gjenerim raportesh përtej asaj që ofron sistemi Moodle. [Aneksi 46.2: "UET LMS Guide për pedagogun"], [Aneksi 46.3, "UET LMS Guide për studentet"]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	UET LMS lejon, si nëpërmjet funksionalitetit bazë të Moodle, ashtu edhe nëpërmjet moduleve të integruara në LMS, komunikim dhe shkëmbim informacioni të shumëllojshëm ndërmjet personelit dhe studentëve. Ky sistem ka qenë veçanërisht i dobishëm gjatë periudhës së pandemisë së Covid-19, kur auditorët u mbyllën dhe mësimdhënia u zhvillua online.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit	Së pari, sistemi UMS ofron nëpërmjet modulit të statistikave monitorim të

<p>garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>aktivitetit akademik dhe administrativ.</p> <p>Së dyti, sistemi UET LMS lejon monitorimin në kohë reale të aktivitetit të pedagogëve për secilën lëndë, duke shfaqur materialet dhe aktivitetet përkatëse.</p> <p>Së treti, sistemi TEAMS, i përdorur gjatë pandemisë së Covid-19 për mësimdhënie interaktive me audio/video, ka lejuar monitorim më të detajuar të mësimdhënies online.</p> <p>Monitorimi, statistikat dhe raportimet me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët, nëpërmjet sistemeve të sipërpërmendura, dëshmojnë në Aneksin 46.5, “Raporti i ecurisë së mësimin online”.</p> <p>[Aneksi 46: “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS”], [Aneksi 46.4: “Video-trajtime mbi sistemin TEAMS LMS”], [Aneksi 46.5: “Raporti i ecurisë së mësimin online”]</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Informacionet për programin e studimit¹, personelin akademik², aktivitetet e ndryshme³, publikohen në web site-in zyrtar të institucionit, https://uet.edu.al në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. GVJ vëren se këto informacione janë në përputhje me dokumentacionin e dosjes së vetëvlerësimit për këtë program studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Tabela përmbledhëse 18.1 paraqet kostot për student në nivel institucional nga viti akademik 2016-2017 deri në vitin akademik 2018-2019. Megjithatë, mungojnë përlllogaritjet e kostove për student për programin e studimit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile. Këto përlllogaritje do të ndihmonin në vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare të programit të studimit.</p> <p>Në nivel institucional, vihet re një tendencë rënie e numrit total të studentëve, rënie e të ardhurave nga tarifat e studimit, dhe rritje e lehtë e kostove për student për vitet akademike që janë ofruar të dhënat. Por, nga ana tjetër, ka patur një tendencë rritje të numrit të</p>

¹ <https://uet.edu.al/neë/sq/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-dhe-arkitektures-3/>

² <https://uet.edu.al/neë/sq/fakulteti-i-inxhinierise-informatikes-e-arkitektures/>

³ <https://uet.edu.al/neë/sq/lajme-aktivitete-2/>

	<p>studentëve për programin e studimit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile.</p> <p>Gjithashtu, në dosjen e vetëvlerësimit mungon një plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile.</p> <p>[Aneksi 0.2: “Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH IngInf”], [Aneksi 27: “Cilesia ne hyrje dhe dalje - MSH Inxhinieri Informatike”], [dok. shtesë 6.1-6.6: “Pasqyra dhe Auditime Financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020”]</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Tabela përmbledhëse 18.2: “Të ardhura dhe financime të ndryshme” dhe pasqyrat dhe auditimet financiare për vitet 2018-2020 përqëndrohen në shpenzimet dhe të ardhurat në bazë institucionale. Megjithatë, në dosjen e vetëvlerësimit mungon një plan për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile.</p> <p>[Aneksi 0.2: “Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH IngInf”], [dok. shtesë 6.1-6.6: “Pasqyra dhe Auditime Financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020”]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni ka kryer auditim të pasqyrave financiare për tri vitet: 2018-2020. Pas mbylljes së pasqyrave financiare, institucioni ka kryer auditimin e jashtëm nga audituesi ligjor. Në këto raporte financiare janë reflektuar të ardhurat nga tarifat e shkollimit (për të gjithë programet e studimit) dhe kontributet e tjera financiare për studentët, dhe ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>[RVB], [dok. shtesë 6.1-6.6: “Pasqyra dhe Auditime Financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020”]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Referuar dosjes së vetëvlerësimit dhe dokumenteve shtesë, për periudhën 2017-2020 vihet rënje e të ardhurave, ulje e shpenzimeve, dhe një tendencë rritje e fitimit institucional. GVJ vlerëson se pasqyrat financiare, shumëllojshmëria e burimeve të të ardhurave, dhe auditimet e rregullta financiare dëshmojnë një qëndrueshmëri financiare të institucionit për vitet 2017-2020, ku përfshihet periudha e zhvillimit të programit të studimit MSH në</p>

	<p>“Inxhinieri Informatike”, me 5 profile.</p> <p>[Aneksi 0.2: “Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB - MSH IngInf”], [dök. shtesë 6.1-6.6: “Pasqyra dhe Auditime Financiare për vitet 2018, 2019 dhe 2020”]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Rregullorja e UET përkufizon politikat dhe procedurat në nivel institucional, të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të tre cikleve të studimit, nga hyrja (Kreu III: “Pranimi i Studentëve”) deri në dalje (Kreu IX: “Diplomimi”). Rregullorja e UET plotësohet nga Rregullorja e programit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile.</p> <p>Këto rregullore mbështeten në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në akte të tjera ligjore dhe nënligjore, dhe Statutin e institucionit.</p> <p>[Aneksi 5: “Rregullore e UET”], [Aneksi 7: “Rregullore MSH Inxhinieri Informatike”], [Aneksi 2: “Statuti UET”]</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Statuti (Neni 50, Pika 3) dhe rregulloret e institucionit dhe programit të studimit garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të	Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit janë të shprehura qartësisht në Rregulloren e UET dhe në Rregulloren e

vlerësimin të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike”. Një pjesë e informacioneve të mësipërme janë të aksesueshme nëpërmjet ueb faqes zyrtare ^{4 5} , ku gjithashtu është i publikuar Statuti i institucionit ⁶ . [Aneksi 5: “Rregullore e UET”], [Aneksi 7: “Rregullore MSH Inxhinieri Informatike”]			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Referuar Statutit të institucionit, Neni 30, pika 6, UET shpall publikisht kuotat dhe kriteret e pranimit, para fillimit të aplikimeve për pranimin e studentëve. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve shpallen në ueb faqen e institucionit. ⁷ [Aneksi 2: “Statuti UET”]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Publiku dhe të interesuarit informohen për programet e studimit dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet ueb faqes së institucionit. ⁸			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve të programit të studimit luan koordinatorja e Fakultetit. Gjithashtu, studentët kanë qasje në sistemin UET LMS, ku informohen për rezultatet dhe kreditet e fituara. [Aneksi 7: “Rregullore MSH Inxhinieri Informatike”]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Këto kriteret dhe procedura specifikohe në Aneksin 28.

⁴ <https://uet.edu.al>

⁵ <https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2018/10/Msc.-Inxhinieri-Informatike.pdf>

⁶ <https://uet.edu.al/ne/sq/statuti/>

⁷ <https://uet.edu.al/ne/sq/si-te-aplikojme/>

⁸ <https://uet.edu.al/ne/sq/si-te-aplikojme/>

kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	[Aneksi 28: “Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve”]			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e institucionit dhe e programit të studimit i specifikojnë qartë mënyrat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Studentët e programit e marrin këtë informacion kryesisht nëpërmjet syllabuseve të lëndëve. [Aneksi 5, Kreu V: “Kontrolli dhe vlerësimi i dijes”], [Aneksi 7, Seksioni 5: “Verifikimi i dijeve të fituara nga studentët”], [Aneksi 19: Silabuset e lëndëve]			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fillim të vitit të fundit akademik të programit të studimit, studentët plotësojnë formularin për zgjedhjen e temës për punimin e diplomës. Nëpërmjet koordinatores së fakultetit ata marrin informacionin e nevojshëm mbi punimin e temës së diplomës. Gjithashtu, referuar RVB, koordinatores u dërgon email për punimin e diplomës dhe formatin e miratuar nga institucioni. Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës janë të qartësuara në Aneksin 10. [RVB], [Aneksi 10: “Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit”]			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Referuar Aneksit 51, përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni informon të interesuarit mbi programin e studimit. Për këtë qëllim, institucioni organizon “Ditët e Hapura” në nivel Fakulteti, ku studentët e ardhshëm mund të marrin pjesë dhe të njihen nga afër me ambientet, profesorët, dhe mësimdhënien. [Aneksi 51: “Komunikimi i integruar i marketingut”]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për programin e studimit, përfshi organizimi dhe kohëzgjatja e studimeve. Një pjesë të informacionit, studentët e marrin nëpërmjet broshurës së UET dhe ueb faqes zyrtare ⁹ . Gjithashtu, koordinatores e Fakultetit dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Këshillimit ndaj Studentit luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve rreth programit të tyre të studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/

⁹ <https://uet.edu.al/neë/ëp-content/uploads/2018/10/MSc.-Teknologji-Informacioni.pdf>

<p>udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Studentët informohen në mënyrë më të detajuar për përmbajtjen e secilës lëndë/modul nëpërmjet platformës UET LMS dhe silabuseve përkatëse.</p> <p>[Aneksi 12: “Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”], [Aneksi 46.3: “UET LMS Guidë për studentët”], [Aneksi 19: Syllabuset]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka në përbërje të tij Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Një nga qëllimet kryesore të kësaj zyre është t’i informojë vazhdimisht studentët rreth mundësive të punësimit, si dhe t’i mbështesë ata që të hyjnë në tregun e punës. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, përgjegjësjë e Zyrës shpjegoi se, kjo Zyrë cakton nga një këshillues karriere të dedikuar për secilin Fakultet. Këshilluesi i karrierës ndihmon në shpërndarjen e informacionit, kryesisht nëpërmjet email-it, me studentët e Fakultetit, për mundësi punësimi, internshipe, workshop-e, dhe aktivitete të tjera. Ky shërbim u ofrohet edhe rrejt të Alumni-t.</p> <p>[Aneksi 12: “Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”], [Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kontaktohen rregullisht nga koordinatoresha e Fakultetit, me email apo me telefon, për t’u vënë në dispozicion informacionin e nevojshëm mbi organizimin e procesit mësimor. Çdo ndryshim në orar, ose ndryshim gjatë zbatimit të tij, u njoftohet studentëve përmes njoftimeve të koordinatoresha, dhe shpallet në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor, kalendarin akademik dhe aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen në UET, dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit LMS.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Institucioni përdor sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, UMS, dhe sistemin ueb të menaxhimit të mësimdhënies, UET LMS, i bazuar në Moodle. Studentët kanë qasje, edhe në distancë, në sistemin UET LMS, për t’u informuar në lidhje me programin e studimit.</p> <p>Referuar RVB, fq. 52, studentët kanë gjithashtu akses në UMS, por vetëm nga brenda ambienteve të institucionit.</p> <p>[Aneksi 46: “Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS”], [Anekset 46.1-46.3: UET LMS]</p>
<p>Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve</p>	<p>Sistemet UMS dhe LMS janë dy sisteme mjaftueshmërisht të sofistikuar ku ruhet informacion i detajuar dhe dokumentacion rreth aktivitetit mësimor të studentëve. Gjatë vizitës së GVJ, përgjegjësi i zyrës IT demonstroi një shumëllojshmëri raportesh që gjenerohen në kohë reale nga të dy sistemet. Gjithashtu, të dy sistemet janë integruar me njëri-tjetrin nëpërmjet databazës qendrore dhe moduleve shtesë, duke shmangur dublikimin dhe siguruar konsistencën e të dhënave.</p>

	[Vizita në IAL]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni ruan, në regjistrin themeltar të studentëve, të dhënat e studentëve të programit të studimit MSH në "Inxhinieri Informatike", për të tre vitet akademike që programi ka qenë aktiv. Statistikat vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve, ndarë sipas profileve të programit të studimit, janë vënë në dispozicion në dosjen e vetëvlerësimit. [Aneksi 27: "Cilësia në hyrje dhe dalje - MSH Inxhinieri Informatike"]																																
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Aneksi 27 i dosjes së vetëvlerësimit paraqet statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi. Nuk paraqiten statistika për tërheqjet nga programi, dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, por referuar RVB, fq. 52, këto të dhëna gjenden në databazën e institucionit. <table border="1"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Profili "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh"</th> <th>Profili "Inxhinieri Software-sh"</th> <th>Profili "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh"</th> <th>Profili "Menaxhim të Dhënash"</th> <th>Profili "Siguria e Sistemeve të Informacionit"</th> <th>Në total</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018 -2019</td> <td>3</td> <td>5</td> <td>0</td> <td>11</td> <td>2</td> <td>21</td> <td>5.8</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>6</td> <td>12</td> <td>2</td> <td>7</td> <td>24</td> <td>52</td> <td>6.78</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>5</td> <td>21</td> <td>0</td> <td>9</td> <td>11</td> <td>46</td> <td>6.35</td> </tr> </tbody> </table> [Aneksi 27: "Cilësia në hyrje dhe dalje - MSH Inxhinieri Informatike"], [RVB]	Numri i studentëve të regjistruar	Profili "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh"	Profili "Inxhinieri Software-sh"	Profili "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh"	Profili "Menaxhim të Dhënash"	Profili "Siguria e Sistemeve të Informacionit"	Në total	Nota mesatare	2018 -2019	3	5	0	11	2	21	5.8	2019-2020	6	12	2	7	24	52	6.78	2020-2021	5	21	0	9	11	46	6.35
Numri i studentëve të regjistruar	Profili "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh"	Profili "Inxhinieri Software-sh"	Profili "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh"	Profili "Menaxhim të Dhënash"	Profili "Siguria e Sistemeve të Informacionit"	Në total	Nota mesatare																										
2018 -2019	3	5	0	11	2	21	5.8																										
2019-2020	6	12	2	7	24	52	6.78																										
2020-2021	5	21	0	9	11	46	6.35																										
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Të dhënat për ecurinë e studentëve të programit të studimit ruhen kryesisht në sistemin e informacionit UMS nëpërmjet Modullit të Koordinatorëve, por edhe në sistemin LMS. Në bazë të tyre, mund të gjenerohen raporte në kohë reale rreth ecurisë së studentëve. [Aneksi 46: "Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS"]																																
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemeve UMS dhe LMS. Të dhënat kanë natyrë sensitive dhe siguria e tyre është nën përgjegjësinë e Zyrës së IT. Të dy sistemet kanë të integruara mekanizma të kontrollit të aksesit, duke mundësuar sigurinë e tyre (konfidencialitet,																																

lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	integritet, dhe disponueshmëri).			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Institucioni ka hartuar statistikën e para mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve të këtij programi studimi, si dhe punësimit të tyre. Megjithatë, nga ky program studimi ka dalë deri tani vetëm një brez studentësh që ka përfunduar studimet, prandaj mund të jetë ende herët për të matur shkallën e cilësisë së punësimit të tyre dhe të merren masa në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. [Aneksi 27: “Cilesia ne hyrje dhe dalje_MSH Inxhinieri Informatike”], [Aneksi 29: “Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve”]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Institucioni parashikon përfshirjen e studentëve në organe të ndryshme vendimmarrëse e këshilluese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshillat Studentorë (Qeveria Studentore¹⁰): Zgjidhen në nivel njësie kryesore dhe institucioni çdo dy vjet nga votat e studentëve. [Aneksi 2: “Statuti UET”, Neni 51] • Senati Akademik: Ndër anëtarët e Senatit Akademik janë kryetari i Këshillit Studentor të institucionit dhe dy studentë të tjerë përfaqësues të tre cikleve të studimit, që zgjidhen nga Këshilli Studentor, mandati i të cilëve është 2-vjeçar. [Aneksi 2: “Statuti UET”, Neni 19.2.4] • Këshilli i Etikës: Ka një anëtar që i rekomandohet Rektorit nga Këshilli Studentor i institucionit. [Aneksi 2: “Statuti UET”, Neni 19.6.2] • KSBC: Ka një përfaqësues nga Këshilli Studentor i institucionit. [Aneksi 2: “Statuti UET”, Neni 16.2]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe	Institucioni i përfshin gjerësisht studentët në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, përmes përfaqësimit të tyre në struktura të ndryshme vendimmarrëse dhe këshilluese (shih Kriterin 1), përfshirjes së tyre në procedurat e sigurimit të cilësisë dhe anketimeve të ndryshme. Kërkesat dhe vlerësimet e studentëve aktualë, por edhe të alumni-t, i kanë

¹⁰ <https://uet.edu.al/neë/sq/qeveria-studentore/>

<p>me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>shërbyer institucionit për evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>[Aneksi 2: “Statuti UET”], [Takimi me studentët], [Takimi me KSBC]</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Referuar planit mësimor të programit MSH në “Inxhinieri Informatike”, GVJ vlerëson se ngarkesa akademike e studentëve nuk tejkalohet dhe është e mirë-balancuar në vite akademike dhe semestra. Ngarkesa normale është 60 ECTS në vit akademik. Rregullorja e institucionit parashikon se studenti ka të drejtë të marrë më shumë kredite se kjo ngarkesë, të cilat i zbriten nga ngarkesa e viteve pasardhëse.</p> <p>Gjithashtu, duke patur parasysh punësimin e një pjese të konsiderueshme të studentëve të programit Master Shkencor, institucioni e ka përshtatur orarin mësimor që mësimi të zhvillohet 17:00-20:00 gjatë ditëve të javës dhe të shtunën paradite.</p> <p>[Aneksi 14.1: “Plani mesimor MSH Inxhinieri Informatike”], [Aneksi 5, “Rregullore e UET”, Neni 13.3], [Takimi me studentët]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Departamenti zhvillon një mbledhje në muaj, të hapur për studentët e programeve që administrohen nga Departamenti. Në këto mbledhje, studentëve u jepet mundësia të shprehin shqetësimet e tyre dhe të japin sugjerime për përmirësimin e programit të studimit. Sipas studentëve të programit, shqetësimet që ata kanë shprehur, zakonisht janë zgjidhur. Gjithashtu, studentëve u jepet mundësia të japin vlerësimin dhe sugjerimet e tyre për secilën lëndë, nëpërmjet Formularit të Vlerësimit të Studentëve për Pedagogun dhe Lëndën. Mekanizëm tjetër i përfshirjes së studentëve janë Fokus Grupet, të cilat janë takime ndërmjet Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë dhe një grupi të përzgjedhur studentësh të programit të studimit, me qëllim marrjen e opinionit të studentëve dhe ndarjen e eksperiencave të tyre për procesin mësimor dhe jetën studentore. Këto takime të Fokus Grupeve janë zhvilluar edhe për MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile, para zhvillimit të sezonit të provimeve përfundimtare.</p> <p>Feedback i vlefshëm për hartimin dhe përmirësimin e programin e studimit është dhënë edhe nga ish studentët alumni të universitetit.</p> <p>[Aneksi 6: “Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit”, F.V.2.3], [Takimi me studentët], [Aneksi 40: “Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët”], [Aneksi 30.2, Shtojca F: “Guidelines for conducting a Focus Group”], [Takimi me përgjegjësen e ZSC], [Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit]</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit</p>	<p>Studentëve të këtij programi studimi u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, me mënyrat e përmendura në Kriterin 4.</p> <p>Studenti mund të marrë shpjegime për komponentin e vlerësimit gjatë seancave sqaruese me pedagogun e lëndës. Në rast se studenti ka ankesë</p>

nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës	<p>për pikët që ka marrë, atij i mundësohet ankimimi i rezultatit nëpërmjet një kërkese drejtuar Përgjegjësit të Departamentit për rivlerësim, i cili kryhet nga një komision i përbërë nga 3 pedagogë.</p> <p>Një masë shtesë që merr institucioni për të ruajtur barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit, është sekretimi i provimeve, për të ruajtur anonimatën e studentit deri në korrigjimin e tezave nga pedagogu i lëndës.</p> <p>[Aneksi 5: “Rregullore e UET”, Nenet 27.4 dhe 32]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	<p>Referuar Aneksit 43, personeli akademik i institucionit merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. GVJ e vlerëson të kënaqshëm outputin shkencor të personelit akademik të programit të studimit, edhe pse ky output duket se është i përqëndruar në disa prej anëtarëve të personelit.</p> <p>[Aneksi 43: “Të dhëna mbi kërkimin shkencor për stafin akademik”]</p>
Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	<p>Institucioni ka lidhur një numër marrëveshjesh me institucione të huaja për programe të përbashkëta studimi, projekte dhe kërkim shkencor të përbashkët.</p> <p>[Aneksi 34.12: “Marreveshje bashkepunimi UET”]</p>
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	<p>Studentët e programit Master Shkencor në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile, realizojnë temën e diplomës si studimin dhe punimin përmbys shkencor të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, raportohet vetëm një student i këtij programi studimi si pjesëmarrës në projekte kërkimore në rang Fakulteti.</p> <p>Megjithatë, përtej aktivitetit shkencor të mësipërm, GVJ nuk konstaton ndonjë punim shkencor të publikuar prej studentëve të programit të studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile. Institucioni organizon konferencën e përvitshme shkencore, “Ditët e Studimeve Shqiptare”, por nuk ka të dhëna për pjesëmarrje të studentëve të këtij programi studimi si prezantues në këtë konferencë.</p> <p>GVJ rekomandon që personeli akademik duhet t'i shtojë përpjekjet për inkurajimin e studentëve me temat më të mira të diplomës që t'i prezantojnë/botojnë rezultatet e tyre shkencore në këtë konferencë, në</p>

	revistën e re të fakultetit, "Nodus", ose përtej tyre. [Aneksi 0.2, Tabela 22], [Aneksi 55: "Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH)", [Takimi me studentët]			
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	Institucioni mbështet publikime cilësore nga personeli akademik, duke ofruar shpërblim financiar për çdo botim në revista shkencore të indeksuara nga Thomson & Reuters. Gjithashtu, botimet cilësore dhe revista me faktor impakti vlerësohen me më shumë pikë në formularin e matjes së performancës së kërkimit shkencor të stafit akademik. Për sa i përket studentëve të programit Master i Shkencave në "Inxhinieri Informatike", me 5 profile, nuk ka evidenca për ndonjë publikim prej tyre në revista shkencore. [Vizita në IAL], [Aneksi 30.2, Shtojca C: "Indicators for the measurement of academic research performance"]			
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	Studentët e programit Master Shkencor në "Inxhinieri Informatike", me 5 profile angazhohen në punimin e diplomës dhe motivohen me një çmim për punimin më të mirë. [Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësen e Departamentit]			
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Pedagogët udhëheqës të temave të diplomës zhvillojnë seanca metodologjike me studentët që udhëheqin, sipas një kalendari takimesh. Gjatë seancave metodologjike, udhëheqësi ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve, studimeve dhe përpunimit të rezultateve. [Aneksi 7: "Rregullore MSH Inxhinieri Informatike", Neni 8]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.7 Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	Institucioni ka bashkëpunime të kënaqshme me organizma shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto bashkëpunime janë shfrytëzuar për projekte të përbashkëta dhe për mobilitetin e stafit dhe studentëve të programit. Për periudhën 2018-2020, në Departamentin e Informatikës dhe Teknologjisë janë fituar 4 projekte, në një prej të cilëve institucioni ka qënë lider projekti. Në vitin akademik 2018-2019 ka patur mobilitet të 2 pedagogëve të Departamentit drejt universiteteve të huaja. Pas këtij viti nuk ka patur mobilitet të stafit për shkak të pandemisë Covid-19. Gjithashtu, në vitet akademike 2018-2019 dhe 2019-2020, gjithsej 3 studentë të programit të studimit MSH në "Inxhinieri Informatike", me 5 profile kanë përfituar nga mobiliteti me programin Erasmus+. Nga ana tjetër,

	<p>nuk është raportuar ndonjë mobilitet i studentëve të huaj në institucion, në rang programi studimi apo departamenti.</p> <p>[Aneksi 34.12: “Marreveshje bashkepunimi UET”], [dok shtesë: “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit”], [Aneksi 28.1: “Mobiliteti i studenteve Erasmus”]</p>
<p>Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.</p>	<p>Studentët e programit marrin njohuri dhe aftësi të metodave bazë të kërkimit shkencor nga lënda “Metoda kërkimi të avancuara”, e cila është një lëndë e detyrueshme në planin mësimor të programit. Kjo lëndë siguron përgatitje të studentëve edhe për ciklin e tretë të studimeve. Njohuritë dhe aftësitë e fituara priten të implementohen në lëndët e tjera të programit, veçanërisht në Temën e Diplomës, si punim përmbyllës shkencor i studimeve.</p> <p>[Aneksi 14.1: “Plani mesimor MSH Inxhinieri Informatike”], [Aneksi 19: Syllabuset e lëndëve]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.</p>	<p>Kur fitohet një projekt, koordinatori dërgon një email tek i gjithë personeli me ndarjen në detyra dhe work packages. Personeli shpreh interesin për pjesëmarrje duke plotësuar një formular elektronik (Google Forms).</p> <p>[Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.</p>	<p>GVJ nuk konstaton politika integruese për kërkuesit shkencorë të huaj në Strategjitë e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 dhe 2021-2025.</p> <p>Gjithësi, referuar Aneksit 55, vihet re se në konferencën vjetore “Ditët e Studimeve Shqiptare” kanë marrë pjesë disa kërkues shkencorë të huaj. Gjithashtu, për vitin akademik 2019-2020 janë organizuar në nivel departamenti 3 leksione/seminare me lektorë të huaj.</p> <p>Kuptohet se perioda e pandemisë Covid-19 e ka vështirësuar integrimin dhe mobilitetin e kërkuesve shkencorë të huaj në institucion.</p> <p>[Aneksi 3.1: “Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020”], [Aneksi 3.2: “Strategjia e kërkimit shkencor UET 2021-2025”], [dok shtesë: “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit”]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.</p>	<p>Institucioni favorizon mobilitetin e studentëve dhe lehtëson një sërë procedurash në këtë proces me mbështetjen e Zyrës së Projekteve dhe Partneriteteve. Kjo dëshmohet edhe nga mobiliteti i studentëve Erasmus+ për periudhën 2018-2020.</p> <p>[Vizita në IAL], [Aneksi 28.1: “Mobiliteti i studenteve Erasmus”]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore</p>	<p>RVB nuk paraqet evidenca për këtë kriter. Ndërkohë që nuk ka patur mobilitet të studentëve të huaj në insitucion në rang programi apo departamenti, nuk është e qartë nëse institucioni ka pritur personel akademik të huaj në rang programi apo departamenti.</p> <p>[Aneksi 28.1: “Mobiliteti i studenteve Erasmus”], [dok shtesë: “Të dhëna mbi projektet dhe shkëmbimin e stafit”].</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Njësia e posaçme e institucionit në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve është Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Aktualisht, kjo zyrë përbëhet nga 4 anëtarë dhe mbulon shërbimet e karrierës, mbështetjen e klubeve studentore, organizimin e aktiviteteve, trajtimin e problematikave, menaxhimin e bursave studentore, dhe shpërndarjen e informacionit tek studentët. Shpërndarja e informacionit për studentët e programit të studimit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile kalon përmes koordinatores së Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.</p> <p>[Aneksi 12: “Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”], [Takimi me përgjegjësen e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit], [Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Rolin kryesor për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin studentëve të programit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile e luan koordinatori i Fakultetit.</p> <p>Institucioni gjithashtu ofron këshillimin akademik, ku çdo pedagog është i detyruar të qëndrojë në zyrë 1 orë në javë, jashtë orarit të mësimit, në dispozicion të studentëve që ndjekin lëndën e tij. Ky shërbim u ofrohet edhe studentëve të ciklit të dytë, pra studentëve të programit MSH në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile dhe konsiderohet i dobishëm për këshillimin dhe asistimin e studentëve nga pedagogu i secilës lëndë.</p> <p>[Aneksi 27.2: “Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik”], [Aneksi 5: “Rregullore e UET”], [Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e</p>	<p>Institucioni ka në përbërje të tij Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. Një nga qëllimet kryesore të kësaj zyre është t’i informojë në mënyrë të vazhduar studentët rreth mundësive të punësimit dhe t’i orientojë ata në tregun e punës. Gjithashtu, kjo Zyrë cakton nga një këshillues karriere të dedikuar për secilin Fakultet. Këshilluesi i karrierës u shpërndan informacion dhe njoftime studentëve të fakultetit, në lidhje me mundësi punësimi, internshipe, workshop-e, dhe aktivitete të tjera.</p> <p>[Aneksi 12: “Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit”], [Takimi me përgjegjësen e Zyrës së Këshillimit të</p>


punës.	Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit]			
Kriteri 4. Zyra/njësi e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Vitin e kaluar akademik ka përfunduar studimet brezi i parë dhe i vetëm i studentëve të programit. Duke qenë se programi i studimit është në proces akreditimi për herë të parë, ky brez studentësh nuk janë pajisur ende me diplomë. Për këtë arsye, gjykohet se është herët për të matur shkallën e cilësisë së punësimit të tyre dhe të merren masa në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Sidoqoftë, statistikat e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit tregojnë një nivel të kënaqshëm të punësimit të brezit të parë të studentëve të programit, pasi shumica dërrmuese e tyre janë të punësuar në përputhje me diplomën. [Aneksi 29: “Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve”]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konstaton se UET ka konsoliduar politika, procedura dhe struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit. Strukturat e SBC në institucion janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), pjesë përbërëse e të cilës është gjithashtu Zyra e Kurrikulave Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) [Takimi me përgjegjësit e ZSC dhe KSBC], [Aneksi 2: “Statuti i UET”, Neni 11]. [Aneksi 8: “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të	GVJ gjykon se strukturat e SBC në institucion janë funksionale, për të garantuar që veprimtaria e institucionit të jetë në përputhje si me

<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>legjislacionin në fuqi, Statutin dhe rregulloret e brendshme, ashtu edhe me objektivat strategjike të institucionit. Gjithashtu, SBC zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë, ish studentë, dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.</p> <p>Parimet e veprimtarisë së SBC në institucion janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një tabloje të gjendjes aktuale të institucionit • Ngritja e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe krijimi i kulturës së cilësisë në institucion • Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e institucionit, njësisive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj. <p>[Aneksi 30.3: “Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022”], [Vizita në IAL]</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet përmes instrumenteve të ndryshme: përfshirjes së personelit akademik dhe ndihmës-akademik, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, ZCS, dhe KSBC, anketimit të mendimit të studentëve, dhe bashkëpunimit me ASCAL, MASR dhe struktura të tjera shtetërore për arsimin e lartë.</p> <p>Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë është realizuar periodikisht në nivel institucional dhe në nivel të programeve të studimit.</p> <p>Universiteti European i Tiranës është akredituar me Vendim të BA Nr. 12, datë 07.04.2017, me kohëzgjatjen 5 vite, me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022. Pas riorganizimit të njësisive kryesore nga 3 fakultete në 5 fakultete UET akreditohet me Vendim të BA Nr. 46, datë 05.07.2019 me afat vlefshmërie deri në 06.04.2022.</p> <p>Programi i studimit Master Shkencor në “Inxhinieri Informatike”, me 5 profile, po i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p> <p>[RVB], [Vizita në IAL]</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësisive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Manuali i UET për sigurimin e brendshëm të cilësisë përshkruan politika dhe procedura të qarta periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në rang institucional dhe për programin e studimit. Nga takimi me përgjegjëset e ZCS dhe KSBC, GVJ gjykon se procedurat zbatohen rregullisht nga këto njësi.</p> <p>[Aneksi 30.2: “Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë”]</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Paqë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Një nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e programit të studimit, është KSBC, e cila vepron në nivel institucional për të gjitha programet e studimit. Në garantimin e cilësisë luajnë rol të rëndësishëm edhe departamenti përgjegjës për programin e studimit (Departamenti i Informatikës dhe Teknologjisë), dhe koordinatori i programit. Për hartimin dhe rishikimin e programeve të studimit, struktura përgjegjëse ka qenë Zyra e Kurrikulave, e ngritur në vitin 2008, e cila gjithashtu vepron në nivel institucional. Në hartimin e kurrikulave të programeve të studimit, kjo zyrë është kujdesur për harmonizimin e propozimeve të departamentit me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të institucionit, dhe për të shmangur përplasjet midis lëndëve.</p> <p>[Aneksi 36: “Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit”], [Aneksi 13: “Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave”], [Vizita në IAL]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ gjykon se institucioni përdor mekanizma e procese mjaftueshëm formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit. Këto mekanizma dhe procese janë të dokumentuara në Manualin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>[Aneksi 30.2: “Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë”]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me Manualin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, metodologjitë e vlerësimit dhe instrumentet matëse/vlerësuese përcaktohen për secilin vit akademik në planin e veprimit. Siç dëshmohet në planin e veprimit për vitin akademik 2020-2021, aktivitetet dhe instrumentet matëse/vlerësuese kanë qenë të shumëllojshme, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi • Kërkimi shkencor • Mbështetja e studentëve • Sigurimi i cilësisë <p>Metodologjia e punës për kontrollin e provimeve të ndërmjetme/përfundimtare dhe cilësisë së korrigjimit detajohet më tej në Aneksin 30.5.</p> <p>[Aneksi 30.1: “Plani veprimit KSBC”], [Aneksi 30.5: “Metodologjia e punës së KSBC_Provimet”]</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse, titullarit të lëndës, përgjegjësve të grupl-</p>

përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	lëndëve, përgjegjësit të departamentit, dekanit etj. Referuar Aneksit 8, Pika F.VII.7.6, rezultatet e KSBC publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Një shembull i komunikimit të rezultateve të vlerësimit drejt autoriteteve përgjegjëse demonstron në Aneksin 37. [Aneksi 8: “Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë”], [Aneksi 37: “Shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset”]			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Nga dosja e vetëvlerësimit nuk është e qartë nëse raportet e vlerësimit përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. Dosja nuk përmban ndonjë raport të brendshëm vlerësimi nga KSBC, përveç një formati relacioni për vlerësimin e provimeve. Ky format lejon raportimin e problematikave të gjetura, por nuk përfshin pika veprimi ose masa të marra për adresimin e tyre, apo përmirësimin në vijim të cilësisë. [Aneksi 30.6: “Formati Raporti për provimet”]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisë e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi i brendshëm kryhet në nivel institucional duke mbuluar të gjithë programet e studimit. Ky vlerësim kryhet në mënyrë periodike, çdo vit akademik, dhe detajohet në Plan Veprimin përkatës për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Dy plane veprimi, për vitet akademike 2018-2019, dhe 2020-2021, janë të disponueshme në Aneksin 30.1. Gjithashtu, procesi periodik i akreditimit të programit shërben si një mundësi për institucionin që të kryejë vlerësimin e brendshëm për programin e studimit, kundrejt gjithë standardeve dhe kriterëve të ASCAL. Rezultatet e tij përfshihen në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentet e tjerë të dosjes së vetëvlerësimit. [Aneksi 30.3: “Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2020”, Pika 5.13], [Aneksi 30.1: “Plani veprimi KSBC”]
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e	Referuar Plan Veprimeve për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe shtojcave në Manualin për SBC, GVJ gjykon se institucioni kryen një

<p>instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>vlerësim të gjithanshëm të mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, kërkimit shkencor, dhe mbështetjes së studentëve nëpërmjet instrumenteve të ndryshëm. GVJ i vlerëson metodat dhe instrumentet e përdorura si të shumëllojshme dhe të përshtatshme.</p> <p>[Aneksi 30.1: “Plani veprimit KSBC”], [Aneksi 30.2: “Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë”]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, ka përdorur metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vëzhgime në auditor • Vlerësim i silabuseve • Kontrolli i provimeve të ndërmjetme/përfundimtare dhe cilësisë së korrigjimit • Monitorim/vlerësim i procesit të hedhjes së notave, plotësimi dhe administrimi i dokumentacionit • Vlerësim i përfshirjes së studentëve në punët kërkimore-shkencore në nivel Departamenti • Monitorim/Vlerësim i zhvillimit të orëve të tutoriatit dhe seanceve metodologjike • Etj. <p>Për personelin akademik, eprori (Përgjegjësi i Departamentit, Dekani) zhvillojnë vizita të lajmëruara në auditor gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi. Në kushtet e pandemisë Covid-19, procesi është zhvilluar online përmes platformave UET LMS dhe Microsoft Teams dhe monitorimi i leksioneve dhe seminareve është realizuar nga Zyra e IT përsa i përket aksesimit nga studentët, kohëzgjatjes, frekuentimit, etj, kurse në lidhje me cilësinë monitorimi ka vazhduar të kryhet nga eprori.</p> <p>[Aneksi 30.1: “Plani veprimit KSBC”], [Aneksi 30.8: “Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu”], [Takimi me ZCS], [Aneksi 46.5: “Raport ecuria e mësimin online”]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e</p>	<p>Institucioni ka përdorur metoda e instrumenta të tërthorta vlerësimi për marrjen e mendimit të palëve të ndryshme, si p.sh:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetësi i vlerësimit të pedagogut nga studentët [Aneksi 40] • Formular për adresimin e kërkesave të studentëve [Aneksi 40.1] • Formulari i vetëvlerësimit të praktikës nga studenti [Aneksi 32.2] • Fokus grupe [Aneksi 30.2, Shtojca F] • Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu [Aneksi 30.8] • Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik

kompetencave të përftuara nga ky program	[Aneksi 41]		
	<ul style="list-style-type: none"> Pyetëtori i stafit UET [Aneksi 30.1, Pika D, "Sigurimi i cilësisë"] 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
			X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UET, përveç aktorëve të brendshëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë (organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, studentët), përfshin edhe aktorë të jashtëm. Kështu, UET ngre pranë departamenteve organe këshilluese të Bordeve të Tregut të Punës. Gjithashtu, përfshihet dhe angazhohet si anëtar i KSBC, një ekspert i jashtëm. [Aneksi 12.1: "Bordi i Tregut të Punës"], [Aneksi 30: "Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC"]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat për personelin përgjegjës për strukturat e SBC përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit. [Aneksi 8: "Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë"]
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	GVJ vlerëson se metodat dhe instrumentet e përdorura për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë (shih Standardin VI.3, Kriteret 3 dhe 4 më sipër), i përfshijnë mjaftueshëm departamentin dhe fakultetin përgjegjës për programin e studimit, personelin akademik dhe administrativ, si edhe studentët e programit të studimit.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ beson se në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe kompetencat profesionale të tyre. Gjithashtu, nuk konstatohet ndonjë diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të	UET ngre pranë departamenteve organe këshilluese, të njohura si Borde të Tregut të Punës, dhe angazhon një ekspert të jashtëm si anëtar të KSBC. Gjithashtu, shpesh merren mendime dhe ekspertizë e vyer për vlerësimin

jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit prej ish studentëve (alumni) të universitetit. [Aneksi 30: "Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC"], [Takimi me Dekanin dhe Përgjegjës in Departamentit]			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni bën publike, sipas një kalendari, Plan Veprimet për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për vitin përkatës akademik. Nga dosja e vetëvlerësimit nuk është e qartë nëse dokumentet e tjera institucionale si "Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022" apo "Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë" bëhen publike për stafin, studentët dhe të gjithë të interesuarit e tjerë. [Aneksi 30.1: "Plani veprimit KSBC"]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Duke marrë parasysh se raportet e KSBC përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato ndahen me ato grupe për të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë. Referuar Aneksit 8, Pika F.VII.7.6, raporti i plotë i KSBC i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Përgjegjësve të Departamenteve. Në rastet kur të dhënat vlerësohen se kanë sensibilitet të lartë, atëherë rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale. [Aneksi 8: "Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë"]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të dhënat e përftuara nga vlerësimet u vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, njësisve kryesore dhe bazë, dhe pedagogëve përkatës. GVJ vlerëson se rezultatet e vlerësimit shërbejnë për identifikimin e problematikave, duke ndihmuar në adresimin dhe përmirësimin e mangësive të evidentuara dhe marrjen e masave nga organet drejtuese dhe strukturat përgjegjëse.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ arrin në konkluzionin se strukturat e SBC institucion, si Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, Zyra e Kurrikulave, dhe KSBC, kujdesen që veprimtaritë në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë të jenë efektive në adresimin e problematikave dhe përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit.

	[Takimi me përgjegjësit e ZSC dhe KSBC]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	GVJ vlerëson se përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohej nga përfshirja e tyre në strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, veprimtari periodike të caktuara, siç janë mbledhjet e hapura të departamentit një herë në muaj, Fokus Grupet, dhe angazhimi i studentëve në grupet e vlerësimit të brendshëm në kuadër të akreditimit të programeve, luajnë një rol të rëndësishëm për ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në "Inxhinieri Informatike" me profilet: "Inxhinieri software-sh", "Siguria e Sistemeve të Informacionit", "Menaxhim të Dhënash", "Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", Universiteti Europian i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me kërkesat për hapjen e programeve të studimit, që ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kështu, plotëson nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit.
2. Programi i studimit gëzon mbështetje të mirë nga strukturat drejtuese dhe kjo vihet re nga projektet ndërkombëtare, mbështetja nga Bordi i Punës, apo mundësitë e ofruara për studentët.
3. Institucioni ka një sistem të konsoliduar të kontrollit të cilësisë në mësimdhënie.
4. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor. Kjo vlen dhe për situatën pandemike, ku studentët kanë komunikuar me anë të MS Teams.
5. Rritja e bashkëpunimit dhe pjesëmarrja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ka ofruar dhe mbështet personelin akademik dhe studentët në njohuri dhe eksperiencë në fusha dhe projekte me interes të programit të studimit dhe tregut të punës.

6. Institucioni ka zhvilluar mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional të personelit akademik në funksion të metodave bashkëkohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjeve në projekte ndërkombëtare.
7. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi të reja në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit.
8. Ofrimi i mbështetjes së studentëve me anë të bursave dhe programet e mobilitetit, ndërkombëtarizimit për studentët me rezultate të larta apo pjesëmarrjes dhe trajnimit në aktivitete dhe trajnime profesionale të organizuara nga UET dhe organizata profesionale apo kompani private.
9. Strukturat administrative mbështetëse të ngritura në nivel institucional janë të konsoliduara dhe të mirë-koordinuara, duke ofruar mbështetjen e nevojshme për funksionimin e programit të studimit.

Pika të dobta

1. Probleme të disa elementëve të programit të studimit me kuadrin ligjor:
 - a. Sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 41/2018, për programet Master profilet ndryshojnë me 12-20% të krediteve. GVJ konstaton që përvec profilit “Menaxhim dhe vlerësim projektësh”, të gjithë profilet e tjerë nuk e përmbushin plotësisht kriterin e përcaktuar në VKM nr. 41/2018. Diferenca me 12 ECTS, do të thotë që diferenca mes profileve, të kombinuar me njëri-tjetrin në forma të ndryshme, është e barabartë me 10%.
 - b. Sipas VKM nr. 418/2018, janë përcaktuar raportet e ngarkesës së personelit akademik me kohë të plotë, ku personeli akademik efektiv duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore. Raporti numerik i kësaj ngarkese del 57% PAE /43% PAK, pra IAL nuk përmbush rregullin e përcaktuar në VKM nr. 418 për raportin e personelit akademik.
 - c. Sipas Nenit 59/6 i Ligjit të Arsimit të Lartë, në programet e studimit Master është e domosdoshme që stafi të jetë të paktën me gradën “Doktor”. Në programin Master i Shkencave në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, viti akademik 2020-21, janë 2 pedagogë me gradën “Master”.
2. Programi i studimit MSc në “Inxhinieri Informatike” me 5 profile, paraqet këto mangësi:
 - a. Programi i studimit shpreh paqartësi në hartimin e qëllimeve dhe objektivave të tij. Vërehet një shpërndarje në dokumentacion, kur përcaktohen këto elemente të rëndësishëm të programit të studimit.
 - b. Disa nga profilet e programit të studimit shfaqin ngjashmëri, prandaj duhet të ketë më tepër ndarje në kurrikulat brenda tyre, për të diferencuar kompetencat profesionale e shkencore që duhet të fitojnë studentët.
 - c. Disa lëndë në strukturën mësimore si dhe në programet e tyre lëndore duhet të riemërtohen, apo dhe të rishikohen në lidhje me aspektin shkencor të tyre, si dhe aplikueshmërinë e njohurive të marra në to.
 - d. Përzgjedhja e lëndëve të profileve, përshkruhet se i përputhet tregut të punës, por mungon përafrimi me programe të ngjashme studimi, të ofruara nga institucione arsimore ndërkombëtare.

- e. Programi i studimit nuk paraqet kritere specifike pranimi për studentët që regjistrohen në këtë program.
3. Në faqen ueb të IAL, në programin Master i Shkencave "Inxhinierisë Informatike", GVJ konstaton një përafri tjetër mes 5 profileve të ndryshëm që ofron ky program studimi (duke përfshirë profilin "Siguria e Sistemeve të Informacionit"), si dhe 4 profileve të programit "Teknologji Informacioni". Sugjerojmë që oferta akademike e programeve të studimit në IAL, të mbështetet mbi një kërkesë konkrete dhe reale që vjen nga tregu i punës, nga aktualiteti shqiptar, nevojat e kërkuesve shkencorë si dhe institucioneve mbështetëse e jo për hir thjesht të diversifikimit të portofolit të titujve të ofruar.
 4. Personeli i punësuar me kohë të plotë që është i angazhuar me mësimdhënie në lëndët me natyrë teknike, është i pakët në numër.
 5. Dokumentacioni i analizës vjetore të programit të studimit nuk është realizuar në mënyrë të plotë dhe shteruese, duke ndjekur metodologjinë e duhur. Këtu do të duhej të nxirreshin në pah dhe efektet në punësim të diplomës, ndërtimi i strukturës mësimore, qartësia e programit, arsyetimi i profilizimit dhe llojeve të tyre, komunikimi me sektorin privat, etj.
 6. Njësia bazë (departamenti) ka varësi të qënësishme nga stafet në njësitë e tjera të fakulteteve të tjera të IAL për programin Master i shkencave, pasi një pjesë e madhe e lëndëve mbulohen prej tyre. Pavarësia e departamentit ndaj këtyre njësive do kishte impakt më pozitiv në konsolidimin e programit të studimit.
 7. Trajnimet dhe konferencat shkencore për studentët janë të pakta dhe kur janë, shpesh nuk lidhen drejtpërdrejt me profilin e tyre.
 8. Studentët kanë një përfshirje të ulët në veprimtarinë shkencore, përfshirë këtu vecanërisht hulumtimin, analizimin, eksperimentimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve, pra gjithë procesin ose faza të vecanta të tij.

Rekomandime

1. Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për zbatimin e gjithë kuadrit ligjor të programit të studimit, sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë, VKM-ve dhe gjithë rregullatorëve të përcaktuar për IAL që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tone.
2. Të hartohen përmbledhja e dokumentave të strukturës dhe planit mësimor për programin Master i Shkencave "Inxhinieri Informatike" me 5 profile, ku të vendosen të gjitha përshkrimet e nevojshme, të dhënat tabelare, profesionet e mundshme të secilit profil, kompetencat e fituara, qëllimet, objektivat, etj, sipas ligjit.
3. Rekomandohet rishikimi dhe rivlerësimi i kurrikulave të secilit profil. Të përshtaten këto kurrikula jo vetëm në bazë të kërkesave të tregut vendas, apo jo vetëm në bazë të stafit që ka në dispozicion, por të konsultohen programe të ngjashme në institucione arsimore perëndimore dhe lokale.
4. Syllabusi i lëndës "Metoda kërkimi të avancuara" të përshtatet me specifikat e fushës së programit të studimit. Gjithashtu, programet lëndore të secilit profil rekomandohen të azhurnohen sipas sugjerimeve të dhëna në këtë RVJ.

5. Të përcaktohen kritere specifike për pranimin e studentëve në këtë program studimi, për secilin profil (mund të jenë të ndryshme ose jo). Kjo në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit master, me vlerën e diplomës që synohet, si dhe me kërkesat e tregut.
6. IAL sugjerohet të ndërmarrë fushata rekrutimi për të përmbushur nevojat me burime njerëzore të angazhuar në lëndët e profileve të programit të studimit me natyrë teknike.
 - a. Rekomandohet zyra e Burimeve Njerëzore për të ndërtuar politika në lidhje me qëndrueshmërinë e stafit të drejtimeve teknike si këto të Informatikës në përgjithësi, që të mos ketë levizje të stafit në cdo vit akademik.
7. Njësia bazë duhet të ndërmarrë iniciativa të tjera në lidhje me aftësimin shkencor dhe praktik të studentëve dhe përtej orëve në auditor (trajtime, certifikime, pjesëmarrje konkrete në projekte).
8. Personeli akademik duhet t'i motivojë më tepër studentët e programit të përfshihen në aktivitete shkencore dhe t'i nxitë ata të prezantojnë ose botojnë rezultatet e temave të diplomës në konferenca dhe revista shkencore.
9. IAL të konsolidojë dokumentacionin e kërkuar sipas kritereve të shprehur në raport, sic ato kërkohen (analizat, vendimmarrjet, verifikimet, etj), si dhe të jenë të azhornuara. Vecanërisht GVJ rekomandon kryerjen e Analizës Vjetore të programit të studimit në mënyrë të plotë.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science in "Computer Engineering" with the profiles: "Software Engineering", "Information Systems Security", "Data Management", "Application Design and Development", "Project Management and Evaluation", European University of Tirana

Strengths and affirmations

1. The study program has been designed in accordance with the requirements for opening study programs, which have impact on the economic development of the country. Thus, it fulfils the needs of the labour market, in line with the strategic goals of local and national economic development in the Information Technology sector.
2. The study program enjoys good support from the management structures, which is indicated by the international projects, the support of the Board of Labour, as well as opportunities offered to the students.
3. The institution has a consolidated system of quality assurance in teaching.
4. The suitable facilities and modern didactic infrastructure available to the study program provide the necessary spaces and contemporary conditions for the learning process. This also applies to the pandemic situation, during which students have communicated through tools such as MS Teams.
5. Increasing cooperation and participation in national and international projects has provided and supported academic staff and students in terms of knowledge and experience in areas and projects of interest to the study program and the labor market.

6. The institution has developed specific mechanisms for the support and professional qualification of the academic staff, in support of contemporary teaching methods, scientific research and participation in international projects.
7. The institution has signed new cooperation agreements towards academic and professional cooperation. Providing support to students through scholarships and mobility programs, internationalization for students with high results or participation and training in activities and professional training organized by UET and professional organizations or private companies within the country and abroad.
8. The support of students through scholarships and mobility programs, internationalization for high-performance students, as well as participation and training in activities and professional trainings organized by UET, professional organizations, or private companies.
9. The administrative support structures set up at the institutional level are robust and well-coordinated, thus providing the necessary assistance for the functioning of the study program.

Weaknesses

1. Problems of some elements of the study program in terms of the legal framework:
 - a. According to the criteria set out in DCM no. 41/2018, for Master programs the profiles should vary by 12-20% of the total credits. The external evaluation group finds that except for the profile "Project Management and Evaluation", the other profiles do not fully meet the criteria set out in DCM no. 41/2018. The difference of 12 ECTS between the profiles, paired with each other in different ways, is equal to 10% of the total credits.
 - b. According to DCM no. 418/2018, which defines the academic staff workload ratios, the Effective Academic Staff (PAE) must cover no less than 70% of the teaching load. The numerical ratio of this workload for this study program is 57% PAE / 43% PAK, so the HEI does not meet the rule set out in DCM no. 418 on the academic staff ratio.
 - c. According to Article 59/6 of the Law on Higher Education, in Master study programs the academic staff is required to have at least the "Doctor" degree. In the MSc in "Computer Engineering" study program with 5 profiles, academic year 2020-21, there are engaged 2 lecturers with a "Master" degree.
2. The MSc in "Computer Engineering" study program with profiles: "Software Engineering", "Information Systems Security", "Data Management", "Application Design and Development", "Project Management and Evaluation", presents the following shortcomings:
 - a. The study program exhibits ambiguity in the design of its aims and objectives. A dispersion is observed in the documentation, where important elements of the study program are defined.
 - b. Some of the profiles show similarity. The study program should have more consistency in the curricula within each profile, to clarify the professional and scientific competencies that students should acquire.

- e. Some courses in the curriculum should be revised in terms of their scientific aspect, applicability of the gained knowledge, be renamed or updated.
 - d. The selection of profile courses is described as appropriate for the labor market, but there is a lack of comparability with similar study programs offered by international educational institutions.
 - e. The study program does not define specific admission criteria for students enrolled in it.
3. On the website of the HEI, where the MSc in "Computer Engineering" is described, the external evaluation group finds another approximation between the 5 different profiles offered by this study program (excluding the profile "Security of Information Systems"), and the 4 profiles of the program MSc in "Information Technology". We suggest that the academic offer of study programs in HEIs be based on a concrete and real demand that comes from the labour market, the Albanian actuality, the needs of researchers and supporting institutions, and not just for the sake of diversifying the portfolio of diplomas offered.
 4. The full-time staff that is engaged in teaching of courses of technical nature, is small in number.
 5. The documentation of the annual analysis of the study program is not realized in a complete and exhaustive way, by following the appropriate methodology. Here, the impact of the diploma on employment, the design of the curriculum, the clarity of the program, the justification of profiling and the actual profiles, the communication with the private sector, etc. should also be highlighted.
 6. The basic unit (department) has significant dependence on the staff of other faculties of the HEI for the study program, as a large part of the courses are covered by them. The independence of the department towards these units would have a more positive impact on the consolidation of the study program.
 7. Scientific trainings and conferences for students are few in number, and those few are often not directly related to their profile.
 8. Students have low involvement in scientific activity, especially including research, analysis, experimentation and drawing conclusions, that is, the whole process or specific stages.


Recommendations

1. It is recommended to take immediate measures for the implementation of the entire legal framework of the study program, according to the provisions of the Law on Higher Education. DCMs and all regulators designated for HEIs that exercise their activity in Albania.
2. All elements of the curricula of the study program should be brought together in one single document containing all the necessary descriptions and items, as requested by the law.
3. It is recommended to review and re-evaluate the curricula of each profile. Adaptation of these curricula should be done not only to the demands of the domestic market, or not only to the available staff, but to consult similar programs in Western educational institutions. Compile the appropriate summary documents of the structure and curriculum for the MSc in "Computer Engineering" study



program with 5 profiles, with all the necessary descriptions, tabular data, possible professions of each profile, acquired competencies, aims, objectives, etc.

4. The syllabus of the course "Advanced Research Methods" should be adapted to the specifics of the area of the study program. Also, the syllabi of each profile are recommended to be updated according to the suggestions given in this report, and to improve the literature with newer publications for some of the courses. In general, review the structure of the profiles, as well as consider the needs of students to acquire more practical skills.
5. Define specific criteria for admission of students in this study program, for each profile (may be different). This should be done in accordance with the aims and objectives of this study program, the value of the diploma intended, as well as labour market demands.
6. The HEI is suggested to undertake recruitment campaigns to meet the needs of human resources engaged in the courses of a technical nature for this study program.
 - a. It is also recommended that the Human Resources office build policies for the retention of the academic staff of technical fields, such as Informatics in general, so that there is no staff attrition each academic year.
7. The basic unit should undertake other initiatives related to the scientific and practical training of students even beyond the hours in the auditorium (training, certification, concrete participation in projects, etc.).
8. The academic staff should further motivate the students of the study program to engage in scholarly activities and encourage them to present or publish the results of their dissertations in conferences and scientific journals.
9. The HEI should consolidate the required documentation according to the criteria expressed in the report, as they are required (analysis, decision-making, verifications, etc.), as well as to be updated. We especially recommend conducting the Annual Analysis of the study program in full.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

